



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 37

Tiranë – E enjte, 11 mars 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 20/2021, datë 15.2.2021	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar..... 4699
Dekret i Presidentit nr. 11987, datë 4.3.2021	Për shpallje ligji..... 4703
Ligj nr. 22/2021, datë 22.2.2021	Për miratimin e shtesës së kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve..... 4704
Dekret i Presidentit nr. 11988, datë 4.3.2021	Për shpallje ligji..... 4712
Ligj nr. 23/2021, datë 22.2.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë..... 4712
Dekret i Presidentit nr. 11989, datë 4.3.2021	Për shpallje ligji..... 4713
Ligj nr. 24/2021, datë 22.2.2021	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro..... 4714
Dekret i Presidentit nr. 11990, datë 4.3.2021	Për shpallje ligji..... 4732
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 4, datë 26.2.2021	Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve..... 4732

Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 3.3.2021	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.....	4742
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 8.3.2021	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ) të nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 222, datë 23.3.2016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” dhe VKM-së nr. 765, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 222, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave ‘Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj’”. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 223, datë 23.3.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” dhe VKM-së nr. 766, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar”. Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”. Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 658, datë 26.9.2012, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....	4742
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 49, datë 17.2.2021	Mbi kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 21.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës ‘Intesa Sanpaolo Bank Albania’ sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare ‘Seka Hydropower’ sh.p.k.”.....	4766
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 50, datë 17.2.2021	Mbi miratimin e riemërimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë, të propozuar nga OST sh.a.....	4768
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 51, datë 17.2.2021	Mbi miratimin e kontratës ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”.....	4769

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 52, datë 17.2.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 15.12.2020 dhe përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 15.12.2020.....	4771
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 53, datë 17.2.2021	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 15.12.2020, dhe përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221, datë 15.12.2020.....	4773
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 40, datë 27.1.2021	Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a.....	4774
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 53, datë 4.2.2021	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Patos sh.a.....	4776
Vendimi i shkurtuar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 8823, datë 26.2.2021	Me objekt hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k.....	4780



LIGJ
Nr. 20/2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 44/2012, “PËR
SHËNDETIN MENDOR”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas pikës 9, të nenit 3, shtohen pikat 9/1 dhe 9/2 me këtë përmbajtje:

“9/1 “Shtrim i vullnetshëm” është shtrimi në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër i një personi me çrregullime të shëndetit mendor, me qëllim ofrimin e kujdesit të duhur shëndetësor dhe trajtimin e nevojshëm pas dhënies së miratimit të informuar.

9/2. “Shtrim i pavullnetshëm” është shtrimi i një personi që vuan nga një çrregullim serioz i shëndetit mendor, që kryhet pa miratimin e tij dhe konfirmohet nëpërmjet një vendimi gjyqësor.”.

Neni 2

Në nenin 10, pas shkronjës “d”, të pikës 1, shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) shërbime për fëmijët”.

Neni 3

Pas nenit 14 shtohet neni 14/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 14/1

Shërbime të shëndetit mendor për fëmijët

1. Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët ofrohen nga Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.

2. Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët është një institucion publik qendror i specializuar, që ofron edhe shërbime të specializuara të shëndetit mendor për fëmijët, në funksion të ruajtjes dhe të përmirësimit të shëndetit mendor të tyre, me qëllim mirërritjen, zhvillimin e fëmijës, diagnostikimin dhe trajtimin, si dhe rehabilitimin e paaftësisë.

3. Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 4

Në titullin e kreut III dhe në nenin 15 hiqen fjalët: “dhe adoleshentët”.

Neni 5

Pika 1, e nenit 16, ndryshohet si më poshtë:

“1. Kujdesi në familje realizohet nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, që kujdesen për personat me çrregullime të shëndetit mendor, nga organet e pushtetit vendor dhe nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në këtë fushë, në bashkëpunim me vetë personin me çrregullime të shëndetit mendor dhe familjen e tij, si dhe ndihmësin personal sipas legjislacionit në fuqi. Kujdesi në familje nënkupton mbështetjen psikologjike, psiko-pedagogjike, shërbimet e ndihmës personale ose familjare, si dhe mbështetjen me pagesa dhe shërbime sipas legjislacionit përkatës.”.

Neni 6

Në titullin e kreut V, përpara fjalës “Trajtimi” shtohen fjalët “Shtrimi dhe”.

Neni 7

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Trajtimi i vullnetshëm

1. Personi me çrregullime të shëndetit mendor, i shtruar në mënyrë të vullnetshme në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, merr trajtim të vullnetshëm pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht informimi paraprak. Miratimin për të miturit e lëshon kujdestari ose përfaqësuesi i tyre ligjor.



2. Miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet ofrimit të informacionit të plotë dhe të përshtatshëm ndaj pacientit për natyrën, qëllimin dhe efektet e ndërhyrjes terapeutike të propozuar, e dokumentuar në formularin tip të miratimit të informuar të trajtimit të vullnetshëm, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit. Pacienti firmos për dhënien e miratimit si në kartelë, ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar.

3. Personi me çrregullime të shëndetit mendor, kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor kanë të drejtë të kërkojnë ndërprerjen, refuzimin ose të ankohen për trajtimin në çdo moment të procesit, gjë e cila mund të kundërshtohet vetëm kur përbushen kriteret për trajtim të pavullnetshëm.”.

Neni 8

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

Shtrim i vullnetshëm

1. Personi me çrregullime të shëndetit mendor shtrohet në mënyrë të vullnetshme në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, pas lëshimit të miratimit me shkrim nga ana e tij, me kusht informimi paraprak.

2. Miratimi i informuar sigurohet nëpërmjet diskutimit në mënyrë të përshtatshme me pacientin për nevojën e shtrimit të tij me qëllim sigurimin e kujdesit dhe trajtimin e duhur shëndetësor dhe përdorimin e formularit tip të miratimit të informuar, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Përmbajtja e diskutimit dhe formulari i miratimit të informuar janë pjesë e kartelës klinike të pacientit. Pacienti firmos për dhënien e miratimit për shtrim si në kartelë, ashtu edhe në formularin e miratimit të informuar.

3. Personi me çrregullime të shëndetit mendor referohet për në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër pasi ka kryer ekzaminimin paraprak nga mjeku në shërbimet komunitare ose shërbimet ambulatorë të specializuara.

4. Shtrimi i vullnetshëm i një personi me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimin e

shëndetit mendor të specializuar me shtretër nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë.”.

Neni 9

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Trajtimi i pavullnetshëm

1. Subjekt i trajtimit të pavullnetshëm është personi i cili trajtohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, sipas përcaktimit të mjekut specialist.

2. Personi me çrregullime të shëndetit mendor trajtohet në mënyrë të pavullnetshme në rast se plotësohen këto kushte njëkohësisht:

- a) kur ka një çrregullim të rëndë mendor;
- b) nuk ka aftësinë e duhur për të dhënë miratimin e informuar;
- c) trajtimi është i nevojshëm për përmirësimin e gjendjes së shëndetit mendor dhe/ose për të rifituar aftësinë për dhënien e miratimit për trajtimin dhe/ose për të parandaluar përkeqësimin ose dëmtimin e shëndetit të tij ose të tjerëve.

3. Vendimi për trajtim të pavullnetshëm të një personi merret nga mjeku specialist vetëm pasi të ketë kryer personalisht vlerësimin e tij. Personi i sëmurë, familjarët e tij të afërt ose kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje.

4. Procedurat e trajtimit dhe të informimit të pacientit e personave të tjerë të interesuar pasqyrohen në kartelën klinike, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”.

Neni 10

Në nenin 22 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “në nenin 20” zëvendësohen me fjalët “në nenin 24/1”.
2. Në pikat 3 dhe 4 fjala “trajtimin” zëvendësohet me fjalën “shtrimin”.



Neni 11

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Rivlerësimi i trajtimit të pavullnetshëm

1. Shefi i shërbimit, jo më vonë se 24 orë nga vendosja në trajtim të pavullnetshëm, urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes së pacientit dhe planin e tij të trajtimit. Rivlerësimi kryhet nga personeli mjekësor që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të trajtimit të pavullnetshëm.

2. Pas rivlerësimit të gjendjes së pacientit dhe planit të trajtimit të personit subjekt i trajtimit të pavullnetshëm, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit për gjendjen e pacientit dhe nëse është dakord ose jo me planin e tij të trajtimit.

3. Në rast se pas rivlerësimit shefi i shërbimit konstaton se nuk përmbushen kriteret për trajtimin e pavullnetshëm, urdhëron nxjerrjen e menjëhershme të personit nga ky trajtim. Vendimi i shefit të shërbimit dhe arsyet e tij shënohen në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore.

4. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se trajtimi i pavullnetshëm duhet të vazhdohet sipas planit të trajtimit të dakordësuar nga dy vlerësimet e pavarura nga njëra-tjetra, personi vazhdon të trajtohet në mënyrë të pavullnetshme në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda 48 orëve, titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor për të vlerësuar procedurën e kryer. Një kopje e kërkesës u vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor.”.

Neni 12

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Trajtimi i pavullnetshëm me vendim gjykate

1. Gjyqtari i vetëm e shqyrton kërkesën e paraqitur nga titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e trajtimit të pavullnetshëm, duke marrë mendimin e një mjeku specialist të një institucioni të pavarur nga institucioni ku trajtohet personi subjekt i kësaj procedure, si dhe dëgjon personalisht pacientin, jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e saj.

2. Vendimi i gjyqarit të vetëm zbatohet menjëherë nga shërbimi i specializuar i shëndetit mendor me shtretër.

3. Vendimi i gjykatës rishikohet në mënyrë periodike çdo 28 ditë, me kërkesë të titullarit të institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor i specializuar me shtretër.

4. Në çdo çast, kur nuk përmbushen kriteret për trajtimin e pavullnetshëm, titullari i institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, vetë personi me çrregullime të shëndetit mendor, të cilit nuk i është hequr zotësia për të vepruar, subjekt i trajtimit të pavullnetshëm, familjarët ose përfaqësuesi ligjor i tij parashtrojnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.”.

Neni 13

Pas nenit 24 shtohen nenet 24/1, 24/2, 24/3, 24/4 dhe 24/5 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

Shtrimi i pavullnetshëm

1. Subjekt i shtrimit të pavullnetshëm është personi, i cili shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër ose, pasi është shtruar në mënyrë të pavullnetshme, mbahet në mënyrë të pavullnetshme, sipas përcaktimit të mjekut specialist.

2. Subjekt i shtrimit të pavullnetshëm janë edhe personat me çrregullime të shëndetit mendor që nuk kanë zotësi për të vepruar, të cilët nuk japin miratimin e informuar për shtrim në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër.



3. Personi me çrregullime të shëndetit mendor shtrohet në mënyrë të pavullnetshme në rast se plotësohen këto kushte njëkohësisht:

- a) kur ka një çrregullim të rëndë mendor;
- b) personi rrezikon jetën, shëndetin ose sigurinë e vetes ose të tjerëve dhe pa trajtimin e duhur gjendja e shëndetit mendor rrezikon të përkeqësohet;
- c) shtrimi duhet të bëhet për qëllime terapeutike;
- ç) janë shteruar mundësitë ekzistuese për trajtimin shëndetësor në komunitet dhe mjekimi i nevojshëm jepet vetëm nëpërmjet shtrimit në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, në përputhje me parimet e alternativës sa më pak kufizuese.

4. Vendimi për shtrim të pavullnetshëm të një personi me çrregullim të shëndetit mendor merret nga mjeku specialist vetëm pasi të ketë kryer personalisht ekzaminimin e tij. Personi i sëmurë subjekt i shtrimit, familjarët e tij të afërt ose kujdestari ligjor gëzojnë të drejtën të informohen për shkaqet e marrjes së këtij vendimi dhe për të drejtat që pacienti gëzon në këtë gjendje.

5. Shtrimi i pavullnetshëm i një personi me çrregullime të shëndetit mendor në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër nuk mund të shërbejë për asnjë rast për qëllim të shqyrtimit të aftësisë për punë.

6. Procedurat e shtrimit dhe të informimit të pacientit e personave të tjerë të interesuar pasqyrohen në kartelën klinike, e cila miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 24/2

Të drejtat e personit që i nënshtrohet shtrimit të pavullnetshëm

1. Pacientit, që i nënshtrohet shtrimit të pavullnetshëm, i shpjegohen me shkrim brenda 48 orëve arsyet e shtrimit të pavullnetshëm, si dhe informohet për të drejtat dhe detyrimet e tij.

2. Pacienti gjatë veprimeve të shtrimit të pavullnetshëm përfaqësohet personalisht dhe, në rast se gjendja shëndetësore nuk e lejon, nëpërmjet përfaqësuesit ligjor.

3. Pacientit, që i nënshtrohet shtrimit të pavullnetshëm, i garantohet mbrojtje e interesave

të tij për të gjitha veprimet procedurale që kanë lidhje me të.

4. Ndaj vendimit për shtrim të pavullnetshëm mund të bëhet ankim në gjykatë sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24/3

Procedura për trajtimin e pavullnetshëm në shërbimet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër

1. Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm të personit, informon menjëherë personin subjekt të këtij trajtimi, familjarët, si dhe përfaqësuesin ligjor, nëse është i pranishëm. Personi gëzon të drejtën të komunikojë me personat pranë tij ose përfaqësuesin e tij ligjor.

2. Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për trajtimin e pavullnetshëm brenda 24 orëve.

Neni 24/4

Rivlerësimi i shtrimit të pavullnetshëm

1. Shefi i shërbimit, jo më vonë se 24 orë nga shtrimi i pavullnetshëm, urdhëron me shkrim në kartelën mjekësore rivlerësimin e gjendjes shëndetësore të personit të shtruar në mënyrë të pavullnetshme. Rivlerësimi kryhet nga personeli mjekësor që nuk ka marrë pjesë në procedurën fillestare të shtrimit.

2. Pas rivlerësimit të gjendjes shëndetësore, personeli mjekësor plotëson kartelën mjekësore me të gjitha shënimet e nevojshme dhe referon pranë shefit të shërbimit nëse shtrimi i pavullnetshëm është i bazuar apo i pabazuar, ose kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte të tilla.

3. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte shtrimi të pavullnetshëm, urdhëron nxjerrjen e menjëhershme të personit nga shtrimi i pavullnetshëm. Vendimi i shefit të shërbimit dhe arsyet e tij shënohen në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore.



4. Në rast se pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se nuk kanë rënë shkaqet që personi të mbahet në kushte shtrimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të mbahet në mënyrë të pavullnetshme në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda 48 orëve, titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor për të vlerësuar procedurën e kryer. Një kopje e kërkesës u vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor.

Neni 24/5

Shtrimi i pavullnetshëm me vendim gjykate

1. Gjyqtari i vetëm e shqyrton kërkesën e paraqitur nga titullari i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, për vlerësimin e shtrimit të pavullnetshëm duke marrë mendimin e një mjeku specialist të një institucioni të pavarur nga institucioni ku është shtruar, si dhe dëgjion personalisht pacientin, jo më vonë se 48 orë nga paraqitja e saj.

2. Vendimi i gjyqtarit të vetëm zbatohet menjëherë nga shërbimi i specializuar i shëndetit mendor me shtretër.

3. Vendimi i gjykatës rishikohet në mënyrë periodike çdo 28 ditë, me kërkesë të titullarit të institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër.

4. Në çdo çast, kur kanë rënë shkaqet shëndetësore që çuan në shtrim të pavullnetshëm, titullari i institucionit ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me shtretër, vetë personi me çrregullime të shëndetit mendor, subjekt i shtrimit të pavullnetshëm, familjarët ose përfaqësuesi ligjor i tij parashtrajnë në gjykatën kompetente kërkesën për revokimin e vendimit të gjykatës.”.

Neni 14

Në pikën 1, të nenit 34, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “b”, pas fjalëve “nenit 19” shtohen fjalët “dhe nenit 19/1”.

2. Në shkronjën “c”, pas fjalëve “nenit 20” shtohen fjalët “dhe pika 4, e nenit 24/1”.

3. Në shkronjën “ç”, pas fjalëve “nenit 22” shtohen fjalët “dhe pikës 2, të nenit 24/3”.

4. Në shkronjën “d”, pas fjalëve “nenit 23” shtohen fjalët “dhe pikës 4, të nenit 24/4”.

Neni 15

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 3, të nenit 14/1 të ligjit.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 19, të pikës 2, të nenit 19/1, të pikës 4, të nenit 20 dhe të pikës 6, të nenit 24/1 të ligjit.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.2.2021

Shpallur me dekretin nr. 11987, datë 4.3.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 11987, datë 4.3.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 20/2021, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012, ‘Për shëndetin mendor’, të ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**



LIGJ
Nr. 22/2021

PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË
KONTRATËS “PËR PRODHIMIN DHE
SHPËRNDARJEN E KARTAVE TË
IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE
ELEKTRONIKE” NDËRMJET
MINISTRISË SË BRENDSHME TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
GRUPIMIT MORPHO DHE FONDIT
SHQIPTARO-AMERIKAN TË
NDËRMARRJEVE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet shtesa e kontratës “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.2.2021

Shpallur me dekretin nr. 11988, datë 4.3.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

SHITESË E KONTRATËS SË
KONCESIONIT

PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN
E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË
PASAPORTAVE ELEKTRONIKE”, DATË 21
KORRIK 2008, E NDRYSHUAR, NDËRMJET
MINISTRISË SË BRENDSHME TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRISË KONCESIONARE ALEAT
SHPK, E NËNSHKRUAR NË TIRANË MË
24.12.2020

Pasqyra e lëndës

1. Shtesa e kontratës së koncesionit

2. Shtojcat

- Shtojca 23 (Procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale të Verifikimit të Identitetit *e-Aleat*)

- Shtojca 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç)

Kjo shtesë (në vijim e referuar si “Shtesa e Kontratës”) e Kontratës së Koncesionit (në vijim e referuar si “Kontrata”) lidhet më 24.12.2020, në Tiranë, Shqipëri, ndërmjet:

Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë (në vijim e referuar si “Autoriteti”) e përfaqësuar me tagra të plota nga ministri i Brendshëm z. Bledar Çuçi, dhe

Shoqërisë koncesionare “ALEAT” sh.p.k. (në vijim e referuar si “ALEAT” ose “Shoqëria Koncesionare”), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që vepron në përputhje me ligjin shqiptar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 18.8.2008, me numrin unik të identifikimit të subjektit NUIS K82018015V, me seli në adresën rruga “Xhanfize Keko”, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar me tagra të plota në këtë Shtesë Kontrate nga z. Jean-Alain Jouan, në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Shoqërisë Koncesionare

Duke pasur parasysh se:

A. Autoriteti ka lidhur me Koncesionarin (grupimi i subjekteve i përbërë nga “Idemia Identity & Security”, France, dhe Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve) Kontratën e koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” (në vijim e referuar si “Koncesioni” ose “Kontrata e Koncesionit”), e



ratifikuar me ligjin nr. 9972, datë 28.7.2008, e ndryshuar më datë 13 korrik 2010 dhe e ratifikuar me ligjin nr. 10322, datë 23.9.2010, dhe më pas e ndryshuar më datë 19 mars 2013 dhe e miratuar me ligjin nr. 129/2013, datë 25.4.2013.

B. Në përputhje me Kontratën e Koncesionit, Koncesionare ka themeluar shoqërinë koncesionarë “ALEAT” sh.p.k., e cila zbaton Kontratën e Koncesionit, të ndryshuar;

C. Me qëllim përmirësimin e Shërbimeve nëpërmjet Platformës *e-Trust*, Palët bien dakord të përdorin Shërbimet Digjitale për Verifikimin e Identitetit në procesin e aplikimit për dokumentet e identitetit, në përputhje me ligjin nr. 9880, datë 25.2.2008, “Për nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, dhe specifikimet e shtojcës 23 (Procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit *e-Aleat*), e cila do të bëhet pjesë përbërëse e Kontratës së Koncesionit.

D. Gjithashtu, Parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, të ndryshuar’”, i cili parashikon se karta e identitetit lëshohet pa afat për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç.

E. Autoriteti i ka kërkuar Shoqërisë Koncesionare të zbatojë ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020 “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, të ndryshuar”, si edhe në vijim të takimeve dhe të komunikimeve të vazhdueshme mes Palëve, nëpërmjet shkresës datë 15.10.2020, nr. prot. JAJ/ 20-0948, Shoqëria Koncesionare i ka paraqitur autoritetit dy zgjidhje teknike të ndryshme (një zgjidhje të shpejtë dhe një zgjidhje komplekse që kërkon kohë, angazhim teknik dhe financiar), duke konsideruar se sistemi është projektuar dhe zbatuar për të prodhuar një dokument identiteti prej polikarbonati (i skalitur me lazer dhe me çip të brendshëm) me një jetëgjatësi të kufizuar për një periudhë maksimale deri në 10 vjet dhe nuk ka zgjidhje teknike dhe teknologji të realizueshme që mundëson lëshimin e një karte identiteti biometrike me certifikatë të kualifikuar dhe të besueshme (për një periudhë kohore të pakufizuar), në përputhje, gjithashtu, edhe me standardet ndërkombëtare të industrisë dhe zgjidhjet teknike të zbatuara në vendet e tjera të BE-së.

F. Autoriteti ka rënë dakord të zbatojë një zgjidhje të shpejtë që konsiston vetëm në një ndryshim vizual të afatit të vlefshmërisë të kartave të identitetit që do të lëshohen për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç, sipas korrespondencës që përmendet në paragrafin E të këtyre parashtrësave, e pasqyruar në këtë Shtesë Kontrate dhe në shtojcën e re 24 (karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç), e cila do të bëhet pjesë përbërëse dhe thelbësore e Kontratës së Koncesionit.

Për sa më sipër, Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

1.1 Neni 1.5 i Kontratës së Koncesionit ndryshohet si më poshtë vijon:

“1.5 Për shmangien e çdo dyshimi, nëse ka ndonjë kontradiktë ndërmjet neneve dhe shtojcave apo dokumenteve të tjera të referuara në këtë Marrëveshje, kontradikta do të zgjidhet duke i dhënë gjithmonë përparësi neneve, shtojcës 1 (Përkufizimet), shtojcës 4 (Përmirësime të miratuara të shtojcave 2 dhe shtojcave 3), shtojcës 11 (Aspektet financiare), shtojcës 23 (Procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit *e-Aleat*) dhe shtojcës 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç).”.

1.2 Shtojca 23 (Procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit *e-Aleat*) dhe shtojca 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) shtohen si shtojca të reja të Kontratës së Koncesionit.

Neni 2

2.1 Palët bien dakord se, në përputhje me termat dhe kushtet e Kontratës së Koncesionit dhe të shtojcave të saj, qëllimi i kësaj shtese të Kontratës është:

2.1.1 Të përmirësojë procesin e aplikimit për prodhimin dhe lëshimin e dokumenteve të identitetit nëpërmjet përdorimit të dokumentit elektronik dhe Shërbimit të Nënshkrimit Elektronik të Kualifikuar, si pjesë e Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit të ofruara nga Shoqëria Koncesionare, sipas Koncesionit, në përputhje me specifikimet e shtojcës 23 (Procesi i



aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit *e-Aleat*;

2.1.2 Të adaptojë një zgjidhje teknike dhe ligjore të realizueshme për zbatimin e ligjit nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë, të ndryshuar’, siç detajohet në shtojcën 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç).

Neni 3

Hyrja në fuqi dhe Data Efektive

3.1 Kjo Shtesë Kontrate do të hyjë në fuqi me hyrjen në fuqi të ligjit të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë që e miraton atë.

3.2 Në rast se Data Efektive nuk ndodh brenda një periudhe prej 120 (njëqind e njëzet) ditëve pune nga data e nënshkrimit të kësaj Shtese Kontrate nga Palët, secila Palë ka të drejtë të zgjidhë këtë Shtesë Kontrate duke i dhënë një njoftim për përfundim Palës tjetër të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara. Pas marrjes së këtij njoftimi për përfundim, Palët nuk do të kenë të drejta apo detyrime të tjera, sipas kësaj Shtese Kontrate, përveç të drejtave dhe detyrimeve që shprehimisht njihen dhe respektohen edhe pas zgjidhjes së kësaj Shtese Kontrate.

3.3 Palët bien dakord se parashikimet e kësaj Shtese Kontrate dhe e shtojcave të saj do të kenë epërsi, në rast se do të ketë mospërputhjeje mes këtyre dokumenteve dhe parashikimeve të Kontratës së Koncesionit.

3.4 Për çdo çështje tjetër që nuk rregullohet nga kjo Shtesë Kontrate dhe shtojcat e saj do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kontratës së Koncesionit.

Për sa më sipër, Palët dhe përfaqësuesit përkatës të tyre e nënshkruajnë rregullisht këtë Shtesë Kontrate.

**Për Ministrinë e
Brendshme të
Republikës së
Shqipërisë:**

Z. Bledar Çuçi Ministër

**Për Shoqërinë
Koncesionare
“ALEAT” sh.p.k.**

Z. Jean-Alain Jouan
Drejtor i përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PRODIMI DHE SHPËRNDARJA E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE E PASAPORTAVE BIOMETRIKE

PËRMIRËSIMI I PROCESIT TË REGJISTRIMIT PËRMES SHËRBIMEVE DIGJITALE TË IDENTITETIT *e-ALEAT*

TABELA E LËNDËS

1. HYRJE

1.1 Përkufizime

1.2 Qëllimi projektit

1.3 Shërbimet që do të përdoren për projektin: Shërbime *e-ALEAT*

1.4 Vlefshmëria e dokumenteve të nënshkruara me nënshkrim elektronik të kualifikuar

2. PROCESI I REGJISTRIMIT DHE INTEGRIMI ME *E-SERVICE*

2.1 Procesi aktual i regjistrimit

2.1.1 Faza e regjistrimit

2.1.2 Produkti

2.1.3 Transferimi

2.2 Procesi i përmirësuar i regjistrimit

2.2.1 Faza e regjistrimit (e pandryshuar)

2.2.2 Produkti

2.2.3 Transferimi

2.2.4 Ndryshimet kryesore dhe pikat e rëndësishme

2.2.5 Impaktet operative

2.3 Plani i implementimit

1. HYRJE

1.1 Përkufizime

Forma e Aplikimit: Marrëveshja ligjore (letër) ndërmjet qytetarit, ALEAT dhe përfaqësuesit të autoritetit.

Zyra aplikimit: Zyra e gjendjes civile ose zyra konsullore.

Autoriteti: Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë.

Përfaqësuesi i autoritetit: Zyrtar i gjendjes civile ose përfaqësuesi i konsullatës CSO: Zyra e gjendjes civile.

Nënshkrimi digjital ose nënshkrimi digjital i kualifikua: Nënshkrimi i dokumentit elektronik nga platformat *e-ALEAT*.

e-Service: Shërbimet elektronike *e-ALEAT* ose platforma *e-TIS*: Platforma për të siguruar Shërbime Digjitale Identiteti.



Dokumente Identiteti: Kartat e identitetit ose pasaportat biometrike.

MEFA: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

MEVA: Aplikimi i verifikimit të regjistrimit MORPHO.

Mol: Ministria e Brendshme.

NCR: Regjistri Civil Kombëtar.

Dokumentet mbështetëse: Formulari i policisë, raporti i policisë për dokumentin e humbur/të vjedhur.

1.2 Qëllimi projektit

Aleat është Shoqëria Koncesionare e konsorciumit midis IDEMIA (*Identity & Security*, më parë *Sagem Security*) dhe Fondit Shqiptaro-Amerikane të Ndërmarrjeve (AAEF), që ofron Shërbimet “Prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike” për shtetasit shqiptarë.

Sipas kontratës për zgjatjen dhe përmirësimin e Kontratës së Koncesionit, ALEAT është zotuar të implementojë disa teknologji të reja, në mënyrë që të përmirësojë procesin e prodhimit dhe, në veçanti, të rimodelojë procesin e regjistrimit. Qëllimi i këtij *upgrade* është që të përmirësojë procesin e punës, duke përdorur teknologjinë më të fundit digjitale.

Kjo teknologji e re (MEVA) është zhvilluar, testuar dhe certifikuar nga IDEMIA përgjatë vitit 2019.

Disa stacione pune MEVA janë instaluar si pilot dhe janë testuar nga ALEAT në disa CSO në Shqipëri gjatë tremujorit të fundit të vitit 2019,

Hapi i fundit është implemetimi në të gjitha zyrat e aplikimeve në Shqipëri dhe jashtë vendit. Para se ky proces i zgjeruar të implementohet, nënshkrimi digjital duhet të aprovohet për regjistrim.

1.3 Shërbimet që do të përdoren për Projektin: Shërbime *e-ALEAT*

Shërbimet *e-ALEAT* janë shërbimet e reja për identitetin të ofruara nga ALEAT, përmes një platforme të sigurt, që siguron besueshmërinë e identitetit për çdo transaksion elektronik. Shërbimet e identitetit digjital *e-ALEAT* sigurojnë qeverinë dhe bizneset që shërbimet t'i ofrohen personit të duhur, duke shtuar biometrinë si veçori të sigurisë së lartë dhe një PIN personal të sigurt. Shërbimet e identitetit digjital të përdorura për regjistrim janë:

- Shërbimi i Identifikimit (autentifikimi dhe identifikimi);

- Shërbimi i Nënshkrimit Digjital të Kualifikuar (nënshkruan dokumente në mënyrë elektronike dhe legale).

1.4 Vlefshmëria e dokumenteve të nënshkruara me nënshkrim elektronik të kualifikuar

Shoqëria Koncesionare ka zbatuar platformën *e-Trust* dhe Shërbimin e Nënshkrimit Elektronik të Kualifikuar, me qëllim përdorimin e dokumenteve elektronike të nënshkruara me Nënshkrim Elektronik të Kualifikuar, të cilat kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore me dokumentet e nënshkruara në formë shkresore, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Palët njohin dhe bien dakord se *e-Shërbimet*, që përdoren në procesin e aplikimit mbështeten dhe bazohen në vlefshmërinë e plotë ligjore të dokumentit elektronik të nënshkruar me nënshkrim elektronik të kualifikuar, i cili ka të njëjtën vlefshmëri ligjore me dokumentin e nënshkruar në formë shkresore, dhe çdo ndryshim në ligj që do të ndikojë në këtë vlefshmëri ligjore do të prekë zbatimin e procesit të aplikimit nëpërmjet *e-Shërbimeve* deri në ndërprerjen e tyre, në rast se dokumenti elektronik i nënshkruar me nënshkrim elektronik të kualifikuar nuk do të ketë të njëjtën vlefshmëri ligjore me dokumentin e nënshkruar në formë shkresore.

Çdo dokument elektronik, përfshirë formularin e aplikimit dhe dokumentacionin shoqërues, i nënshkruar me nënshkrim elektronik të kualifikuar do të ketë të njëjtën vlefshmëri ligjore me dokumentin e nënshkruar në formë shkresore dhe do të përbëjë provë të plotë përpara çdo autoriteti publik, institucioni, organizate, gjykate, prokurori, autoritet e policisë dhe çdo autoriteti tjetër, subjekte juridike private apo individë, dhe do të zëvendësojë dokumentet shkresore, në përputhje me specifikimet e shtojcës 23 (Procesi i aplikimit i përmirësuar nëpërmjet Shërbimeve Digjitale për Verifikimin e Identitetit *e-ALEAT*) e Kontratës së Koncesionit.

Palët bien dakord se procesi i aplikimit i përmirësuar përmes Shërbimeve të Identitetit Digjital *e-ALEAT* kryhet në përputhje me shtojcën 4 (Përmirësimet e rena dakord në shtojcat 2 dhe 3) dhe shtojcën 11 (Aspektet financiare) të Kontratës së Koncesionit të ndryshuar. Palët bien dakord se ALEAT do të përballojë kostot në lidhje me



mirëmbajtjen e platformës *e-Trust*, në mënyrë që të sigurojë procesin e regjistrimit të përmirësuar përmes Shërbimeve të Identitetit Digjital *e-Aleat*, në përputhje me Kontratën e Koncesionit.

2. PROCESI REGJISTRIMIT DHE INTEGRIMI ME *e-SERVICE*

2.1 Procesi aktual i regjistrimit

Procesi i prodhimit të dokumenteve të identifikimit është vendosur në të gjitha zyrat e aplikimit në Shqipëri dhe jashtë vendit dhe ofron kartat e identitetit, pasaportat biometrike dhe shërbimet elektronike për qytetarët shqiptarë, sipas Kontratës së Koncesionit dhe amendamenteve të saj. Faza e regjistrimit, pjesë e procesit të prodhimit, përshkruhet më poshtë.

2.1.1 Faza e regjistrimit

Faza e regjistrimit konsiston në mbledhjen e të dhënave vijuese:

- a) të dhëna alfanumerike të verifikuara nga përfaqësuesi i autoritetit dhe importuar nga NCR-ja;
- b) të dhënat biometrike (gjurmët e gishtit, portreti, nënshkrimi elektronik ...);
- c) dokumentet e mëparshme të identitetit (bandë MRZ e pasaportës së mëparshme, kartën e identitetit të shënjuar) ose dokumentet mbështetëse.

2.1.2 Produkti:

- a) Formulari i aplikimit (letra) e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i autoritetit dhe qytetari;
- b) skedari digjital që përmban të dhëna alfanumerike dhe biometrike;
- c) dokumente identifikimi të pavlefshme ose dokumente mbështetëse.

2.1.3 Transferimi:

- a) formulari i aplikimit, me postë (ALEAT për CSO-në ose konsull i përgjithshëm i Ambasadës për Zyrën e Konsullatës);
- b) të dhënat elektronike të koduara: *online* (ALEAT për CSO) ose *offline* me CD të dërguar me postë (konsulli i përgjithshëm i Ambasadës për Zyrën e Konsullatës);
- c) dokumente identiteti të pavlefshme ose dokumente mbështetëse, me postë (ALEAT për CSO ose Konsull i Përgjithshëm i Ambasadës për Zyrën e Konsullatës).

2.2 Procesi i përmirësuar i regjistrimit

2.2.1 Faza e regjistrimit (e pandryshuar)

Faza e Regjistrimit konsiston në mbledhjen e të dhënave vijuese:

- a) të dhëna alfanumerike të verifikuara nga përfaqësuesi i autoritetit dhe importuar nga NCR-ja;
- b) të dhënat biometrike (gjurmët e gishtit, portreti, nënshkrimi elektronik ...);
- c) dokumentet e mëparshme të identitetit (bandë MRZ e pasaportës së mëparshme, kartën e identitetit të shënjuar) ose dokumentet mbështetëse.

2.2.2 Produkti:

- a) formulari i aplikimit (letra) e nënshkruar dhe vulosur nga përfaqësuesi i autoritetit dhe qytetari (*);
- b) skedari digjital që përmban të dhëna alfanumerike dhe biometrike;
- c) dokumente identifikimi të pavlefshme ose dokumente mbështetëse (*).

Shënim (*). Formulari i aplikimit dhe dokumenti bashkëngjitur e tij do të skanohen dhe i gjithë dokumenti do të nënshkruhet elektronikisht me një nënshkrim të kualifikuar digjital.

2.2.3 Transferimi

- a) të dhënat elektronike të koduara përmes një lidhjeje të sigurt në internet;
- b) formulari i aplikimit me dokumentet e bashkëngjitur, nënshkruar elektronikisht, në internet përmes një lidhjeje të sigurt.

2.2.4 Ndryshimet kryesore dhe pikat e rëndësishme

- ALEAT do të filloj prodhimin e dokumentit të ID-së pa marrë formularin e aplikimit në letër dhe dokumentet e tjera të mëparshme të pavlefshme ose mbështetëse.

- Dokumentet e skanuar të nënshkruara me nënshkrimin digjital të kualifikuar do të kenë të njëjtën vlefshmëri si dokumentet origjinale në letër, ato do të bëhen një kopje e kualifikuar elektronike, duke zëvendësuar origjinalin e nënshkruar elektronikisht nga një përfaqësues i autoritetit.

- Një lidhje e re e sigurt e instaluar midis secilës zyre aplikimi dhe ALEAT-it. Kjo lidhje do të sigurojë transferimin e të dhënave dhe format e nënshkruar elektronikisht në ALEAT.

- Parakusht për t'u përmbushur: Letrën zyrtare nga autoriteti që identifikon përfaqësuesin e autoritetit me kartat e vlefshme të identitetit (certifikatë të aktivizuar) për secilën zyrë të aplikimit që do të ngarkohet në sistem.

2.2.5 Impaktet operative

- Formularët e aplikimit në letër dhe dokumentet e identifikimit të pavlefshme të tyre



ose dokumentet mbështetëse do të mbahen përkohësisht në zyrat e aplikimit.

- Ruajtja e dokumenteve të lartpërmendura do të bëhet në zyrën e aplikimit dhe do të shkatërrohet periodikisht në vend ose do të merret nga ALEAT për shkatërrim të sigurt fizik.

- Në rast të problemeve operacionale, siç janë (interneti, *software* ose platforma jashtë funksioni, lista nuk është gjithëpërfshirëse) do të kalohet nga mënyra *online* në atë *offline* dhe regjistrimi mund të bëhet, pas marrëveshjes me ALEAT, sipas procesit aktual (§2.1), në mënyrë që të vazhdojë të ofrohet shërbimi për qytetarin.

2.3 Plani i implementimit

Procesi i përmirësuar i regjistrimit përmes *e-Tis* platformës do të implementohet gradualisht dhe do të vendoset sipas planit paraprak:

1. Implementimi i sistemit të ri (*hardware* dhe *software*) në të gjitha ambasadat gjatë një periudhe dymujore (2-mujore).

2. Një (1) muaj pas nënshkrimit të amendamentit të kontratës, testimi në një zyrë aplikimesh (vendet kufitare - Selanik) do të kryhet gjatë një periudhe njëmuajore (1-mujore).

3. Implementimi në të gjitha ambasadat në vendet kufitare gjatë një periudhe dymujore (2-mujore).

4. Implementimi në të gjitha ambasadat e vendeve evropiane gjatë një periudhe katërmujore (4-mujore).

5. Implementimi në të gjitha zyrat e tjera të aplikimit në Shqipëri gjatë një periudhe dymujore (2-mujore).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PRODHIMI DHE SHPËRNDARJA E KARTAVE TË IDENTITETIT DHE E PASAPORTAVE BIOMETRIKE

KARTA E IDENTITETIT PËR SHTETASIT QË MBUSHIN MOSHËN 75 VJEÇ

TABELA E LËNDËS

1. HYRJE

1.1 Përkufizime

1.2 Qëllimi i zgjidhjes për lëshimin e kartës së identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç

2. ZBATIMI I ZGJIDHJES PËR LËSHIMIN E KARTAVE TË IDENTITETIT PËR SHTETASIT QË MBUSHIN MOSHËN 75 VJEÇ

3. SPECIMENI I KARTËS SË IDENTITETIT PËR SHTETASIT QË MBUSHIN MOSHËN 75 VJEÇ

1. HYRJE

1.1 Përkufizime

Forma e aplikimit: Marrëveshja ligjore (letër) ndërmjet qytetarit, ALEAT-it dhe përfaqësuesit të autoritetit;

Zyra aplikimit: Zyra e gjendjes civile ose zyra konsullore.

Autoriteti: Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë.

Përfaqësuesi i autoritetit: Zyrtar i gjendjes civile ose përfaqësuesi i konsullatës.

CSO: Zyra e gjendjes civile.

Nënshkrimi digjital ose nënshkrimi digjital i kualifikuar: Nënshkrimi i dokumentit elektronik nga platforma *e-ALEAT*.

e-Service: Shërbimet elektronike.

e-ALEAT ose platforma e-TIS: Platforma për të siguruar shërbime digjitale identiteti.

Dokumente identiteti: Kartat e identitetit ose pasaportat biometrike.

MEVA: Aplikimi i verifikimit të regjistrimit MORPHO.

Mol: Ministria e Brendshme.

NCR: Regjistri Civil Kombëtar.

Dokumentet mbështetëse: Formulari i policisë, raporti i policisë për dokumentin e humbur/vjedhur.

1.2 Qëllimi i zgjidhjes për lëshimin e kartës së identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç

Aleat është Shoqëria Koncesionare e konsorciumit midis IDEMIA (*Identity & Security*, më parë *Sagem Security*) dhe Fondit Shqiptaro-Amerikane të Ndërmarrjeve (AAEF), që ofron Shërbimet “Prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave biometrike” për shtetasit shqiptarë. Parlamenti shqiptar ka miratuar ligjin nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar”, i cili parashikon se karta e identitetit lëshohet pa afat për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç. Me qëllim zbatimin e ligjit të sipërpërmendur, Palët kanë rënë dakord të zbatojnë një zgjidhje të shpejtë që konsiston vetëm në një ndryshim vizual të afatit të



vlefshmërisë së kartës së identitetit që do të lëshohet për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç.

2. ZBATIMI I ZGJIDHJES PËR LËSHIMIN E KARTAVE TË IDENTITETIT PËR SHTETASIT QË MBUSHIN MOSHËN 75 VJEÇ

2.1 Palët njohin dhe bien dakord, se në përputhje me parashikimet e Kontratës së Koncesionit dhe të shtojcave të saj, sistemi është projektuar dhe zbatuar nga shoqëria koncesionare për të prodhuar një dokument biometrik polikarbonati të skalitur me lazer (me çip të brendshëm që përmban *e-Certifikatat* dhe të dhënat e tjera përkatëse) me një jetëgjatësi maksimale prej 10 (dhjetë) vjetësh, jetëgjatësi, e cila ndikon edhe vlefshmërinë e *e-Certifikatave* dhe MRZ-në e kartave të identitetit. Për këtë arsye dhe duke marrë parasysh kufizimet teknologjike dhe teknike, karta e identitetit që do të lëshohet për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç do të jetë objekt i specifikimeve dhe i kushteve të detajuara në shtojcën 24 (karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç).

2.2 Autoriteti angazhohet që të informojë në mënyrën e duhur shtetasit dhe të fillojë një fushatë ndërgjegjësimi për specifikat dhe përdorimin e kartës së identitetit që do të lëshohet për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç, përfshirë specifikimet dhe kushtet e kësaj karte, në përputhje me parashikimet e kësaj shtese kontrate dhe të shtojcës së saj 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç).

2.3 Na përputhje me dispozitat e këtij skeduli, autoriteti merret ekskluzivisht me të gjitha kërkesat, ankesat ose pretendimet eventuale, që mund të ngrihen nga qytetarët dhe/ose subjektet e tjera në lidhje me modelin e rënë dakord (periudha e vlefshmërisë dhe rinovimi i letërnjoftimit të lëshuar për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç), për sa i përket përputhshmërisë me dispozitat ligjore në fuqi.

2.4 Palët bien dakord se vlefshmëria dhe zbatimi i kësaj shtese kontrate dhe i shtojcës së saj 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) janë në çdo rast të lidhura dhe me qëllim vënien në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar”.

Çdo ndryshim i mundshëm në ligj që do të prekë parashikimet e ligjit nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar”, do të ketë efekt përkatësisht edhe në parashikimet e kësaj shtese kontrate dhe të shtojcës së saj 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) dhe do të jetë objekt i marrëveshjes me shkrim mes Palëve.

2.5 Palët bien dakord se duke deroguar shprehimisht parashikimet e Kontratës së Koncesionit dhe të shtojcave të saj dhe me qëllim zbatimin e ligjit nr. 89/2020, datë 9.7.2020, “Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar”, zgjidhja teknike dhe ligjore që do të vihet në zbatim nga shoqëria koncesionare vetëm për lëshimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç do të jetë si më poshtë vijon:

2.5.1 Shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç dhe që do të rinovojnë kartën e tyre të identitetit apo që do të aplikojnë për një kartë të re identiteti do të pajisen me një kartë identiteti që do të ketë një afat vlefshmërie prej 50 (pesëdhjetë) vjetësh;

2.5.2 Karta e identitetit që do të lëshohet shtetasve që mbushin moshën 75 vjeç do të ketë material përbërës, komponent, grafikë dhe strukturë të njëjtë me kartën e identitetit që prodhohet dhe lëshohet nga Shoqëria Koncesionare sipas Kontratës së koncesionit dhe shtojcave të saj dhe në çdo rast do të ketë një jetëgjatësi maksimale prej 10 (dhjetë) vjetësh. Një specimen i kartës së identitetit që do të lëshohet për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç i bashkëlidhet kësaj shtojce 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) të Kontratës së Koncesionit.

2.5.3 *E-Certifikatat* e vendosura në çipin e kartës së identitetit do të kenë një afat vlefshmërie prej 10 (dhjetë) vjetësh, në përputhje me kërkesat e *e-IDAS*, pavarësisht se vlefshmëria e kartës së identitetit do të jetë për 50 (pesëdhjetë) vjet. Çdo *e-Shërbim* që do të ofrohet në lidhje me kartën e identitetit është i kushtëzuar me vlefshmërinë e *e-Certifikatave*. Me skadimin e *e-Certifikatave*, shtetasit që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe që kërkojnë të përdorin *e-Shërbimet* do të aplikojnë për një kartë të re identiteti. Nëse do të jetë e nevojshme, autoriteti do të përballojë ekskluzivisht të gjitha



kostot për rastet e shtetasve që kanë mbushur moshën 75 vjeç dhe që kanë riaplikuar apo rinovuar kartë e tyre të identitetit, në përputhje me parashikimet e kësaj shtese kontrate dhe të shtojcës 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) të Kontratës së Koncesionit.

2.5.4 Të dhënat elektrike që ndodhen në çipin e kartës së identitetit dhe MRZ-ja do të kenë një afat maksimal vlefshmërie prej 10 (dhjetë) vjetësh, i cili nuk mund të zgjatet përtej kësaj periudhe. Karta e identitetit nuk mund të përdoret si dokument udhëtimi pas 10 vjetësh nga data e lëshimit dhe autoriteti do të informojë në mënyrën e duhur shtetasit se pas 10 vjetësh nga data e lëshimit, Karta

e identitetit nuk do të jetë e vlefshme për të përfituar *e-Shërbimet*, përfshirë identifikimin elektronik, dhe as mund të përdoret si dokument ndërkombëtar udhëtimi, në përputhje me parashikimet e kësaj shtese kontrate dhe të shtojcës 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) të Kontratës së Koncesionit.

2.6 Palët bien dakord se karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç, në përputhje me parashikimet e kësaj shtese kontrate dhe të shtojcës 24 (Karta e identitetit për shtetasit që mbushin moshën 75 vjeç) të Kontratës së Koncesionit, do të vihet në zbatim brenda 2 (dy) muajve nga data efektive e shtesës së kontratës.

3. SPECIMENI I KARTËS SË IDENTITETIT PËR SHITETASIT QË MBUSHIN MOSHËN 75 VJEC



**DEKRET****Nr. 11988, datë 4.3.2021****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 22/2021, “Për miratimin e shtesës së kontratës ‘Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike’, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

**LIGJ
Nr. 23/2021**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË TURQISË, MBI
DHURIMIN NË FUSHËN E
SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 22.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11989, datë 4.3.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

**MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË
MBI DHURIMIN NË FUSHËN E
SHËNDETËSISË**

Qeveria e Republikës së Turqisë dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë (në tekstin e mëposhtëm referuar si “Palët”) kanë rënë dakord për sa vijon, në lidhje me spitalin që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri, dhe dhurimin e materialeve nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë për t’u përdorur në këtë spital.

**Neni 1
Angazhimi i palëve**

Pala turke merr përsipër t’i dhurojë palës shqiptare një spital me 150 shtretër që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri, dhe pajisjet mjekësore, pajisjet, materialet dhe orenditë e renditura në shtojcë për t’u përdorur në spitalin e përmendur për palën shqiptare.

Ky donacion jepet nga Pala Turke, në mënyrë që të forcojë sistemin shëndetësor shqiptar dhe të mbështesë infrastrukturën e kujdesit shëndetësor. Në këtë kontekst, Republika e Turqisë do të caktojë personelin e kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë gjatë fazës së tranzicionit të spitalit në fjalë dhe do të ofrojë këshillim përmes Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Turqisë. Palët, të përfaqësuara nga ministratë e veçanta të shëndetësisë, do të nënshkruajnë një protokoll të veçantë, në lidhje me funksionimin e përbashkët të spitalit, gjatë fazës kalimtare të spitalit.

Palët bien dakord të sigurojnë të gjitha llojet e përjashtimeve nga taksat dhe tarifat dhe të



lehtësojnë nga të gjitha procedurat doganore, të importit dhe taksimit, gjatë transferimit nga Turqia në Shqipëri, të gjitha llojet e pajisjeve mjekësore, pajisjeve, orendive dhe materialeve të ndërtimit, siç sigurohen nga Pala Turke dhe siç tregohet në shtojcën për spitalin me 150 shtretër që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri. Spitali i përmendur duhet të jetë në përputhje me standardet e cilësisë të përcaktuara në legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Furnizimi brenda Shqipërisë përmes prokurimit të mallrave dhe tëshërbimeve për ndërtimin dhe funksionimin deri në datën e dhurimit të spitalit nga Pala Turke për Palën Shqiptare, përjashtohet nga taksa e vlerës së shtuar. Mallrat, materialet dhe pajisjet e importuara nga Pala Turke për ndërtimin dhe funksionimin e spitalit, gjithashtu, përjashtohen nga detyrimet doganore/taksat e tjera dhe TVSH-ja për importet.

Mallrat dhe pasuria e dhuruar dhe të drejtat e tyre të përdorimit nuk do të transferohen nga Pala Shqiptare te një palë e tretë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës Turke.

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Turqisë do të rezervojë të drejtën për të ndërtuar spitalin dhe për të siguruar të gjitha llojet e pajisjeve që do të përdoren gjatë ndërtimit, dhe të gjitha llojet e pajisjeve mjekësore, pajisjeve dhe orendive (përfshirë transferimin) që do të përdoret gjatë ofrimit të shërbimit me anë të lidhjes së kontratave të ndara me kontraktorët turq.

Autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë bien dakord të lehtësojnë procedurat e nevojshme të lejes, licencës etj. për Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës së Turqisë dhe/ose kompanitë kontraktuese që vlerësohen të përshtatshme nga ajo.

Neni 2

Spitali i ndërtuar dhe të gjitha llojet e pajisjeve mjekësore, pajisjeve dhe orendive që do të përdoren në këtë spital do t'i përkasin Palës Shqiptare dhe do të përdoren në spitalin që do të ndërtohet në Fier, Shqipëri.

Neni 3

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të Palëve në çdo

kohë. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me të njëjtën procedurë ligjore të përshkruar në nenin 4, paragrafi i parë.

Neni 4

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Bërë në Ankara, Turqi, më 2.2.2021, në dy kopje origjinale, secila në turqisht, shqip dhe anglisht, duke qenë i gjithë teksti njësoj autentik. Në rast të mosmarrëveshjes së interpretimit, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

Në emër të Qeverisë së
Republikës së Turqisë

Zëvendësministri i
Shëndetësisë
Halil Eldemir

Në emër të Këshillit të
Ministrave të Republikës
së Shqipërisë

Ambasadori i Republikës
së Shqipërisë në Ankara
Kastriot Robo

DEKRET

Nr. 11989, datë 4.3.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 23/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta



LIGJ
Nr. 24/2021

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË (HUAMARRËSI), DHE
KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) PËR
PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS
BASHKIAKE V, NË SHUMËN 80 000 000
(TETËDHJETË MILIONË) EURO**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 2, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.2.2021.

Shpallur me dekretin nr. 11990, datë 4.3.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE HUAJE

E DATËS 18.12.2020, NDËRMJET KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË (HUAMARRËSI), PËR SHUMËN 80,000,000.00 EURO

- PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS
BASHKIAKE V -
BMZ-NR. 2013 66 467
ID E HUAS 29769

TABELA E LËNDËS

1. Huaja
2. Kanalizimi i Huas tek agjencitë e zbatimit të Projektit
3. Disbursimi
4. Tarifat
5. Interesi
6. Shlyerja dhe parapagimi
7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi
8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë
9. Veprimet e kundërligjshme
10. Kostot dhe detyrimet publike
11. Detyrime të veçanta
12. Përfundimi i Marrëveshjes së Huas
13. Përfaqësimi dhe deklaratat
14. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Projektin
15. Dispozita të përgjithshme
- Aneksi 1 Skeduli i disbursimit
- Aneksi 2 Forma e opinionit ligjor të këshilltarit ligjor të Huamarrësit
- Aneksi 3a Zotimet e përputhshmërisë së Huamarrësit
- Aneksi 3b Zotimet e përputhshmërisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit

PREAMBULË

Baza për këtë marrëveshje huaje ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit (“Marrëveshja” ose “Marrëveshja e Huas”) është marrëveshja e datës 11 tetor 2019 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (FC) (Marrëveshja Qeveritare).



Marrëveshja e Huas është pjesë e Programit të Infrastrukturës Bashkiake V (Programi). Programi do të financohet me anë të kësaj Marrëveshjeje Huaje, Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja e grantit për investimin), marrëveshja e grantit e financuar nga SECO (Marrëveshja e grantit SECO), marrëveshja e grantit e financuar nga BE-ja (Marrëveshja e grantit e BE-së) dhe marrëveshja e grantit për masat shoqëruese (Marrëveshja e grantit shoqërues) të gjitha të së njëjtës datë me këtë marrëveshje.

KfW-ja do të rifinancojë huan e dhënë, në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione interesi nga fondet e buxhetit me interes të ulët të siguruara nga Republika Federale e Gjermanisë, për projekte që plotësojnë kriteret e pranueshmërisë për politika zhvillimi. Termat dhe kushtet e huas janë në përputhje me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen e Asistencës Zyrtare të Zhvillimit (ODA).

Mbi këtë bazë dhe sipas kushtit që Republika Federale e Gjermanisë jep një garanci për hua, KfW-ja do të japë një hua, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

1. Huaja

1.1 *Shuma*: KfW do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk tejkalon një total prej 80,000,000.00 euro (Huaja), (me fjalë: tetëdhjetë milionë euro).

1.2 *Qëllimi*: Huamarrësi do të përdorë Huan ekskluzivisht për financimin e Programit.

Në kuadrin e këtij Programi, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Ujësllësit dhe të Kanalizimeve ("Njësia e koordinimit të programit" ose "NJKP"), do të veprojë si njësia e koordinimit të programit për drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të Projektit, si dhe për kontraktimin dhe kryerjen e shërbimeve të konsulencës. Shoqëritë e shërbimeve të ujësllësit UK Berat-Kuçovë, UK Elbasan, UK Fier, UK Kamzë, UK Lezhë, UK Shkodër dhe UK Vlorë do të veprojnë si Agjenci të Zbatimit të Projektit (secila si "AZP", bashkërisht si "AZP-të").

Huamarrësi, nëpërmjet MIE/NJKP-së, në kuadrin e Programit, do të garantojë që AZP-të të përdorin pjesë të fondeve të Huas ekskluzivisht për financimin e investimeve për përmirësimin e sistemeve të ujësllësit dhe të kanalizimeve në qytetin përkatës (secili "Projekt"). Huamarrësi,

nëpërmjet MIE/NJKP-së, përdor pjesën e mbetur të fondeve të Huas për financimin e shërbimeve të konsulencës, në lidhje me zbatimin e Programit.

MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja përcaktojnë detajet e Programit dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja, si dhe shpërndarjen e fondeve të Huas ndërmjet AZP-ve dhe Huamarrësit, duke nënshkruar një marrëveshje të veçantë, e cila do të sigurohet si e pranuar edhe nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Marrëveshja e veçantë).

1.3 *Taksat, tarifat, detyrimet doganore*: Taksat dhe tarifatat e tjera publike që duhet të paguhet nga Huamarrësi ose ndonjë prej AZP-ve, si dhe detyrimet doganore, nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas tek agjencitë e zbatimit të Projektit

2.1 *Marrëveshja e Nënhuas*: Huamarrësi kanalizon fondet e Huas të kërkuara për financimin e masave të investimit të përcaktuara në nenin 1.2 (Fondet e investimit) tek AZP-të. 90% e fondeve të investimit kanalizohen si grante të pashlyeshme me anë të marrëveshjeve të nëngrantit ndërmjet Huamarrësit dhe AZP-së përkatëse (Marrëveshjet e nëngrantit). 10% e fondeve të investimit kanalizohen në formën e huave me anë të Marrëveshjeve të nënhuas (Marrëveshjet e nënhuas), me një afat prej 40 vjetësh, duke përfshirë një periudhë 10-vjeçare pa penalitet (pa pagesë interesi, principali dhe tarifash gjatë kësaj periudhe pa penalitet). Marrëveshja e nënhuas do të jetë në euro dhe interesi do të jetë deri në 1% në vit.

2.2 *Përkthimi i vërtetuar*: Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të secilës prej marrëveshjeve të nëngrantit dhe nënhuas të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 *Mospërgjegjësia e Agjencisë së Zbatimit të Projektit*. Kanalizimi i Huas nuk përbën ndonjë përgjegjësi të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

3. Disbursimi

3.1 *Kërkesa për disbursim*: Sapo të gjitha kushtet, para disbursimit, në zbatim të nenit 3.3 (Kushtet para disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje të përmbushen, KfW-ja do të disbursojë Huan në



përputhje me progresin e Programit dhe me kërkesën e Huamarrësit, nëpërmjet NJKP-së. Disbursimet do të kryhen në përputhje me skedulin e disbursimit që përfshihet në shtojcën 1 (Skeduli i disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo periudhë disbursimi të specifikuar në shtojcën 1. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursim me shuma më të ulëta brenda ndonjë periudhe të tillë, shumat e padisbursuara mund të kërkojnë në secilën prej periudhave vijuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime prej më pak se 200,000.00 eurosh.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimeve:* KfW-ja ka të drejtë të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 dhjetor 2027.

3.3 *Kushtet para disbursimit:* KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje vetëm nëse janë plotësuar kushtet pararendëse të mëposhtme në një mënyrë të pranueshme për KfW-në në formë dhe në përmbajtje:

i) Huamarrësi do të ketë provuar, siç e kërkon KfW-ja, me anë të paraqitjes së një opinionit ligjor, përmbajtja e të cilit është kryesisht në përputhje me modelin në aneksin 2 (Formulari i opinionit ligjor të këshilltarit ligjor të Huamarrësit) të kësaj Marrëveshjeje dhe me anë të paraqitjes së kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje Huaje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor, se Marrëveshja e Huas është ligjërish në fuqi dhe e zbatueshme dhe, në mënyrë të veçantë, se:

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës kushtetuese dhe dispozitave të tjera ligjore të zbatueshme për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje; dhe

ii) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha taksat mbi të ardhurat nga të ardhurat e interesit dhe të gjitha tarifatat, komisionet dhe kostot e ngjashme në Shqipëri, gjatë dhënies së Huas;

b) KfW-ja zotëron një dokument origjinal të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Marrëveshjes së Veçantë, secila e nënshkruar me fuqi ligjërish detyruese; dhe

c) nënshkrimet model të përmendura në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit) të kësaj Marrëveshjeje janë marrë nga KfW-ja;

d) garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 (Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë) është në fuqi dhe efekt pa ndonjë kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2 (Tarifa e menaxhimit) të kësaj Marrëveshjeje;

f) nuk ka ndodhur asnjë arsye për përfundim, asnjë incident nuk ka ndodhur, i cili do të bëhej shkak për përfundim me njoftim ose skadim ose konstatim ose përmbushje të një kushti (arsye e mundshme për përfundim); dhe

g) asnjë rrethanë e jashtëzakonshme nuk ka lindur që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

KfW-ja ka të drejtë, përpara çdo disbursimi nga Huaja, që të kërkojë dokumente dhe prova të mëtijshme që i çmon të nevojshme, sipas diskrecionit të saj, për të konstatuar kushtet para disbursimit, të specifikuara në këtë seksion.

3.4 *Detajet e procedurës së disbursimit:* MIE/NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit, duke nënshkruar Marrëveshjen e Veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar edhe nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke përfshirë kushtet specifike para disbursimit dhe në mënyrë të veçantë, provat që duhet të jepen nga Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s/NJKP-së që dokumentojnë se shumat e kërkuara të Huas po përdoren për qëllimin e rënë dakord, si edhe detyrimin e MIE-s/NJKP-së për të informuar Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për shumat e disbursuara, në lidhje me secilën AZP.

3.5 *E drejta për të anuluar disbursimet:* Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 11 (Detyrimet e veçanta) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas, me pëlqimin paraprak të KfW-së kundrejt pagesës së një tarife mosshfrytëzimi, sipas dhe siç përcaktohet në nenin 3.6 (Tarifa e mosshfrytëzimit) të kësaj Marrëveshjeje.

3.6 *Tarifa e mosshfrytëzimit:* Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume Huaje, për të cilën është përcaktuar një përqindje interesi, sipas nenit 3.5 (E drejta për anulimin e disbursimeve) të kësaj



Marrëveshjeje ose, nëse kjo shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet deri në afatin e caktuar në nenin 3.2 (Afati për kërkimin e disbursimit) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja, si rezultat i mosdisbursimit të shumës së Huas (Tarifa e mosshfrytëzimit⁷), përveç kur ky mosdisbursim përbën shkelje të kësaj Marrëveshjeje Huaje nga KfW-ja. KfW-ja do të llogarisë shumën e tarifës së mosshfrytëzimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Tarifa e mosshfrytëzimit do të përcaktohet sikur asnjë subvencion interesi të mos ishte dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë për Programin.

4. Tarifat

4.1 *Tarifa e angazhimit*: Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme (Tarifa e angazhimit) për shumën e padisbursuara të Huas.

Tarifa e angazhimit duhet të paguhet për pagesën e prapambetur çdo gjashtë muaj, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, për herë të parë më 15 maj 2021, por jo më herët se sa në datën përkatëse pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt sipas nenit 15.10 (Hyrja në fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje.

Tarifa e angazhimit do të ngarkohet nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues, për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit definitiv të disbursimeve nga Huaja.

Tarifa e angazhimit llogaritet si më poshtë:

i. për periudhën që fillon 12 muaj pas datës së nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse është e zbatueshme me efekt prapaveprues, deri 24 muaj pas nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, tarifa e angazhimit do të arrijë shumën 0,125 % në vit (me fjalë: zero pikë njëqind e njëzet e pesë për qind në vit); dhe

ii. për periudhën vijuese që fillon 24 muaj pas nënshkrimit nga KfW-ja të kësaj Marrëveshjeje Huaje, tarifa e angazhimit do të arrijë shumën prej 0,25 % në vit (me fjalë: zero pikë njëzet e pesë për qind në vit).

4.2 *Tarifa e menaxhimit*: Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi të pakthyeshme në

një shumë të vetme prej 0,5 % të shumës së Huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Shuma) të kësaj Marrëveshjeje (Tarifa e menaxhimit).

Tarifa e menaxhimit paguhet në datën më të hershme të dy datave të mëposhtme: i. përpara disbursimit të parë; ose ii. pas kalimit të tre muajve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje Huaje nga KfW-ja ose pas kalimit të një muaji nga hyrja në fuqi dhe efekt e kësaj Marrëveshjeje Huaje (cilado datë e mëvonshme e përcaktuar sipas pikës “ii”). Tarifa e menaxhimit duhet të paguhet sapo kjo Marrëveshje Huaje të jetë nënshkruar, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht apo vetëm pjesërisht ose nuk është disbursuar.

5. Interesi

5.1 *Interesi*: Huamarrësi do t'i paguajë interes KfW-së si më poshtë:

Norma fikse e interesit e caktuar pas disbursimit të Huas. Huamarrësi do të paguajë interes mbi Huan, sipas dispozitave të mëposhtme:

a) *Norma e interesit*: Huamarrësi do të paguajë interes për secilën shumë të Huas në një normë (Norma fikse e interesit) të përcaktuar nga KfW-ja brenda dy ditësh bankare (siç përcaktohet në nenin 15.1 (Ditë bankare) të kësaj Marrëveshjeje) para disbursimit të shumës përkatëse të Huas dhe që do të përbëhet nga:

i. Norma e shkëmbimit e përcaktuar në bazë të faqes *Rojters* “ICAPEURO” ose nëse kjo faqe nuk përmban detajet e nevojshme ose nëse nuk është e aksesueshme, në faqen *Bloomberg* “ICAE” (ose në një faqe vijuese që zëvendëson faqet *Rojters* ose *Bloomberg* të përcaktuara më lart). Nëse të dyja faqet nuk përmbajnë të dhënat e nevojshme ose janë të pazëvendësueshme, KfW-ja do të përcaktojë këtë normë mbi bazën e kostove të saj efektive të financimit në tregun e kapitalit në euro për maturimet që u korrespondojnë periudhave përkatëse të interesit fiks, sa më afër që të jetë e mundur,

ii. plus një marzh prej 0.55 % në vit që merr parasysh fondet e grantit të vëna në dispozicion nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

Nëse norma e interesit e llogaritur në përputhje me sa më lart bie nën 0% në vit, norma fikse e interesit do të jetë 0% në vit.

Norma fikse e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa të jetë marrë kësti i fundit i shlyerjes në pajtim me skedulën e shlyerjes



të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

b) *Konsolidimi*: Nëse është kryer më shumë se një disbursim nga Huaja, KfW-ja do të konsolidojë normat e interesit të caktuara për secilën shumë Huaje në një normë interesi të vetme pas secilit disbursim. Kjo normë e konsoliduar interesi fiks do t'i korrespondojë mesatares së ponderuar të normave individuale të interesit të rrumbullakosura deri në 1/10,000 të një pikë për qind, nëse presja dhjetore e parë e hequr është më e ulët se 5 ose e rrumbullakosur deri në 1/10,000 të një pike për qind, nëse presja e parë dhjetore e hequr është e barabartë ose më e madhe se 5 dhe do të jetë baza për llogaritjen e mëtejshme të interesit nga data e secilit disbursim deri në disbursimin e ardhshëm. Pas disbursimit të plotë të Huas, norma mesatare e interesit e përcaktuar në këtë mënyrë do të zbatohet derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me skedulin e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

c) *Njoftimi i normës së interesit*: KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit Normën Fikse të Interesit të caktuar sipas nenit 5.1(a) (Norma e interesit) të kësaj Marrëveshjeje, pa vonesë, pasi të jetë caktuar. KfW-ja do t'i njoftojë Huamarrësit normën e interesit të konsoliduar sipas nenit 5.1(b) (Konsolidimi) të kësaj Marrëveshjeje në datën e ardhshme të pagesës (siç përcaktohet në nenin 5.3 (Datat e pagesës) të kësaj Marrëveshjeje).

5.2 *Llogaritja e interesit*: Interesi për një shumë Huaje të disbursuar do të ngarkohet që nga data (ekskluzivisht) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas e mbajtur me KfW-në për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, siç specifikohet në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje. Interesi do të llogaritet në përputhje me nenin 7.1 (Llogaritja) të kësaj Marrëveshjeje.

5.3 *Datat e pagesës*: Interesi do të jetë i kërkuar në shumën të prapambetura për pagesë në datat e specifikuara më poshtë (secila një "Datë pagesë"):

a) përpara datës së pagesës të këstit të parë të shlyerjes, më 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti, por jo më herët sesa në datën e pagesës pas datës në të cilën kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi dhe efekt

sipas nenit 15.11 (Hyrja në fuqi dhe efekt) të kësaj Marrëveshjeje;

b) në datën e pagesës së këstit të parë të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje së bashku me një këst të tillë;

c) më pas në datën e pagesës së kësteve të shlyerjes sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Skeduli i shlyerjes*: Huamarrësi do të shlyejë Huan, si më poshtë:

	Data e pagesës	Kësti i shlyerjes
1	15 maj 2026	3,809,523.80
2	15 nëntor 2026	3,809,523.80
3	15 maj 2027	3,809,523.80
4	15 nëntor 2027	3,809,523.80
5	15 maj 2028	3,809,523.80
6	15 nëntor 2028	3,809,523.80
7	15 maj 2029	3,809,523.80
8	15 nëntor 2029	3,809,523.80
9	15 maj 2030	3,809,523.80
10	15 nëntor 2030	3,809,523.80
11	15 maj 2031	3,809,523.80
12	15 nëntor 2031	3,809,523.80
13	15 maj 2032	3,809,523.80
14	15 nëntor 2032	3,809,523.80
15	15 maj 2033	3,809,523.80
16	15 nëntor 2033	3,809,523.80
17	15 maj 2034	3,809,523.80
18	15 nëntor 2034	3,809,523.80
19	15 maj 2035	3,809,523.80
20	15 nëntor 2035	3,809,523.80
21	15 maj 2036	3,809,524.00

Ky skedul i shlyerjes mund të rregullohet herë pas here, në përputhje me nenin 6.5 (Skeduli i rishikuar i pagesës).

6.2 *Shumat e padisbursuara të Huas*: Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt këstit përkatës të shlyerjes së fundit që duhet të paguhet sipas skedulit të shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të rasteve kur KfW-ja, me diskrecionin e vet, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste individuale.

6.3 *Shlyerjet në rastin e disbursimit jo të plotë*: Nëse një këst shlyerjeje duhet të paguhet përpara se Huaja të disbursohet plotësisht, kjo nuk do të cenojë skedulin e shlyerjes, sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që kësti i shlyerjes për t'u paguar sipas skedulit të shlyerjes është më i ulët sesa shuma e Huas e



disbursuar dhe që nuk është shlyer ende (Shuma e Huas për t'u paguar). Nëse kësti i shlyerjes që duhet të paguhet në përputhje me nenin 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje tejkalon shumën e Huas për t'u paguar, ky këst shlyerjeje do të reduktohet në nivelin e shumës së Huas për t'u paguar dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë në këstet e shlyerjes që duhen paguar. Në llogaritjen e shumës së Huas për t'u paguar, KfW-ja rezervon të drejtën për të konsideruar disbursime nga Huaja, të cilat kryhen brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditësh para një date pagese për të përcaktuar shumën e Huas për t'u paguar vetëm për datën vijuese të pagesës.

6.4 *Parapagimi*: Sa më poshtë do të zbatohen për parapagimet:

a) *E drejta për parapagim*: Në bazë të paragrafëve të mëposhtëm 6.4(b) (Njoftimi) deri 6.4(e) (Kompensimi) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e Huas përpara datës së planifikuar të pagesës, nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje sipas nenit 6.1 (Skeduli i shlyerjes) të kësaj Marrëveshjeje.

b) *Njoftimi*: Parapagimi i një shume Huaje sipas nenit 6.4(a) (E drejta për parapagim) të kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet njoftimit të parapagimit nga Huamarrësi për KfW-në jo më vonë sesa në ditën e pesëmbëdhjetë bankare (siç përcaktohet në nenin 15.1 (Dita bankare) të kësaj Marrëveshjeje) para datës së synuar për parapagim. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin që t'i paguajë KfW-së shumën e deklaruar në datën e caktuar.

c) *Tarifa e parapagimit*: Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë fikse interesi Huaje, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesë, një shumë të tillë që është e nevojshme për të kompensuar humbjet, shpenzimet ose kostot e shkaktuara nga KfW-ja si rezultat i këtij parapagimi (Tarifa e parapagimit), KfW-ja do të përcaktojë shumën e tarifës së parapagimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Tarifa e parapagimit do të përcaktohet sikur asnjë subvencion interesi të mos ishte dhënë nga Republika Federale e Gjermanisë për Programin. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i sigurojë Huamarrësit një tregues të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm të shlyerjes, sipas nenit 6.4(b) (Njoftimi) të kësaj Marrëveshjeje.

d) *Shumat për t'u paguar*: Së bashku me parapagimin sipas nenit 6.4(a) (E drejta e parapagimit) të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i. çdo tarifë parapagimi për t'u paguar si rezultat i parapagimit, sipas nenit 6.4(c) (Tarifa e parapagimit) të kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii. të gjithë interesin e shtuar mbi shumën e parapaguar të Huas dhe pagesat e tjera ende të pakryera, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje që janë shtuar deri në datën e parapagimit.

e) *Kompensimi*: Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të Huas) të kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 *Skeduli i rishikuar i shlyerjes*: Në rast se zbatohet neni 6.3 (Shlyerjet në rast disbursimi jo të plotë) ose neni 6.4 (Parapagimi) të kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një skedul të rishikuar shlyerjeje, i cili do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe do të zëvendësojë skedulin e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja*: Interesi, tarifa e angazhimit, interesi i kamatëvonesës, sipas nenit 7.5 (Interesi i kamatëvonesës) të kësaj Marrëveshjeje, pagesat e kompensimit me shumë të vetme/fikse për shumat e vonuara të pagesës sipas nenit 7.6 (Kompensimi me shumë të vetme/fikse) të kësaj Marrëveshjeje, tarifa e mosshfrytëzimit dhe tarifa e parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti 360-ditor me muaj prej tridhjetë ditësh.

7.2 *Data e pagesës*: Nëse një pagesë që do të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bie në një datë që nuk është ditë pune në Bankë, Huamarrësi duhet ta kryejë një pagesë të tillë në ditën vijuese të punës në Bankë. Nëse dita vijuese e punës në Bankë bie brenda muajit vijues kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në ditën e fundit të punës në bankë të muajit aktual kalendarik.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij për pagesë në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse i janë kredituar KfW-së në disponim të lirë të saj, pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se në orën 10.00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, numri



IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, duke caktuar datën e pagesës si një referencë shtesë (Ref. VVVVMMDD).

7.4 *Kundërpretendimet/kundërpaditë e Huamarrësit*: Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë asnjë të drejtë për mbajtje ose kompensim ose të drejta të ngjashme kundrejt detyrimeve të pagesës, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, përveç kur këto të drejta njihen me vendim deklarues ose nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 *Interesi i kamatëvonesës*: Nëse ndonjë kësht shlyerjeje ose parapagimi, sipas nenit 6.4 (Parapagimi) të kësaj Marrëveshjeje nuk është në dispozicion të KfW-së, kur duhet kryer pagesa, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të ngarkojë interesin e kamatëvonesës në normën 200 pikë bazë mbi përqindjen e interesit në vit, siç përcaktohet në nenin 5.1 (Interesi) të kësaj Marrëveshjeje për periudhën që fillon në datën e pagesës dhe që përfundon në datën kur këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje. Ky interes, kamatëvonesë, duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 *Kompensimi me pagesë të vetme*: KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim me pagesë të vetme për shumat e vonuara të pagesës (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimeve të përmendura në nenin 7.5 (Interesi i kamatëvonesës) të kësaj Marrëveshjeje) nga data e pagesës deri në datën e pagesës në vlerën 200 pikë bazë në vit mbi përqindjen fikse të interesit, sipas nenit 5.1 (Interesi) të kësaj Marrëveshjeje. Kompensimi me shumë të vetme/fikse duhet të paguhet menjëherë me kërkesën e parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë se nuk ka ndodhur asnjë dëm ose se dëmet kanë qenë më të vogla se sa kompensimi me shumë të vetme.

7.7 *Kompensimi*: KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesa kundrejt pagesave që duhet të kryhen, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje ose sipas marrëveshjeve të tjera të Huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

7.8 *Llogaritjet e kryera nga KfW-ja*: Gabimet e dukshme të mungesave, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave që duhen paguar në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, përbëjnë provë *prima-facie* (*Anscheinsbeweis*).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë pretendime pagese, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë, përpara disbursimit të parë.

9. Veprimet e kundërligjshme

Nëse, në ndonjë juridiksion të zbatueshëm, bëhet e paligjshme për KfW-në që të përmbushë ndonjë prej detyrimeve të saj, siç parashikohet nga kjo Marrëveshje Huaje ose për të financuar ose për të mirëmbajtur Huan, me njoftimin e Huamarrësit nga KfW-ja:

a) angazhimi i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) Huamarrësi do të shlyejë Huan plotësisht në datën e specifikuar nga KfW-ja në njoftimin e dërguar të Huamarrësit (e cila duhet të jetë jo më herët se sa dita e fundit e ndonjë periudhe të zbatueshme pas datës së duhur të pagesës, e lejueshme me ligj).

10. Kostot dhe detyrimet publike

10.1 *Asnjë zbritje ose mbajtje në burim*: Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kostot e tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera që të bëjë ndonjë zbritje të tillë ose të mbajë shuma mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten me shumën e tillë, siç është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plotë shumën e kërkuar, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, pas zbritjes së taksat dhe detyrimeve.

10.2 *Kostot*: Huamarrësi do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që lindin, në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huas, në mënyrë të veçantë kostot e dërgesave dhe të transferimeve (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, në lidhje me mirëmbajtjen ose me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me këtë Marrëveshje Huaje, si dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin prej saj.

10.3 *Taksat dhe tarifat e tjera*: Huamarrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shtohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për sa i takon lidhjes dhe zbatimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nëse KfW-ja i kërkon paradhënie këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do



t'i transferojë pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3 (Numri i llogarisë, koha e kreditimit) të kësaj Marrëveshjeje ose në llogari tjetër, siç specifikohet nga KfW-ja.

11. Detyrime të veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni i veçantë:* Huamarrësi, nëpërmjet MIE/NJKP-së do të kryejë vetë dhe do të kërkojë që çdo AZP:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë programin, në përputhje me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike, në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale dhe kryesisht në përputhje me hartimin e Programit të rënë dakord ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së;

b) do t'ua caktojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur, të kualifikuar, dhe zbatimin e Programit firmave të kualifikuara;

c) do të pajtohet në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të garantojë financim të plotë të Programit dhe do t'i japë KfW-së, me kërkesë, të dhëna që provojnë mbulimin e kostove të paguara nga kjo Hua;

e) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që përcaktojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Programin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

f) do t'i mundësojë çdo kohë KfW-së dhe përfaqësuesve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër që lidhet me zbatimin dhe funksionimin e Programit, si dhe të vizitojë projektet dhe të gjitha instalimet e lidhura me to;

g) do t'i japë KfW-së të gjitha informacionet dhe të dhënat e tjera që lidhen me programin dhe progresin e tij të mëtejshëm, siç mund ta kërkojë KfW-ja;

h) menjëherë, me nismën e vet:

i. do t'i përcjellë KfW-së çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi nga OECD-ja ose anëtarët e tij, sipas së ashtuquajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të bashkuara", pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjen ndaj këtyre pyetjeve me KfW-në; dhe

ii. do të njoftojë KfW-në, në lidhje me të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit.

11.2 *Detaje të zbatimit të programit:* NJKP-ja, AZP-të dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e lidhura me nenin 11.1 (Zbatimi i programit dhe informacioni i posaçëm) të tij, duke nënshkruar Marrëveshjen e veçantë, e cila do të siglohet si e pranuar edhe nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

11.3 *Sipërmarrja e Përputhshmërisë:* Huamarrësi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 3a (Zotimet e përputhshmërisë së Huamarrësit) dhe të garantojë që AZP-të të përbushin në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në aneksin 3b (Zotimet e përputhshmërisë të agjencisë së zbatimit të Projektit).

11.4 *Transporti i furnizimeve:* Dispozitat e përcaktuara në marrëveshjet qeveritare, të cilat janë të njohura për Huamarrësin, do të zbatohen për transportin e furnizimeve, të cilat do të financohen nga Huaja.

11.5 *Klasifikimi pari passu:* Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje klasifikohen dhe do të përdoren minimalisht *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj që ky klasifikim të garantohet edhe për të gjitha detyrimet e ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura. Në këtë Marrëveshje Huaje, "Borxh i jashtëm" nënkupton një detyrim të Huamarrësit, i cili:

i. rregullohet nga një sistem ligji i ndryshëm nga ligji i Huamarrësit; ose

ii. i pagueshëm në një valutë të ndryshme nga valuta e vendit të Huamarrësit; ose

iii. i pagueshëm ndaj një personi të themeluar, me vendbanim, vendqëndrim ose me seli kryesore ose vend kryesor biznesi jashtë vendit të Huamarrësit.

11.6 *Detyrimet:* Huamarrësi nuk do të dhe nëpërmjet MIE/NJKP nuk do të lejojë dhe do të garantojë që çdo AZP nuk do të krijojë ose lejojë vazhdimin e ndonjë detyrimi mbi sendet pasurore (asetet) e Projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Në këtë Marrëveshje Huaje, "Detyrim" nënkupton çdo hipotekim, garanci, barrë, detyrim, caktim ose transferim nëpërmjet letrës me vlerë, hipotekimit



ose interesit të garancisë dhe çdo marrëveshje ose masë tjetër, efekti i të cilit/së cilës është krijimi i një garancie ose ndonjë të drejte për t'i dhënë prioritet pagese në lidhje me çdo detyrim të ndonjë personi.

Ky detyrim nuk zbatohet:

a) për detyrimet ekzistuese ose tashmë të rëna dakord me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe të njoftuara KfW-së para nënshkrimit të Marrëveshjes së Huas;

b) për tarifatat që lindin zakonisht gjatë kryerjes së rregullt të biznesit, sipas rregullave ligjore ose rregullave të tjera të zakonshme kontraktuale për sigurimin e detyrimeve (me përjashtim të pasivëve/detyrimeve të Huas) ndaj furnizuesve ose ofruesve të tjerë të shërbimeve (për shembull, mbajtja e të drejtave të titullit, të zakonshme në industri dhe barrët ligjore); ose

c) për tarifatat që kanë ekzistuar tashmë në kohën e blerjes së një aseti, me kusht që këto tarifa të hiqen brenda tre muajve pas blerjes/përvetësimit.

Nëse Huamarrësi, MIE/NJKP ose ndonjë AZP, i jep ndonjë pale të tretë garanci ose të drejta të tjera që i mundësojnë kësaj pale të tretë të kërkojë përmbushje preferenciale të pretendimeve kundër kujt do prej sendeve pasurore/aseteve, pronave ose të ardhurave të Projektit, KfW-ja mund të kushtëzojë pëlqimin e saj ndaj Huamarrësit, duke i dhënë, gjithashtu, KfW-së garanci (shtesë) në të njëjtën masë që siguron në mënyrë të barabartë dhe proporcionale pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

11.7 Shitja e aseteve: Pa pëlqimin e KfW-së, as Huamarrësi, as AZP-të nuk do të shesin asete të Projektit.

12. Përfundimi i Marrëveshjes së Huas

12.1 Arsytet e përfundimit: KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në nenin 12.2 (Pasoja juridike të shfaqjes së një shkaku të përfundimit) të kësaj Marrëveshjeje, nëse krijohet një rrethanë që përbën një shkak të mirë (*Wichtiger Grund*). Këto përfshijnë, veçanërisht, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk kryen detyrimet e pagesave ndaj KfW-së, kur është e kërkueshme;

b) shkelen detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje Huaje, marrëveshjen e grantit të Investimit, marrëveshjen e grantit SECO, marrëveshjen e grantit të BE-së, marrëveshjen e grantit shoqëruar ose në marrëveshjen e veçantë, si

dhe në çdo marrëveshje tjetër shtesë ligjërisht e detyrueshme për këtë Marrëveshje;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj nuk ka më një efekt detyrues mbi Huamarrësin ose nuk mund të zbatohet më ndaj Huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe mirëmbajtjen e Huas provohet të jetë e rremë, çorientuese ose e paplotë;

e) ndodhin rrethanat të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë kryerjen e detyrimeve, sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Huamarrësi, përmes MIE/NJKP-së, ose ndonjë AZP-je nuk mund të provojë që shumatat e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar; ose

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, është i falimentuar ose fillon negociatat me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit;

12.2 Pasoja ligjore të shfaqjes së një shkaku të përfundimit: Nëse një nga ngjarjet e përmendura në nenin 12.1 (Arsytet e përfundimit) ka ndodhur, KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet, sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nëse kjo ngjarje nuk zgjidhet brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1(a) të kësaj Marrëveshjeje) ose në të gjitha rastet e tjera të nenit 12.1 (Arsytet e përfundimit) të kësaj Marrëveshjeje, brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga KfW-ja, periudhë e cila, gjithsesi, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të anulojë këtë Marrëveshje Huaje plotësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje do të pushojnë dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjithë ose një pjese të Shumës së Papaguar të Huas, së bashku me interesin e shtuar dhe shumatat e mbetura që i detyrohet kësaj Marrëveshjeje Huaje. Nenet 7.5 (Interesi i kamatëvonesës) dhe 7.6 (Kompensimi me pagesë të vetme) të kësaj Marrëveshjeje zbatohen për shumatat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje Huaje përfundon plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë tarifën e mosshfrytëzimit, në përputhje me nenin 3.6 (Tarifa e mosshfrytëzimit) dhe/ose pagesën e parapagimit, në përputhje me nenin 6.4 c) (Tarifa e parapagimit).



13. Përfaqësimi dhe deklaratat

13.1 *Përfaqësimi i Huamarrësit:* Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrimet model të vërtetuar prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Huamarrësin në të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje. Prokurat nuk do të skadojnë deri në marrjen nga ana e KfW-së të revokimit të tyre të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

13.2 *Adresat:* Deklaratat ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bëhen me shkrim. Çdo njoftim duhet të dërgohet origjinale ose - me përjashtim të kërkesave për disbursim - përmes faksit. Çdo dhe të gjitha deklaratat ose njoftimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Germany

Faks: +49 69 7431-2944

Për huamarrësin: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3

Tiranë, Shqipëri

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Projektin

14.1 *Publikimi i informacionit të lidhur me Projektin nga KfW-ja:* Për të përmbushur parimet e pranuar ndërkombëtarisht për arritjen e transparencës dhe efikasitetit maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e vlerësimit dhe kategorizimit mjedisor dhe social, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (Pas Projektit) për Programin dhe financimin e tij gjatë negociatave parakontraktuale, paralelisht me zbatimin e marrëveshjes/ve të lidhur/a me Programin dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (qoftë nga KfW-ja apo palët e treta, në përputhje me nenin 14.3 më poshtë (Transferimi i informacionit në lidhje me Projektin te palët e treta dhe publikimi nga këta) më poshtë), për Programin dhe mënyrën e tij të financimit nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose

informacion të hollësishëm sensitiv financiar apo të lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Program ose në financimin e tij, të tillë si:

a) informacion për të dhënat e brendshme financiare;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;

d) të dhëna personale për personat fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

14.2 *Transferimi i informacionit, në lidhje me programin te palët e treta:* KfW-ja e ndan informacionin e përzgjedhur për Programin dhe mënyrën e tij të financimit gjatë periudhës së plotë me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet e saj kompetente;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH Zusammenarbeit (GIZ) GmbH*;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO;

f) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

14.3 *Transferimi i informacionit, në lidhje me programin te palët e treta dhe publikimi nga këta:* Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për programin dhe financimin e tij gjatë periudhës së plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat botojnë seksionet që kanë lidhje me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare

(http://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen_fakten/transparenz-fuer-mehr-Eirksamkeit/Transparenzstrategie/index.html);

b) Tregu dhe investimi gjerman (GTAI), për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/welcome.html>)



c) OECD-ja, për qëllimet e raportimit të flukseve financiare, në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://www.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal), për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<https://www.deval.org/en/>);

e) Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (<http://www.simap.ch>);

h) Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij.

14.4 *Transferimi i informacionit, në lidhje me programin te palët e treta (përfshirë publikimin nga këta):* KfW-ja rezervon më tej të drejtën për transferimin (duke përfshirë qëllimet e publikimit) e informacionit për programin dhe financimin e tij gjatë periudhës së plotë të palët e tjera të treta për të mbrojtur interesat e ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e tjera të treta, nëse interesat e ligjshëm të Huamarrësit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Huamarrësit përfshijnë veçanërisht konfidencialitetin e informacionit sensitiv të përmendur në nenin 14.1 (Publikimi i informacionit, në lidhje me Projektin nga KfW-ja), i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtën t'iu transferojë informacion palëve të treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave statutores ose rregullore ose për të ruajtur ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në proceset gjyqësore ose administrative.

15. Dispozita të përgjithshme

15.1 *Ditë bankare:* Kur bëhet referencë në këtë Marrëveshje Huaje për një “Ditë bankare”, kjo do të thotë një ditë përveç një të shtune ose të diele kur bankat tregtare në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

15.2 *Vendi i kryerjes:* Vendi i kryerjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

15.3 *Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet ligjore:* Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Huaje është ose bëhet e pavlefshme ose, nëse ka një boshllëk ligjor në cilindo nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Huaje, kjo nuk do të ndikojë në

vlefshmërinë e dispozitave të mbetura të saj. Palët në këtë Marrëveshje Huaje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjorisht të vlefshme, e cila i afrohet sa më shumë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të mbushin çdo boshllëk ligjor në dispozitat me një dispozitë të vlefshme ligjore, e cila i afrohet sa më shumë frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje.

15.4 *Forma me shkrim:* Çdo shtesë dhe ndryshim në këtë Marrëveshje Huaje duhet të jetë me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kërkesa për formën me shkrim vetëm me kërkesë me shkrim.

15.5 Ministri i Financave dhe i Ekonomisë është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet miratuar nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje Huaje që cenojnë vetëm periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

15.6 *Caktimi:* Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë, pengojë ose hipotekojë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje.

15.7 *Ligji i zbatueshëm:* Kjo Marrëveshje Huaje rregullohet nga legjislacioni gjerman.

15.8 *Periudha e kujfizimit:* Të gjitha pretendimet e KfW-së në bazë të kësaj Marrëveshjeje Huaje skadojnë pas pesë vjetësh nga fundi i vitit, kur është ngritur një kërkesë e tillë dhe kur KfW-ja është vënë në dijeni për rrethanat që përbejnë një pretendim të tillë ose mund të ishin vënë në dijeni për to, pa pakujdesi të rëndë.

15.9 *Heqja dorë nga imuniteti:* Nëse dhe në masën që Huamarrësi mund të kërkojë, tani ose në të ardhmen, në ndonjë juridiksion, imunitet për vetë ose pasuritë e tij dhe në atë masë që një juridiksion i jep imunitet Huamarrësit dhe pasurive të tij nga padia, ekzekutimi, konfiskimi ose proces tjetër ligjor, Huamarrësi në mënyrë të pakthyeshme bie dakord të heqë dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje, në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, në lidhje me:

i. “ambientet e misionit” të tashmë ose të ardhme sipas përkufizimit të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar më 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për



Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar më 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii. një pasuri e patundshme që futet në sferën e nenit 3, paragrafët 1–3 të ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.2.2001, “Mbi pasuritë e patundshme shtetërore”;

iii. çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë tashmë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë, sipas së drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj

15.10 Mosmarrëveshjet ligjore:

a) *Arbitrazhi*: Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje do të zgjidhen ekskluzivisht dhe në formë përfundimtare nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë kuadër, do të zbatohen sa më poshtë:

i. Gjykata e Arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra, të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), të zbatueshme herë pas here.

ii. procedura e arbitrazhit do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedurës do të jetë gjuha angleze.

15.11 *Hyrja në fuqi dhe efekt*: Kjo Marrëveshje Huaje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt deri në datën kur KfW-ja të ketë marrë një njoftim me shkrim nga Huamarrësi se Marrëveshja e Huas është ratifikuar rregullisht. Nëse Marrëveshja e Huas nuk ka hyrë në fuqi brenda gjashtë muajve

pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Huaje ose në ndonjë afat tjetër sikurse mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja e Huas dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull duke i dërguar një njoftim me shkrim Huamarrësit.

Bërë në 2 origjinale në gjuhën angleze

Frankfurt am Main,
18.12.2020 KfW

Tiranë, 18.12.2020
Republika e Shqipërisë

Emri: Arne Gooss
Funksioni: Përgjegjës
sektori

Emri: Anila Denaj
Funksioni: Ministër i
Financave dhe Ekonomisë

Emri: Jochen Reik
Funksioni: Menaxher
Portofoli Senior

ANEKSI 1 SKEDULI I DISBURSIMIT

Skeduli i disbursimit në mënyrën më të shpejtë të mundshme

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (“Data efektive e mbarimit të periudhës”, në përputhje me listën e më poshtme) Huamarrësi mund të kërkojë disbursime vetëm deri në një nivel që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Periudha	Data efektive e fillimit të periudhës (përfshirë)	Data efektive e mbarimit të periudhës (me përjashtim të)	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në euro)
1	1.1.2021	30.6.2021	3,000,000.00
2	1.7.2021	31.12.2021	12,500,000.00
3	1.1.2022	30.6.2022	22,500,000.00
4	1.7.2022	31.12.2022	32,500,000.00
5	1.1.2023	30.6.2023	42,500,000.00
6	1.7.2023	31.12.2023	52,500,000.00
7	1.1.2024	30.6.2024	62,500,000.00
8	1.7.2024	31.12.2024	72,500,000.00
9	1.1.2025	31.12.2027	80,000,000.00



ANEKSI 2
FORMA E OPINIONIT LIGJOR TË
KËSHILLTARIT LIGJOR PËR
HUAMARRËSIN

Shënim. Ju lutemi ndryshoni si duhet
“Republika e SHTETIT”/ “SHTETIT”.

[Letër me kokë e këshilltarit ligjor]

KfW

Departamenti [_____] _____

(datë)

Në vëmendje të: [_____]

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main/Germany

Republika Federale e Gjermanisë

**Marrëveshje Huaje e datës _____
dhe e lidhur ndërmjet KfW-së dhe
[_____] (Huamarrësi) për një
shumë që nuk tejkalon në total
EURO _____.000.000,--.**

Të nderuar zotërinj,

Unë jam [ministri i Drejtësisë] [këshilltari
ligjor i] [shefi i departamentit ligjor i _____
(ju lutemi specifikoni ministrinë ose autoritet
tjetër) të] Republikës së SHTETIT. Unë kam
vepruar në atë cilësi në lidhje me një marrëveshje
huaje, të datës _____ “Marrëveshja e Huas”),
dhe e lidhur ndërmjet Huamarrësit dhe juve, në
lidhje me një hua që ju do t’i jepni Huamarrësit
në një shumë që nuk tejkalon në total
Euro _____.000.000,--.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 Një origjinal autentik të nënshkruar, të
Marrëveshjes së Huas;

1.2 Në veçanti, dokumentet kushtetuese të
Huamarrësit:

a) Kushtetutën e Republikës së SHTETIT, e
datës _____, e botuar rregullisht në
_____, nr. _____, faqja _____, e
ndryshuar;

b) Ligjin/et nr. _____, të datës _____, e
publikuar rregullisht _____, nr. _____,
faqja _____, e ndryshuar [ju lutem vendosni
këtu, nëse ekzistojnë, ligje (p.sh., ligjet për
buxhetin) në lidhje me marrjen hua të parave nga
Republika e SHTETIT];

c) _____ - [ju lutem referojuni
dokumente të tjera, p.sh., dekretet ose
vendimet nga organet qeveritare ose
administrative të SHTETIT, në lidhje me
përmbylljen e marrëveshjeve të huas nga
SHTETI, në përgjithësi ose në lidhje me
përmbylljen e Marrëveshjes së Huas]; dhe

d) Marrëveshjen e Bashkëpunimit Financiar
midis Qeverisë së Republikës së SHTETIT dhe
Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë,
datë _____ (Marrëveshja e Bashkëpunimit),

dhe ligje, rregullore, certifikata, të dhëna,
regjistrime dhe dokumente të tjera, të cilat i kam
konsideruar të domosdoshme ose të
përshtatshme për t’u shqyrtuar. Gjithashtu, unë
kam bërë kërkime të tilla që i kam konsideruar të
domosdoshme ose të përshtatshme, me qëllim
dhënien e këtij opinion.

2. Opinioni

Për qëllimet e nenit _____ të Marrëveshjes së
Huas, unë mendoj që, sipas ligjeve të Republikës
së SHTETIT në datën e kësaj Marrëveshjeje:

2.1 Sipas nenit _____ të Kushtetutës/nenit
_____, të ligjit mbi _____ [ju lutemi
specifikoni sipas rastit] Huamarrësi ka të drejtë të
lidhë Marrëveshjen e Huas dhe ka ndërmarrë të
gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar
zbatimin, dorëzimin dhe përmbushjen e
Marrëveshjes së Huas, veçanërisht me anë të:

a) ligjit/eve nr. _____, datë _____, të
parlamentit të Republikës së SHTETIT, që
ratifikon Marrëveshjen e Huas/miraton zbatimin,
dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së
Huas nga Huamarrësi/_____ [ju
lutem vendosni sipas rastit];

b) rezolutës/at nr. _____, datë
_____, të Kabinetit të Ministrave/të
Komitetit të huas shtetërore/_____ [ju
lutem vendosni organet qeveritare ose
administrative të SHTETIT, sipas rastit];

c) _____ [ju lutem referojuni
rezolutave, vendimeve etj.].

2.2 znj./z. _____ (dhe znj. z.
_____) është (janë) i autorizuar



rregullisht nga _____ [p.sh., me ligj për shkak të funksionit të tij / saj (si ministër i _____/ si _____), me vendim qeverie _____, me prokurë _____, datë _____ etj.] të nënshkruajë individualisht/bashkërisht Marrëveshjen e Huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huas e nënshkruar nga znj/z. _____ (dhe z. znj. _____) është zbatuar siç duhet në emër të Huamarrësit dhe përbën detyrime ligjërish detyruese të Huamarrësit të zbatueshme ndaj tij me ligj, në përputhje me kushtet e tij.

[**Alternativa 1** për seksionin 2.3, që do të përdoret, nëse përveç dokumenteve të përcaktuara në seksionet 2.1 dhe 2.2, duhet të merren autorizime të caktuara zyrtare etj., në bazë të ligjeve të Republikës së SHTETIT.]

2.3 Për zbatimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja e të gjitha shumave të përcaktuara në të, në monedhat e specifikuar në të), janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë miratimet zyrtare, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e mëposhtme:

a) miratimi i _____ [Banka Qendrore/Banka Kombëtare _____], datë _____, nr. _____;

b) pëlqimi i _____ [ministri/Ministria e _____], datë _____, nr. _____; dhe

c) _____ [ju lutem rendisni çdo autorizim tjetër zyrtar, licenca dhe/ose pëlqime].

Asnjë autorizim tjetër zyrtar, pëlqime, licenca, regjistrime dhe/ose miratime të ndonjë autoriteti ose agjencie qeveritare (përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së SHTETIT) ose gjykatë nuk kërkohet ose këshillohet në lidhje me zbatimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja e të gjitha shumave të kërkueshme në këto monedha të specifikuar këtu) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

[**Alternativa 2** për seksionin 2.3, që do të përdoret, vetëm nëse përveç dokumenteve të përcaktuara në seksionet 2.1 dhe 2.2, nuk duhet të merret asnjë autorizim zyrtar etj., në bazë të ligjeve të Republikës së SHTETIT.]

2.3 Asnjë autorizim tjetër zyrtar, pëlqime, licenca, regjistrime dhe/ose miratime të ndonjë autoriteti ose agjencie qeveritare (përfshirë Bankën Qendrore/Kombëtare të Republikës së SHTETIT) ose gjykatë nuk kërkohet ose këshillohet, në lidhje me zbatimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huas nga Huamarrësi (përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin të KfW-ja e të gjitha shumave të kërkueshme në këto monedha të specifikuar këtu) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas.

2.4 Asnjë taksë pulle ose taksë ose detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e Marrëveshjes së Huas.

2.5 Zgjedhja e legjislacionit gjerman për të rregulluar Marrëveshjen e Huas dhe paraqitjen në arbitrazh, në përputhje me nenin _____ të Marrëveshjes së Huas, janë të vlefshme dhe të detyrueshme. Vendimet e arbitrazhit ndaj Huamarrësit do të njihen dhe janë të zbatueshme në Republikën e SHTETIT, sipas rregullave të mëposhtme: _____ [ju lutem vendosni traktatin e zbatueshëm (nëse ka ndonjë), p.sh. Konventa e Nju-Jorkut e vitit 1958, dhe/ose parimet themelore në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në SHTETIN].

2.6 Gjykatat e Republikës së SHTETIT kanë lirinë të japin vendimin e emërtuar në monedhën ose monedhat e specifikuar në Marrëveshjen e Huas.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi, sipas Marrëveshjes së Huas dhe zbatimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huas përbëjnë akte private dhe tregtare dhe jo akte qeveritare ose publike. As Huamarrësi dhe as ndonjë pronë e tij nuk ka ndonjë të drejtë për imunitet nga arbitrazhi, padi, ekzekutim, konfiskim ose proces tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja e bashkëpunimit është në fuqi dhe efekt të plotë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së SHTETIT. [Në mbështetje të nenit 3, të Marrëveshjes së bashkëpunimit.] [Nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por ekziston një marrëveshje për tatimin e dyfishtë] Në bazë të _____ [ju lutem specifikoni



traktatin ose ligjet dhe rregulloret në fuqi]/Huamarrësit nuk do t'i kërkohet të bëjë ndonjë zbritje ose ndalim/mbajtje nga ndonjë pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë në bazë të Marrëveshjes së Huas dhe nëse më vonë vendoset ndonjë zbritje apo mbajtje e tillë, dispozitat e nenit ____ të Marrëveshjes së Huas do të funksionojë në mënyrë që të kërkojë nga Huamarrësi të zhdëmtojë KfW-në në përputhje me rrethanat.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk do të konsiderohet se është rezident, me vendbanim, që ushtron biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e SHETETIT, vetëm për shkak të ekzekutimit, përmbushjes ose zbatimit të Marrëveshjes së Huas. Nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, të kualifikohet ose ndryshe të ketë të drejtë të ushtrijë biznes ose që KfW-ja të emërojë agentë ose përfaqësues në Republikën e SHETETIT.

Prandaj, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe të pakushtëzuara, ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të cilat janë të zbatueshme ndaj Huamarrësit, në përputhje me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor është i kufizuar në ligjet e Republikës së SHETETIT.

(Vendi)

(Datë)

[Nënshkrimi]

Emri: _____

Bashkëlidhur:

Shënim. Ju lutemi bashkëlidhni fotokopje të vërtetuara të dokumenteve dhe të dispozitave ligjore të përmendura më lart (në lidhje me ligjet e gjata ose Kushtetutën e Republikës së SHETETIT, një kopje të dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe, gjithashtu, jepini KfW-së një përkthim zyrtar në gjuhën angleze ose gjermane të secilit prej dokumenteve të mësipërme, përveç nëse një dokument i tillë është lëshuar në gjuhën angleze dhe gjermane si një gjuhë zyrtare ose, përveç se nëse KfW-ja ka treguar se një gjuhë tjetër është e pranueshme.

ANEKSI 3A

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË HUAMARRËSIT

1. PËRKUFIZIME

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënimi për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një person apo pronë të ndonjë personi për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme mbi veprimet e një personi.

“Praktikë e fshehtë” është një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër.

“Praktikë korruptive” premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, qoftë drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga çdo person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e atij personi për të vepruar.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqpërfaqësim që çorienton ose synon të çorientojë, qoftë me ose pa dashje, një person, me qëllim marrjen e një përfitimi financiar ose shmangien e një detyrimi.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e provave materiale hetimore ose dhënia e dëshmive të rreme për hetuesit, për të penguar materialisht një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese, praktike të fshehtë ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi të një personi për të mos e lejuar atë që të tregojë gjithçka për çështje që lidhen me hetimin, ose nga kryerja e hetimit; ose ii. çdo akt që synon të pengojë materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, lidhur me një hetim zyrtar mbi dyshimet e një praktike korruptive, praktike mashtruese, praktike shtrënguese ose praktike të fshehtë.

“Person”, një person fizik, person juridik, partneritet apo shoqatë e pathemeluar në formën e korporatës.

“Praktikë e sanksionueshme” çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë



korruptive, praktike mashtruese, ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose ligjeve të tjera të zbatueshme; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Huamarrësit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksione” sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga organi sanksionues.

“Organ sanksionues” Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian ose Republika Federale e Gjermanisë.

“Listë e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike, që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.

2. SIPËRMARRJA LIDHUR ME INFORMACIONIN

Huamarrësi:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Huamarrësin që KfW-ja mund të kërkojë;

b) nëpërmjet MIE/NJKP-së, i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Programin, të Huamarrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Huamarrësin që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) nëpërmjet MIE/NJKP-së, informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e tij, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi të lidhur me Projektin;

d) nëpërmjet MIE/NJKP-së, i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tyre të mëtejshme, siç KfW-ja mund të kërkojë, për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) nëpërmjet MIE/NJKP-së, u mundëson KfW-së dhe agjentëve të saj, në çdo kohë, inspektimin e të gjithë dokumentacionit tjetër të Huamarrësit dhe palëve të tij (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të mbi programin dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

Për sa i përket legjislacionit gjerman apo legjislacionit të vendit të Huamarrësit, ky i fundit shprehet se asnjë prej personave që vepron në emër të Huamarrësit për Projektin, nuk ka kryer ose nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë të pagesës së interesit, duke iu referuar rrethanave mbizotëruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Huamarrësi ndërmerr të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e saj, sapo Huamarrësi apo KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Në veçanti, Huamarrësi i përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Huamarrësi nuk lidh transaksione apo nuk angazhohet në veprimtari të tjera lidhur me programin që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

ANEKSI 3B

ZOTIMET E PËRPUTHSHMËRISË TË AGJENCISË SË ZBATIMIT TË PROJEKTTIT

1. PËRKUFIZIMET

“Praktikë shtrënguese”, dëmtimi apo lëndimi ose kërcënim i për të dëmtuar apo lënduar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë person apo pronë të personit për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme në veprimet e një personi;



“Praktikë e fshehtë”, një marrëveshje midis dy apo më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin e papërshtatshëm në veprimet e një personi tjetër;

“Praktikë korruptive” premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, insistimi për të dhënë, marrja, pranimi ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazhi të papërshtatshëm të çfarëdolloj natyre, për apo nga ndonjë person, me qëllim ndikimin në veprimet e një personi apo pengimin e ndonjë personi për të vepruar.

“Kategoritë e përcaktuara të veprave penale” kategoritë e mëposhtme të veprave penale, të përcaktuara sipas rekomandimeve të FATF-së dhe shënimit përkatës interpretues: pjesëmarrja në një grup kriminal të organizuar dhe shantazhim; terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve; shfrytëzimi seksual, duke përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve; trafikimi i paligjshëm i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope; trafikimi i paligjshëm i armëve; trafikimi i paligjshëm i mallrave të vjedhura dhe i mallrave të tjera; korrupsioni dhe mitmarrja/mitdhënia; mashtrimi; falsifikimi i monedhës; falsifikimi dhe pirateria e produkteve; krimi mjedisor; vrasja, lëndimi i rëndë trupor; rrëmbimi; mbajtja e paligjshme me forcë dhe pengmarrja; grabitja ose vjedhja; kontrabandimi (duke përfshirë edhe në lidhje me taksat dhe tarifatat doganore dhe akcizat); krimet tatimore (të lidhura me taksat direkte dhe të tërthorta); zhvatja; falsifikimi, pirateria; manipulimi i tregut dhe tregtimi i brendshëm.

“Rekomandimet e FATF-së”, rekomandime të tilla që përcaktohen herë pas here nga Task-Forca e Veprimit Financiar (FATF). FATF-ja është organi ndërqeveritar, qëllimi i së cilës është hartimi dhe nxitja e politikave kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

“Praktikë mashtruese” nënkupton çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim, që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfuturi financiar ose shmangies së një detyrimi.

“Origjinë e paligjshme”, origjina e fondeve të përfuturuar me anë të:

- a) ndonjë veprë penale të listuar në kategoritë e caktuara të veprave penale;
- b) ndonjë praktike korruptive;
- c) ndonjë praktike mashtruese; ose
- d) pastrimit të parave.

“Praktikë penguese”: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja e qëllimshme e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar për dyshimet për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcërimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. çdo veprim i synuar për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar kontraktualisht, në lidhje me një hetim zyrtar për dyshimet e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

“Person” çdo person fizik, person juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

“Praktikë e sanksionueshme” çdo praktikë shtrënguese, praktikë e fshehtë, praktikë korruptive, praktike mashtruese ose praktike penguese (sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje), që: i. është e paligjshme sipas legjislacionit gjerman ose legjislacioni tjetër të zbatueshëm; dhe që ii. ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional mbi këtë Marrëveshje ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së apo zbatimin e saj.

“Sanksionet”, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot apo masat shtrënguese ekonomike, financiare ose tregtare, të administruara, miratuara apo zbatuara nga ndonjë organ sanksionues.

“Organ sanksionues”, Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

“Lista e sanksioneve”, çdo listë e personave, grupeve apo subjekteve të përcaktuara në mënyrë specifike, që u nënshtrohen sanksioneve, e lëshuar nga ndonjë organ sanksionues.



2. SIPËRMARRJA NË LIDHJE ME INFORMACIONIN

Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) i vë në dispozicion KfW-së menjëherë, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të gjithë informacionin përkatës që lidhet me “njohjen e klientit” apo informacione të ngjashme për Agjencinë e Zbatimit të Projektit dhe të ndonjë (në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë) aksionari, filiali dhe/ose bashkëpunëtori tjetër të tij (nëse ka ndonjë);

b) i ofron KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet e lidhura me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese dhe palëve të tjera përkatëse, tek të cilat KfW-ja bazohet për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e praktikave të sanksionueshme, pastrimit të parave ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është e nevojshme për këtë qëllim;

c) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj, sapo merr dijeni apo dyshon për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, anëtarët e organeve të saj të menaxhimit, organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj;

d) i jep KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme, sipas kërkesës së KfW-së, për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i mundëson KfW-së dhe agentëve të saj inspektimin në çdo kohë të të gjithë dokumentacionit tjetër të lidhur me Projektin, të Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe palëve të saj (nën)kontraktuese apo palëve të tjera të lidhura me të dhe kryerjen e vizitave në Projekt dhe në të gjitha instalimet përkatëse, për qëllimet e kësaj shtojce.

f) informon KfW-në menjëherë dhe me pëlqimin e saj për çdo rast që mund të sjellë klasifikimin ekzistues ose të mundshëm të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, anëtarëve të organeve të saj të menaxhimit ose organeve të tjera qeverisëse apo aksionarëve të saj, si shtetas me emërtim të veçantë ose personave apo

subjekteve të bllokuara, të renditur në ndonjë lloj liste sanksionesh.

3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

Për sa i përket legjislacionit gjerman ose vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit, kjo e fundit përfaqëson dhe garanton se janë të vërteta dhe të sakta sa më poshtë:

a) në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari vet;

b) në dijeni të saj dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njihen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme të bursës, as kapitali i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, as fondet e investuara në Projekt nuk kanë burim të paligjshëm.

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit, bashkëpunëtorët, filialet apo asnjë person tjetër që vepron në emër të saj nuk ka kryer apo nuk është angazhuar në praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi.

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk: i. ka lidhur ndonjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë apo persona dhe subjekte të bllokuara të renditura në ndonjë lloj liste sanksionesh; ose nuk ii. është angazhuar në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen jepen për herë të parë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato konsiderohen të përsëritura me çdo tërheqje Huaje dhe në çdo datë të pagesës së interesit, duke iu referuar rrethanave mbizëtoruese në atë datë.

4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

a) përmbushë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, respektojë dhe përmirësojë, nëse është e nevojshme, standardet dhe udhëzimet e brendshme (duke përfshirë pa kufizim, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ndaj klientit), të nevojshme për shmangien e praktikave të sanksionueshme, akteve të pastrimit të parave ose të financimit të terrorizmit; dhe

b) sapo Agjencia e Zbatimit të Projektit ose KfW-ja të marrë dijeni apo të dyshojë për ndonjë praktikë të sanksionueshme, akt pastrimi parash apo financim terrorizmi, bashkëpunon plotësisht



me KfW-në dhe agjentët e saj, për të përcaktuar nëse ka ndodhur ky incident përputhshmërie. Agjencia e Zbatimit të Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me detaje të arsyeshme çdo njoftimi të KfW-së dhe ofron mbështetje dokumentuese për këtë përgjigje, me kërkesë të KfW-së.

5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia e Zbatimit të Projektit ndërmerr të:

- a) sigurojë se kapitali apo fondet e tjera që investon nuk kanë burim të paligjshëm;
- b) sigurojë se biznesi i saj nuk shkakton praktikë të sanksionueshme, pastrim parash apo financim terrorizmi; dhe
- c) mos lidhë apo të mos vijojë asnjë marrëdhënie biznesi me shtetas me emërtim të veçantë, persona ose subjekte të bllokuar, të renditur në ndonjë listë sanksionesh ose të mos angazhohet në veprimtari të tjera që përbëjnë shkelje të sanksioneve.

DEKRET

Nr. 11990, datë 4.3.2021

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe të nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 24/2021, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e infrastrukturës bashkiake V, në shumën 80 000 000 (tetëdhjetë milionë) euro”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 4, datë 26.2.2021

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 59, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Kualifikimi i mësuesve organizohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Provimi për kategorinë e kualifikimit të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar zhvillohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (në vijim “ASCAP”).

3. Organizimi i kualifikimit të mësuesve udhëhiqet nga parimi i transparencës, meritokracisë dhe trajtimit të barabartë për situata objektive të njëjta.

Neni 2

Qendra e provimit

Provimi i kualifikimit të mësuesve zhvillohet me shkrim në mjediset e përcaktuara nga ASCAP-i.

Neni 3

Administrimi dhe monitorimi i provimit

Kualifikimi i mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar:

1. Administrohet nga ASCAP-i.
2. Monitorohet nëpërmjet strukturave të vlerësimit të cilësisë së ASCAP-it.
3. Kryhet nëpërmjet portofolit personal të zhvillimit profesional të mësuesve dhe të provimeve, sipas profileve përkatëse.



Neni 4

Kriteret e pranimit

1. Kandidatët për kualifikim (kandidatët) janë punonjësit e institucioneve arsimore parauniversitare publike dhe private, të cilët kanë diplomë në fushën e mësuesisë ose zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të ciklit të parë dhe të dytë ose të barasvlershme me to, të ngjashme ose të përafërt me fushën përkatëse të mësimdhënies në arsimin parauniversitar, si dhe kandidatët që japin lëndët e muzikës, të arteve pamore, kërcimit dhe edukimit fizik.

2. Procedurave të kualifikimit u nënshtrohen detyrimisht të gjithë mësuesit, të cilët, deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, plotësojnë kushtet e mëposhtme për vjetërsinë e punës në arsim:

a) të paktën 5 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues i kualifikuar”;

b) të paktën 10 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe të paktën 5 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues i kualifikuar”;

c) të paktën 20 vjet punë për kategorinë e kualifikimit “Mësues mjeshtër” dhe të paktën 10 vjet punë pas marrjes së kategorisë “Mësues specialist”.

3. Punonjësit arsimorë, të përmendur në pikën 2, që kanë mospërputhje midis vjetërsisë së punës në arsim dhe kategorisë së kualifikimit, kualifikohen për kategorinë më të ulët që nuk e kanë fituar ende.

4. Duke filluar nga viti shkollor 2014–2015 e në vazhdim, mësuesit që plotësojnë kriteret e pikës 2 të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për të fituar kategorinë e kualifikimit, nëse kanë kryer të paktën 3 ditë trajnimi në vit kalendarik, të cilat janë të barasvlershme me 18 orë trajnimi të pasqyruara me 1 (një) kredit.

Neni 5

Parimet bazë të procedurave të provimit të kualifikimit

1. Procedura e provimit të kualifikimit bazohet në parimet e mëposhtme:

a) ruajtja e fshehtësisë së fondit të pyetjeve dhe të testeve;

b) korrektesa e kandidatëve në mjedisin e provimit;

c) korrektesa e administrimit;

ç) vlerësimi i standardizuar i përgjigjeve të mësuesve.

KREU II

**DETYRAT E INSTITUCIONEVE
PËRGJEGJËSE DHE E KANDIDATËVE**

Neni 6

**Detyrat e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë
në Arsimin Parauniversitar**

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton programet orientuese për kualifikimin sipas profileve përkatëse, të cilat përmbajnë njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi, si dhe referencat e literaturës që përbëhen nga akte ligjore e nënllore dhe udhëzues të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Pjesa tjetër e literaturës përzgjidhet nga mësuesit që do të marrin pjesë në kualifikim;

b) cakton hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesin e testit dhe vlerësuesit e testeve;

c) realizon seanca informuese me hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit e testeve, vlerësuesit e testeve, si dhe me përgjegjësit e administrimit të provimit, për zhvillimin e këtyre proceseve;

d) harton formatet e procesverbaleve të parashikuara në këtë udhëzim;

e) përcakton mjediset ku do të zhvillohen provimet në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP);

f) cakton numrin e kandidatëve në provim sipas mjediseve përkatëse;

g) njofton secilën Drejtori Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) për numrin e punonjësve të saj ose punonjësve të Zyrate Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) në varësi të saj që do të kryejnë detyrat e përgjegjësit të administrimit të provimit, administratorit dhe sekretuesit;

h) përcakton kriteret e vlerësimit me pikë të kërkesave të testit dhe të pjesëve të tij;

i) përdor bar kode për sekretimin e testeve të provimit;

j) dërgon në DRAP/ZVAP, listën e vlerësimeve për çdo pjesëmarrës, me pikët për të dyja pjesët e testit dhe vlerësimin me fjalë të tij;



k) harton raportin e ecursisë së procesit të kualifikimit dhe ia paraqet ministrit përgjegjës për arsimin;

l) i paraqet ministrit përgjegjës për arsimin rekomandime për politikën dhe planet e zhvillimit profesional të personelit mësimor bazuar në rezultatet e provimit të kualifikimit.

Neni 7

Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton listën përfundimtare të përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve për administrimin e provimit të kualifikimit, sipas mjediseve dhe numrit të përcaktuar nga ASCAP-it;

b) verifikon dhe monitoron saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

c) verifikon dhe monitoron vlerësimin e kriterëve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit, të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

d) monitoron vlerësimin e portofolit të mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse.

Neni 8

Detyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) harton listën e emrave të kandidatëve që do të marrin pjesë në kualifikimin e mësuesve për DRAP-në dhe e dërgon në ASCAP, sipas databazës së përcaktuar;

b) harton listën e emrave të përgjegjësve të administrimit, administratorëve dhe sekretuesve dhe i dërgon në DPAP;

c) verifikon dhe monitoron saktësinë e aplikimeve të paraqitura nga kandidatët për procesin e kualifikimit;

d) verifikon dhe monitoron procesin e vlerësimit të kriterëve të kandidatëve për të hyrë në procesin e kualifikimit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

e) monitoron vlerësimin e portofolit të mësuesit të kryer nga ZVAP-ja përkatëse;

f) organizon seminare rreth rezultateve të provimeve të kualifikimit në DRAP;

g) përmirëson planin e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë mbështetur në rezultatet e provimeve.

Neni 9

Detyrat e zyrës vendore të arsimit parauniversitar

Zyra vendore e arsimit parauniversitar kryen detyrat e mëposhtme:

a) informon kandidatët për procedurat dhe rregullat e procesit të kualifikimit;

b) njofton kandidatët që të paraqesin kërkesën për kualifikim dhe portofolin profesional;

c) shqyrton dhe miraton kërkesat e paraqitura;

d) vlerëson me pikë portofolat e kandidatëve nga komisione të ngritura në ZVAP;

e) njofton secilin kandidat dhe drejtorinë e shkollës përkatëse për vlerësimin me pikë të portofolit;

f) dërgon në DRAP listën emërore të të gjithë kandidatëve me pikët e portofolit, sipas databazës së përcaktuar nga ASCAP-i;

g) njofton secilin kandidat për datën, orën e zhvillimit të provimit;

h) njofton për rezultatet në provim secilin kandidat dhe drejtorinë e shkollës përkatëse;

i) hedh në databazën e personelit mësimor të dhënat e reja të kualifikimit të mësuesve.

Neni 10

Detyrat dhe përgjegjësitë e kandidatit në provim

1. Ditën e zhvillimit të provimit, kandidatët duhet të respektojnë rregullat e mëposhtme:

a) të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);

b) të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të provimit;

c) të mos mbajnë dhe të mos përdorin telefonin celular dhe mjete të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo përbën kriter skualifikimi;

d) të mos pinë duhan dhe të mos konsumojnë ushqime në mjediset e provimit;



e) të mos komunikojnë me njëri-tjetrin gjatë zhvillimit të provimit.

2. Nëse një kandidat nuk paraqitet në provim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëherë provimi nuk vlerësohet si i kryer.

3. Në rast se kandidati hyn në provim dhe tërhiqet nga provimi pa e përfunduar atë, atëherë ai skualifikohet.

4. Kandidati që del nga salla e provimit nuk rihyn në sallë gjatë zhvillimit të provimit.

5. Mjediset ku zhvillohet provimi, monitorohen nëpërmjet strukturave të sigurimit të cilësisë së ASCAP-it.

KREU III ORGANIZIMI I PROVIMIT TË KUALIFIKIMIT

Neni 11 Portofoli i kandidatit

1. Portofoli personal i kandidatit përmban këto dokumente:

- a) jetëshkrimi (me fotografi);
- b) fotokopje e noterizuar e certifikatave me kreditet përkatëse;
- c) fotokopje e noterizuar e dëshmime të titujve/gradave shkencore (nëse ka);
- d) fotokopje e noterizuar e dëshmime të mbrojtjes së gjuhëve të huaja (nëse ka).

2. Portofoli profesional i kandidatit përmban këto dokumente:

- a) plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup-klasash, organizuar nga mësuesi përkatës;
- b) një planifikim të një mësimi model (ditar), duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin, sipas kurrikulës me kompetenca;
- c) një test/detyrë përmbledhëse për një periudhë të caktuar, sipas profilin përkatës;
- ç) rezultatet e të nxënit, sipas kompetencave lëndore për një periudhë të caktuar (në një lëndë dhe klasë të caktuar);
- d) një plan të një projekti kurrikular, së bashku me përshkrimin e realizimit të tij;
- e) gjuha e huaj e mbrojtur në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës ose në provime ndërkombëtare, të njohura sipas akteve ligjore në fuqi;

f) diplomë: diplomë e ciklit të dytë master, me 60–120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to, me 60–120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Diploma e ciklit të dytë nuk përfton pikë, nëse vlen si kriter arsimimi për profesionin e mësuesit.

3. Vlerësimi i portofolit profesional:

a) Komisioni i Vlerësimit të Portofolit (KVP), i ngritur nga titullari i ZVAP-së, vlerëson me pikë secilin dokument të portofolit profesional, sipas kriterëve të përcaktuara në shtojcën 1 dhe 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

b) Kandidati, që nuk fiton të paktën 1 pikë për çdo dokument të shkronjave “a”, “b”, “c”, “d”, të pikës 1 të këtij neni ose nuk i dorëzon ato, nuk merr pjesë në provimin e kualifikimit.

Neni 12 Programet orientuese të kualifikimit

1. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve hartohen nga ASCAP-i dhe vihen në dispozicion të kandidatëve nga ZVAP-të.

2. Programet orientuese të kualifikimit publikohen edhe në faqen zyrtare elektronike të ASCAP-it.

3. Programi orientues i kualifikimit të mësuesve të arsimit parashkollor bazohet në të gjitha programet mësimore të arsimit parashkollor.

4. Programi orientues i kualifikimit të mësuesve të arsimit fillor bazohet në të gjitha programet lëndore të arsimit fillor.

5. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve të arsimit të mesëm të ulët, të gjimnazit, të shkollave të specializuara, si dhe të mësuesve të kulturës së përgjithshme në arsimin profesional e arsimin e orientuar, bazohen në të gjitha programet e lëndëve që japin në shkollë.

6. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve që japin lëndët profesionale në shkollat artistike, bazohen në programet mësimore për degët e muzikës, artit pamor dhe baletit.

7. Programet orientuese të kualifikimit të mësuesve, që japin lëndët e kulturës profesionale në shkollat speciale, hartohen sipas programeve të përgjithshme të përgatitura nga ASCAP-i.



8. Mësuesit e arsimit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, që japin më shumë se një lëndë, do t'i nënshtrohen procesit të kualifikimit për lëndën në të cilën zhvillojnë më shumë orë mësimore vjetore gjatë vitit të kualifikimit. Për raste të veçanta është kompetencë e ZVAP-së të vendosë në cilën lëndë do të kualifikohet mësuesi.

Neni 13

Testet e provimit të kualifikimit

1. Testet e provimit të kualifikimit janë:

a) testi i arsimit parashkollor;

b) testi i arsimit fillor;

c) testi i arsimit të mesëm të ulët për lëndët: gjuhë shqipe, anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, qytetari, TIK, edukim fizik, muzikë, art pamor, si dhe lëndë të tjera specifike brenda planit mësimor, sipas kërkesave nga ZVAP-të;

ç) testi i gjimnazit dhe i kulturës së përgjithshme të shkollave të orientuara dhe speciale për lëndët: gjuhë shqipe dhe letërsi, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, matematikë, fizikë, biologji, kimi, histori, gjeografi, teknologji informacioni dhe komunikimi, ekonomi, qytetari, sociologji, psikologji, filozofi, edukim fizik, si dhe lëndë të tjera specifike brenda sistemit arsimor sipas kërkesave nga ZVAP-të;

d) testi për specialitetet “Muzikë”, “Art pamor” dhe “Balet” në kulturën profesionale në shkollat artistike;

dh) testi i përgjithshëm për mësuesit e kulturës profesionale në shkollat speciale.

2. Testet hartohen nga grupe të ngritura nga drejtuesi i ASCAP-it, të përbëra nga specialistë dhe mësues, sipas profileve përkatëse, të cilët nënshkruajnë kontratën me drejtorin e ASCAP-it.

3. Një test i provimit të kualifikimit përbëhet nga dy pjesë:

a) pjesa e parë përmban dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësuesve, programet përkatëse lëndore, metodologjinë e mësimdhënies dhe të nxënies në përgjithësi dhe të lëndës përkatëse, etikën, sjelljen dhe komunikimin e mësuesit në institucionin arsimor

parauniversitar, si dhe aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;

b) pjesa e dytë përfshin përmbajtjen shkencore të lëndës, sipas programit të kualifikimit përkatës.

Neni 14

Administrimi

1. Përgjegjësit e administrimit të provimit, administratorët dhe sekretuesit janë punonjës të DRAP/ZVAP-ve ose persona të caktuar nga titullari i DRAP-së dhe miratuar nga DPAP-ja.

2. ASCAP-i i dorëzon përgjegjësit të administrimit të provimit fletëtestet në ambientet e ASCAP-i.

3. Përgjegjësi i administrimit të provimit:

a) organizon zhvillimin korrekt të provimit bashkë me administratorët;

b) dorëzon te secili nga administratorët fletëtestet përkatëse;

c) zëvendëson një administrator me një nga administratorët rezervë, kur e shihet të nevojshme;

d) përjashton një kandidat nga provimi kur shkel rregullat e provimit;

e) lejon vetëm personat e autorizuar nga ministri, të futen në mjediset e provimit;

f) harton proces verbalin dhe ia dorëzon atë përfaqësuesit të ASCAP-it.

4. Administratori i provimit:

a) organizon zhvillimin korrekt të provimit;

b) respekton orarin e zhvillimit të provimit;

c) sigurohet, përpara fillimit të provimit, për identitetin e kandidatit nëpërmjet dokumentit të tij të identifikimit;

d) sigurohet që çdo kandidat është ulur në vendin e paracaktuar;

e) njeh kandidatët me rregullat e zhvillimit të provimit dhe masat disiplinore;

f) shpërndan fletëtestet kandidatëve;

g) nuk lejon asnjë person të paautorizuar të futet në mjedisin e provimit;

h) njofton menjëherë përgjegjësin e administrimit, kur shfaqen parregullsi që cenojnë mbarëvajtjen e provimit;

i) dorëzon te përgjegjësi i administrimit fletëtestet e përfunduara bashkë me fletëtestet e papërdorura;

j) harton procesverbalin e provimit dhe ia dorëzon përgjegjësit të administrimit.



5. Në përfundim të provimit të kualifikimit, përgjegjësi i administrimit i dorëzon përfaqësuesit të ASCAP-i kutinë me fletëtestet dhe materialet e provimit.

Neni 15

Mjediset e provimit të kualifikimit

1. Në një mjedis provimi vendosen vetëm kandidatët e një apo disa ZVAP-ve, sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.

2. Në hyrje të çdo mjedisi provimi shpallet në një vend të dukshëm, lista e kandidatëve në atë mjedis dhe vendi i secilit kandidat.

3. Në mjedisin e provimit, kandidatët qëndrojnë jo më pak se 1,5 m larg njëri-tjetrit.

4. Në ditën e provimit, në godinën ku zhvillohet provimi, nuk kryhet asnjë veprimtari tjetër.

5. Në mjedisin e provimit lejohen të hyjnë ose të qëndrojnë vetëm:

- a) përgjegjësi i administrimit të provimit;
- b) administratori;
- c) sekretuesi;
- d) persona të autorizuar nga ministri.

6. Numri i kandidatëve për 1 administrator është jo më i madh se 15.

7. Për numër të madh kandidatësh caktohen administratorë rezervë.

8. Një sekretues mbulon jo më shumë se 60 kandidatë.

Neni 16

Korrektesa

1. Kandidati nuk lejohet:

- a) të marrë ose të japë informacion ose kopje nga një kandidat tjetër;
- b) të komunikojë me një kandidat tjetër;
- c) të bëjë komente për përmbajtjen ose zgjidhjen e testit gjatë kohës së zhvillimit të provimit;
- ç) të mbajë celular ose mjet tjetër të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;
- d) të plotësojë testin me laps;
- dh) të shkruajë në fletën e provimit ndonjë shënim tjetër, përveç çfarë kërkon testi;
- e) të ketë me vete materiale të tjera, si: libra, fletore, fletë të bardha etj.;
- f) të ndërrojë vendin e paracaktuar;

g) të mos dorëzojë testin tek administratori.

2. Kandidati, që ka shkelur një nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “ç”, “dh”, “e”, “f” dhe “g”, të pikës 1 të këtij neni, sipas raportimit me shkrim të administratorit, skualifikohet nga provimi dhe nuk fiton kategorinë e kualifikimit.

3. Kandidatit që ka shkelur secilin nga detyrimet e përcaktuara në shkronjat “c” ose “d”, të pikës 1 të këtij neni, i ulen 10 pikë nga vlerësimi i testit.

4. Administruesi ndalohet:

- a) të japë kopje ose të lejojë të kopjohet;
- b) të mbajë celular gjatë zhvillimit të provimit;
- c) të largohet nga mjedisi i provimit duke lënë kandidatët pa një zëvendësues;
- ç) të komunikojë me kandidatin për përmbajtjen e testit;

d) të shfletojë ose të bëjë shënime në materialet e provimit, si gjatë edhe pas përfundimit të provimit.

6. ASCAP-i njofton MASR-në dhe DRAP/ZVAP-në përkatëse dhe më pas, DRAP/ZVAP-ja njofton drejtorin e institucionit arsimor përkatës, për:

- a) hartuesin e testeve që nuk ka ruajtur fshehtësinë e testit;
- b) vlerësuesin e testit që nuk është treguar korrekt gjatë vlerësimit të testeve;
- c) administratorin që nuk ka zbatuar udhëzuesin.

7. ASCAP-i mban procesverbal për rastet kur vëren parregullsi gjatë zhvillimit të provimit.

Neni 17

Sekretimi

1. Sekretimi i testeve bëhet me anë të barkodeve.

2. Në secilin test ka një vend të caktuar ku vendoset barkodi.

3. Sekretimi i testeve fillon menjëherë, pasi ka filluar procesi i provimit.

4. Sekretuesi vendos barkodin në test dhe në listën emërore të kandidatëve të përgatitur nga ASCAP-i. Kandidati nënshkruan pasi të ketë verifikuar emrin në listë.

5. Pas përfundimit të procesit të sekretimit, sekretuesi bën mbylljen e barkodeve të sekretimit të papërdorura.

**Neni 18
Vlerësimi**

1. Vlerësimi i testeve kryhet në Tiranë, në mjedise të përcaktuara nga ASCAP-i, nga komisionet e vlerësimit të testeve.

2. Vlerësuesi nënshkruan kontratën me drejtuesin e ASCAP-it.

3. Komisioni i vlerësimit të testeve është i përbërë nga dy anëtarë që janë specialistë ose bashkëpunëtorë të ASCAP-i për lëndën që testohet.

4. Komisioni i vlerësuesve vlerëson me pikë secilën nga dy pjesët e testit dhe veçon testet e dyshuara për kopjim.

5. Provimi quhet i kryer me sukses nëse kandidati ka fituar të paktën 40% të pikëve totale të testit.

6. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit bëhet me sistemin e 100 pikëve, nga të cilat 30 pikë janë të portofolit dhe 70 pikë janë të provimit.

7. Kandidati vlerësohet me pesë shkallë: A, B, C, D, E, që u korrespondojnë, përkatësisht vlerësimeve me fjalët “Shkëlqyeshëm”; “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm” dhe “Dobët”.

8. Kandidati nuk e fiton kualifikimin nëse vlerësimi përfundimtar i tij është “Dobët”.

**Neni 19
Shqyrtimi i testeve të dyshuara për kopjim**

1. Komisioni i shqyrtimit të testeve, i ngritur nga drejtori i ASCAP-it, identifikon testet e dyshuara për kopjim dhe shqyrton ankesat e kandidatëve për vlerësimin e kryer.

2. Komisioni përbëhet nga tre anëtarë, të cilët nënshkruajnë kontratë me drejtuesin e ASCAP-it.

3. Anëtarët e komisionit nënshkruajnë procesverbalin përkatës.

**Neni 20
Përsëritja e provimit të kualifikimit**

1. Kandidati ka të drejtë të hyjë në procesin e kualifikimit për çdo kategori dhe në rast se nuk e kalon me sukses provimin, hyn në provim në sesionin pasardhës.

2. Kandidati që e ka fituar kategorinë e kualifikimit dhe ka dëshirë të përmirësojë rezultatin, mund të futet në provim në sesionin pasardhës.

**Neni 21
Certifikimi**

1. Kandidati që fiton kategorinë e kualifikimit, pajiset me certifikatën në të cilën tregohet edhe vlerësimi me shkronjë i shoqëruar me përshkrim.

2. Certifikata prodhohet nga ASCAP-i dhe nënshkruhet nga drejtuesi i ASCAP-it.

3. ASCAP-i u dërgon certifikatat ZVAP-ve.

4. ZVAP-të u dorëzojnë certifikatat mësuesve përkatës.

**Neni 22
Procedura e ankimit**

1. Për portofolin:

a) kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim për vlerësimin të titullari i ZVAP-së brenda tri ditëve nga vlerësimi i portofolit;

b) titullari i dërgon ankuesit përgjigjen me shkrim brenda pesë ditëve nga data e dorëzimit të ankesës;

c) përgjigja e titullarit është përfundimtare.

2. Për zhvillimin e provimit:

a) Kandidati ka të drejtë të ankohet me shkrim, brenda tri ditëve nga data e përfundimit të provimit, të drejtuesi i ASCAP-it, për parregullsi gjatë zhvillimit të provimit ose për ndëshkimet që i janë dhënë nga administratori.

b) Drejtuesi i ASCAP-it i dërgon ankuesit përgjigjen me shkrim brenda dhjetë ditëve nga data e dorëzimit të ankesës.

3. Për vlerësimin e testeve:

a) brenda tri ditëve nga data e njoftimit të rezultateve të provimeve, ZVAP-ja mbledh të gjitha ankimet me shkrim të kandidatëve për vlerësimin e provimit dhe i dërgon në formë elektronike dhe me postë në DRAP;

b) brenda tri ditëve nga marrja e ankimeve nga ZVAP-të, DRAP-ja i mbledh të gjitha ankimet nga ZVAP-të përkatëse dhe i dërgon në ASCAP në formë elektronike dhe me postë, sipas formatit të përcaktuar nga ASCAP-i;

c) nëse ankesa e kandidatit gjykohet e drejtë, testi rivlerësohet;

d) vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Testeve është përfundimtar.

e) përgjigjet e vlerësimeve përfundimtare të kandidatëve u dërgohen në formë elektronike DRAP-së dhe ZVAP-së përkatëse.



Neni 23

Konflikti i interesit

1. Hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve dhe administratorët nuk lejohet të jenë:

- a) autorë të teksteve të nxënësit;
- b) autorë të librave ndihmës për nxënësit ose mësuesit (përveç atyre që botohen nga institucionet vartëse të MASR-së);
- c) kandidatë për kualifikimin e atij viti.

2. Hartuesit dhe vlerësuesit e testit, administratorët, anëtarët e komisioneve të shqyrtimit të testeve nuk duhet të kenë lidhje familjare me kandidatët (bashkëshort/bashkëshorte/bashkëjetues, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes/bashkëjetuesit).

3. Hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve dhe anëtari i komisioneve të shqyrtimit të testeve nënshkruajnë deklaratën e konfliktit të interesit në ASCAP-it.

Neni 24

Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim ruhet në institucionet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Aspekte financiare

1. Kandidatët i mbulojnë vetë shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të marrë pjesë në provimin e kualifikimit.

2. Shpenzimet për hartuesit e fondit të pyetjeve, hartuesit dhe vlerësuesit e testeve mbulohen nga ASCAP-i.

Neni 26

Objekti i inspektimit

1. Procedurat e vlerësimit të portofolave nga ZVAP-të dhe monitorimi i provimeve të kualifikimit përfshihen në platformat e inspektimit të ASCAP-it, DPAP-së dhe DRAP-ve.

2. Dokumentacioni i krijuar gjatë zbatimit të procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim është objekt i inspektimit të institucioneve të autorizuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore për arsimin parauniversitar.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

Hyrja në fuqi dhe dispozita të tjera

1. Udhëzimi nr. 8, datë 26.3.2020, “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”, shfuqizohet.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË

Evís Kushi



SHTOJCË 1

FORMATI PËR VLERËSIMIN E PORTOFOLIT TË KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE ARSIMORË NË ARSIMIN BAZË DHE ARSIMIN E MESËM TË LARTË¹

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

a)	Plani i një aktiviteti të një klase të caktuar ose grup-klasash, organizuar nga mësuesi përkatës: 1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit: 1 pikë 2. Përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit: 1 pikë 3. Prezantim i planit: 1 pikë	0–3 pikë
b)	Planifikim ditor me një strukturë të plotë bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin, sipas kurrikulës me kompetenca. (Mësuesi, nëse dëshiron, mund të hartojë plan ditor për dy orë të njëpasnjëshme.) 1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit ditor, sipas formatit të përcaktuar me kurrikulën me kompetenca: 1 pikë 2. Përcaktimi i rezultateve të të nxënit, sipas përmbajtjes së temës/temave mësimore: 1 pikë 3. Përshkrimi i teknikave të mësimdhënies dhe vlerësimit të arritjeve për realizimin e rezultateve të të nxënit: 1 pikë	0–3 pikë
c)	Test/detyrë përmbledhës/e për një periudhë të caktuar, sipas profilit përkatës: 1. Tipat e ushtrimeve/kërkesave. Struktura e testit/detyrës sipas niveleve: 1 pikë 2. Saktësia e pikëve për çdo tip ushtrimi/kërkesë: 1 pikë 3. Konvertimi i pikëve në nota: 1 pikë	0–3 pikë
ç)	Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç dhe kompetencave lëndore për një periudhë të caktuar (në një lëndë të klasës të caktuar). 1. Formulimit të rezultateve të të nxënit, sipas strukturës së përcaktuar: 1 pikë 2. Përdorimi i foljeve të përshtatshme në hartimin e rezultateve të të nxënit: 1 pikë 3. Përshtatja e rezultateve të të nxënit të periudhës me çështjet kryesore që do të trajtohen gjatë periudhës: 1 pikë	0–3 pikë
d)	Një plan të një projekti kurrikular së bashku me përshkrimin e realizimit të tij. 1. Përputhshmëria e rezultateve të të nxënit me temën e projektit: 1 pikë 2. Veprimtaritë kryesore të përfshira në projekt: 1 pikë 3. Mënyra e paraqitjes së gjetjeve të projektit: 1 pikë	0–3 pikë
e)	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja): 1. Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike: 3 pikë 2. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A1: 2 pikë 3. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel A2: 3 pikë 4. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1: 4 pikë 5. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B2: 5 pikë 6. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C1: 6 pikë 7. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel C2: 7 pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur, në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë dhe janë brenda afatit të vlefshmërisë, sipas legjislacionit përkatës. Pavarësisht, se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	0–7 pikë

¹ Vlerësimi për secilin element përmbajtësor të portofolit (a, b, c, ç, d) është 3 pikë. Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt skualifikohet. Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 5 pikë.



f)	Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master, me 60–120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to, me 60–120 kredite ECTS, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, të drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë, nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit. 1. Diploma me 60–90 kredite: 6 pikë 2. Diploma me 120 kredite: 7 pikë 3. Doktoratë: 8 pikë	0–8 pikë
----	---	----------

SHTOJCË 2
FORMATI PËR VLERËSIMIN E PORTOFOLIT TË KUALIFIKIMIT TË PUNONJËSVE
ARSIMORË
NË ARSIMIN PARASHKOLLOR²

Kriteret dhe skema e vlerësimit të portofolit të kandidatëve për procesin e kualifikimit.

a)	Plani i një aktiviteti të zhvilluar në bashkëpunim me prindërit: 1. Struktura e ndjekur në shkrimin e planit të aktivitetit: 1 pikë 2. Përcaktimi i rezultateve të pritshme nga zhvillimi i aktivitetit: 1 pikë 3. Prezantimi i planit: 1 pikë	0–3 pikë
b)	Planifikimi ditor (PD): 1. Lidhja e rezultateve të të nxënës me temën ditore: 1 pikë 2. Zbatimi i kërkesave të formatit të planifikimit sipas kurrikulës së re: 1 pikë 3. Veprimtaritë dhe metodat aktive të të mësuarit të planifikuara nga mësuesi (të shtjelluara): 1 pikë	0–3 pikë
c)	Vlerësimi i fëmijëve (TK): 1. Vëzhgime dhe shënime individuale: 1 pikë 2. Listëkontrolle: 1 pikë 3. Portofoli i të nxënës: 1 pikë	0–3 pikë
ç)	Planifikimi dhe zhvillimi i një teme mujore ose i projektit, sipas metodologjisë me të cilën punon kopshiti. 1. Struktura e planifikimit mujor/projektit sipas formatit të kurrikulës së re: 1 pikë 2. Lidhja e rezultateve të të nxënës me trajtimin e koncepteve lëndore: 1 pikë 3. Planet javore me aktivitetet e planifikuara: 1 pikë	0–3 pikë
d)	Punime të fëmijëve (mundësisht të lidhura me rubrikën 4) (PK): 1. Përshtatja e punimeve me grup-moshën e fëmijëve: 1 pikë 2. Larmia e punimeve të lidhura me konceptet lëndore dhe veprimtari të lira të zhvilluara në kopsht: 1 pikë 3. Shembuj produktesh mujore ose të realizuara në kuadrin e një projekti: 1 pikë	0–3 pikë
e)	Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja (jo mësues të gjuhëve të huaja): 1. Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike: 3 pikë 2. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A1 2: pikë 3. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli A2 3: pikë 4. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 4: pikë 5. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 5: pikë 6. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C1 6: pikë 7. Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli C2 7: pikë Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti, kur gjuha e huaj është e mbrojtur, në kuadër të përfundimit të studimeve të larta të ciklit të dytë dhe është brenda afatit të vlefshmërisë, sipas legjislacionit përkatës.	0–7 pikë

² Vlerësimi për secilin element përmbajtësor të portofolit (a, b, c, ç, d) është 3 pikë. Është e detyrueshme që në çdo element mësuesi të fitojë të paktën 1 pikë, sepse në rast të kundërt skualifikohet. Minimumi për kalimin e portofolit përmbajtësor është 5 pikë.



	Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 7 pikë në vlerësimin e portofolit. Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.	
f)	Diplomë: Diplomë e ciklit të dytë master, me 60–120 kredite ECTS, diplomat e ciklit të tretë “Master ekzekutiv” ose të barasvlershme me to, doktoratë të fituar në fushën e edukimit, e drejtimit të arsimit dhe/ose që lidhet me profilin përkatës. Kjo lloj diplome nuk përfiton pikë shtesë, nëse vlen si kriter shkollimi për profesionin e mësuesit: 1. Diploma me 60–90 kredite: 6 pikë 2. Diploma me 120 kredite: 7 pikë 3. Doktoratë: 8 pikë	0–8 pikë

UDHËZIM**Nr. 5, datë 3.3.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020,
“PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE
PËRBËRËSE, FORMËN E DIPLOMËS
OSE CERTIFIKATËS SË LËSHUAR NGA
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË
LARTË DHE PROCEDURËS SË
REGJISTRIMIT TË TYRE NË
REGJISTRIN SHTETËROR TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR ARSIMIN E LARTË DHE
KËRKIMIN SHKENCOR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “m”, e pikës 1, të kreut II, riformulohet si vijon:

“m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës, për diplomat që janë lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe ID e Maturës Shtetërore/numri i dokumentit të njëvlershmërisë së dëftesës/diplomës së arsimit të mesëm të lartë që është lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë (numri i regjistrimit të veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat “Bachelor”,

diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat “Master i shkencave” të programeve të integruara të studimeve;”.

b) Shkronja “n”, e pikës 1, të kreut II, riformulohet si vijon:

“n) Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë për diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/Numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimit të diplomës;”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

VENDIM**Nr.4, datë 8.3.2021**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e	Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e	“ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e	“ “
Fiona Papajorgji	anëtare e	“ “
Altin Binaj	anëtar i	“ “
Përparim Kalo	anëtar i	“ “
Sonila Bejtja	anëtare e	“ “

me sekretare Blerina Basha, në datën 4.2.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen nr. 57 (S) akti, që u përket:



KËRKUESE: Shoqata kombëtare “Pronësi me drejtësi”, përfaqësuar nga av. Suela Mëneri, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga znj. Mimoza Arbi, me autorizim.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga Avokatja e Shtetit znj. Enkelejda Muçaj, me autorizim.

MINISTRIA E DREJTËSISË, përfaqësuar nga z. Erind Mërkuri, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Lirët Themelore të Njeriut (KEDNJ) i nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 133/2015, datë 5.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.

Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 222, datë 23.3.2016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” dhe VKM-së nr. 765, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 222, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”.

Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 223, datë 23.3.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” dhe VKM-së nr. 766, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar”.

Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në i VKM-së nr. 658, datë 26.9.2012, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, 15, 17, 18, pika 1, 41, 42, pika 1, 122, 131, 132, 134, pika 1, shkronja “h” dhe 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 6, pika 1, 13, 14, 18 dhe 41

të KEDNJ-së dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet e kërkeses, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 5.12.2015 Kuvendi i Shqipërisë, me propozimin e Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*ligji nr. 133/2015*), objekti i të cilit është rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet, në përputhje me nenin 41 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së. Për këtë qëllim, ligji parashikon procedurat për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave, si dhe përgjegjësitë e organeve administrative të ngarkuara për realizimin e tyre. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji është shfuqizuar ligji nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar (*ligji nr. 9235/2004*), si dhe ligji nr. 10239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, i ndryshuar.

2. Në vitin 2016 ky ligj është kundërshtuar në tërësinë e tij në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) nga disa subjekte, mes të cilave edhe shoqata kombëtare “Pronësi me drejtësi”. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 (*vendimi nr. 1/2017*), Gjykata ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të kërkesës. Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 133/2015, Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6, pika 1, shkronja “b”, si dhe të



nenit 7, pika 2, shkronja “a” dhe “b” të ligjit të mësipërm. *Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër*.”.

3. Në bazë të nenit 37 të ligjit nr. 133/2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 222, datë 23.3.2016, “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj” (VKM nr. 222/2016), e cila rregullon procedurat për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e akteve të subjekteve të shpronësuara gjatë procesit të njohjes e të kompensimit të pronës, dhe VKM-në nr. 223, datë 23.3.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (VKM nr. 223/2016), e cila përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar dhe fizik për kompensimin e pronave.

4. Shoqata kombëtare “Pronësi me drejtësi” (*kërkuesja*), duke pretenduar se dispozitat e nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 133/2015, si dhe ato të nenit 18, shkronjat “b” dhe “c” të VKM-së nr. 222/2016 dhe nenit 3, shkronjat “b” dhe “c” të VKM-së nr. 223/2016, bien ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e tyre si të papajtueshme me Kushtetutën, kërkesë që është regjistruar në Gjykatë me nr. S-57, datë 11.12.2017.

5. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 658, datë 26.9.2012, “Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 658/2012) është miratuar metodologjia sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Sipas këtij akti, metodologjia për vlerësimin e pronave të paluajtshme është burimi i vetëm zyrtar për përllogaritjen e vlerës së pasurive të paluajtshme dhe miratimi i vlerës së pronës për secilin qark do të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Në datën 3.2.2016, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 9235/2004 dhe në vijim të pikës 3 të VKM-së nr. 658/2012, Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” (VKM nr. 89/2016), me të cilin është miratuar vlera e tokës sipas hartave që i bashkëlidhen dhe janë pjesë e këtij vendimi. Kërkuesja, duke pretenduar se përmbajtja e VKM-së nr. 89/2016 bie ndesh me

parimet dhe standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e saj, e cila është regjistruar me nr. S-59, datë 26.12.2017.

6. Në lidhje me këtë kërkesë, me shkresën e datës 15.3.2018, kërkuesja ka paraqitur në Gjykatë komente shtesë, ku shprehet për zgjerimin e objektit të ankimit, duke kërkuar edhe kontrollin e kushtetutshmërisë së VKM-së nr. 658/2012, për shkak të lidhjes organike mes këtyre dy akteve. Sipas kërkueses, njëra normë nuk kuptohet pa tjetrën dhe mospërputhja e hartave të vlerës, të miratuara nga qeveria sipas kësaj VKM-je, ka krijuar “situatë të vazhdueshme” të shkeljes të së drejtës së saj për kompensim të drejtë, të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm.

7. Në datën 27.12.2017, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 765, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 222, datë 23.3.2016 të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj’” (VKM nr. 765/2017) dhe VKM-në nr. 766, datë 20.12.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016 të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave’, të ndryshuar” (VKM nr. 766/2017). Duke pretenduar se dispozitat e VKM-së nr. 222/2016 (të ndryshuar me VKM-në nr. 765/2017) dhe të VKM-së nr. 223/2016 (të ndryshuar me VKM-në nr. 766/2017) në tërësinë e tyre bien ndesh me parimet dhe standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e këtyre akteve, kërkesa që janë regjistruar në Gjykatë përkatësisht me nr. S-15, datë 5.4.2018 dhe nr. S-14, datë 5.4.2018.

8. Me vendimet e datës 22.2.2018 të Mbledhjes së Gjyqtarëve, si dhe vendimet e datës 20.6.2018 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, është vendosur kalimi i çështjeve të mësipërme për shqyrtim në seancë plenare.

9. Me vendimin e datës 7.1.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur bashkimin e çështjeve që u përkasin kërkesave të shoqatës kombëtare “Pronësi me drejtësi” (S-57, datë 11.12.2017; S-59, datë 26.12.2017; S-14, datë 5.4.2018 dhe S-15, datë 5.4.2018), me objekt shfuqizimin e ligjit nr. 133/2015 dhe të vendimeve



nr. 222/2016, nr. 223/2016, nr. 89/2016, nr. 765/2017 dhe nr. 766/2017 të Këshillit të Ministrave në një të vetme. Po ashtu, për shkak të situatës dhe rregullave në fuqi të shkaktuara nga COVID-19, në zbatim të nenit 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka vendosur zhvillimin e seancës plenare me praninë e kërkueses dhe të subjekteve të interesuara, por pa praninë e publikut.

10. Në seancën plenare të datës 4.2.2021, gjatë parashtrimit të kërkesave paraprake, përfaqësuesja e kërkueses u shpreh se interesi për shtimin e objektit, i paraqitur me kërkesën e datës 15.3.2018 nuk ka ndryshuar. Gjykata, pasi dëgjoi edhe përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, të cilët kërkuan mospranimin e saj, vendosi të pranojë kërkesën për shtim objekti, duke përfshirë në këtë gjykim edhe VKM-në nr. 658/2012.

II

Pretendimet e palëve

11. **Kërkuesja, shoqata kombëtare “Pronësi me drejtësi”**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se aktet e kundërshtuara prej saj cenojnë këto të drejta dhe parime kushtetuese:

A. Për ligjin nr. 133/2015

11.1 *Të drejtën e pronës private dhe parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes*, pasi në parashikimet e nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, kemi të bëjmë me konceptin e një “shpronësimi të ri”, i njëjtë me atë që ka konstatuar Gjykata në vendimin e saj nr. 1/2017, me të cilin ka shfuqizuar pikat 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit.

11.2 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi duke e konsideruar metodologjinë e përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 6 në funksion të parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të këtij neni, të cilat tashmë janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese, ka rënë baza ligjore që mban akoma në fuqi pikën 1, shkronja “b”, të nenit 6 për sa kohë që kjo dispozitë nuk mund të gjejë zbatim pa dispozitat e shfuqizuara tashmë. Shfuqizimi i pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 sjell si pasojë mosfunksionimin e një hallke themelore të metodologjisë së vlerësimit, që ka për bazë “përfitimet e zbritshme” dhe në mungesë të saj dispozitat e mbetura në fuqi karakterizohen nga paqartësia.

11.3 Zbatueshmëria e nenit 6 kushtëzohet po në nenin 7, pika 2, me procedurën e parashikuar në

pikat “a” dhe “b” të tij, të cilat lidhen në mënyrë organike vetëm me dispozitat e nenit 6, pikat 3 dhe 5, që në tërësi parashikojnë rivlerësimin e pronave të kthyera ose të kompensuara para hyrjes në fuqi të ligjit. Nëpërmjet nenit 6, pikat 3 dhe 5 dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, ligjvënësi shpreh qëllimin e tij të qartë se rivlerësimi i pronave do të bëhet sipas parimit të “përfitimeve të zbritshme”. Këto rregullime janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe shprehin një vazhdimësi, e cila me shpalljen si jokushtetuese të pikave 3 dhe 5 të nenit 6, automatikisht lë hapësirë për arbitraritet nga ana e ligjbatuesve, të cilët duke rrëzuar ose zhvlerësuar kërkesat e pronarëve, bazuar në parashikimet e nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, kanë krijuar konfuzion në drejtëm të pritshmërive të ligjshme të subjekteve të shpronësuara.

B. Për VKM-në nr. 222/2016, të ndryshuar me VKM-në nr. 765/2017

11.4 *Të drejtën e pronës private*, pasi trajtimi me kritere të reja të kërkesave që presin prej vitesh në Agjencinë e Trajtimit të Pronave (ATP), vendos një barrë joproportionale për subjektet. Kjo e drejtë kufizohet në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, pasi tagrin për të ndërhyrë në të e ka vetëm Kuvendi dhe jo Këshilli i Ministrave.

11.5 *Parimin e sigurisë juridike*, pasi Këshilli i Ministrave ka transferuar në këtë akt një numër të konsiderueshëm të parashikimeve të ligjit, të cilat, më pas, janë bërë objekt i ndryshimeve, duke shtuar, pakësuar ose ndryshuar dukshëm kontekstin e tyre.

11.6 *Parimin e hierarkisë së akteve normative*, pasi Kuvendi e ka autorizuar Këshillin e Ministrave të miratojë një listë të dokumenteve të nevojshme për procesin e trajtimit të pronës sipas ligjit nr. 133/2015, por jo të rregullojë trajtimin e kërkesave për njohjen e së drejtës. Kjo VKM mbështetet në nenin 37 të ligjit, i cili parashikon vetëm afatet brenda të cilave Këshilli i Ministrave duhet të miratojë aktet për të cilat është autorizuar nga vetë ligji. Po ashtu, ky akt i jep ATP-së një diskrecion edhe më të gjerë se ligji për të mbledhur, administruar dhe përpunuar aktet.

11.7 *Të drejtën për proces të rregullt dhe mjete juridike efektive*, sepse që kërkesat për njohje dhe kthim ose kompensim të trajtohen nga ATP-ja, duhet të plotësojnë jo vetëm kushtet e ligjit nr. 133/2015, por edhe ato të parashikuara në këtë VKM.



C. Për VKM-në nr. 223/2016, të ndryshuar me VKM-në nr. 766/2017

11.8 Të drejtën e pronës private, pasi kufizimet e imponuara nga ky akt nënligjor vendosin një barrë joproporcionale mbi të drejtën e individit për mbrojtjen e pronës dhe procesin e rregullt. Ky akt, në tejkalim të ligjit, parashikon kryerjen e hetimit administrativ nga ana e ATP-së para dhënies së kompensimit. Përveçse subjektet kërkuese jetojnë në një gjendje pasigurie, kohëzgjatja e proceseve të nevojshme për realizimin e të drejtave të tyre do e shtojë edhe më tej këtë barrë. Kjo e drejtë kufizohet në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës, pasi tagrin për të ndërhyrë në të e ka vetëm Kuvendi dhe jo Këshilli i Ministrave.

11.9 Parimin e sigurisë juridike, pasi Këshilli i Ministrave ka transferuar një numër të konsiderueshëm të parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 në VKM-në nr. 223/2016, çka bie ndesh me kërkesën për të evituar ndryshimet e shpeshta ligjore, pasi pas përfshirjes të këtyre dispozitave në VKM, ato janë bërë objekt i ndryshimeve nga ana e Këshillit të Ministrave.

11.10 Parimin e hierarkisë së akteve normative, pasi ligji nr. 133/2015 nuk e ka autorizuar shprehimisht Këshillin e Ministrave që të rregullojë masën dhe mënyrën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara që kanë një vendim përfundimtar për kompensim. Ky akt nënligjor tejkalon frymën e ligjit dhe paraqet një burim të ri të së drejtës, të ndryshëm nga ligji nr. 133/2015 dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar nga ATP-ja. Akti i kundërshtuar mbështetet në nenin 37 të ligjit, i cili parashikon vetëm afatet brenda të cilave Këshilli i Ministrave duhet të miratojë aktet për të cilat është autorizuar nga vetë ligji.

Ç. Për VKM-në nr. 89/2016

11.11. Të drejtën e pronës private, pasi vlerësimi financiar i llogaritur duke përdorur metodologjinë sipas VKM-së nr. 89/2016 është disa herë më i ulët se ai i përdorur nga GJEDNJ-ja me çmimin e hartës së vitit 2008. Mes hartave të vlerave të viteve 2008 dhe 2016 janë vënë re shpërpjesëtime të konsiderueshme.

11.12 Legjislacioni mbi të cilin është hartuar VKM-ja nr. 89/2016 është ligji nr. 9235/2004, në preambulën e të cilit rikonfirmohet vijimësia e VKM-së nr. 658/2012. Kjo metodologji parashikon vlerësimin e pronës sipas standardit ndërkombëtar, ku evidentohen 3 komponentë

bazë: çmimi i tregut, lloji i pasurisë dhe qëllimi i përdorimit të saj. Ajo synon të pasqyrojë vlerën e tregut të pasurive të paluajtshme vit pas viti, duke iu referuar luhatjeve të tij. Megjithatë, zbatueshmëria e saj në sistemin e brendshëm është vënë në dyshim nga GJEDNJ-ja. Përpyekjet e palës shtetërore për të paraqitur të tjera harta të vlerës së pronës nga ato të vitit 2008 janë rrëzuar nga GJEDNJ-ja, e cila ka hedhur poshtë referencat e ndryshme nga ato të përcaktuara në çështjen *Vrioni kundër Shqipërisë*, ku ka vënë në dukje, ndër të tjera, se çmimi i referencës, i pasqyruar në hartat e vlerës së vitit 2008, ka reflektuar vlerën reale të tregut, të indeksuar edhe sipas interesave dhe inflacionit të kohës së miratimit të tij.

11.13 Në hartën e vitit 2016, për shembull në qytetin e Tiranës, në disa zona kadastrale vlera e çmimit të kompensimit është rreth 2 herë më e vogël sesa ajo e parashikuar në hartat e vitit 2008, rënie kjo që vë në dyshim mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e kompensimit të subjekteve të shpronësuara.

D. Për VKM-në nr. 658/2012

11.14 Në këtë akt nënligjor parashikohet se metodologjia e vlerësimit të pasurive të paluajtshme bazohet te standardet ndërkombëtare të vlerësimit të tyre, të cilat paraqiten në aneksin 1/1, por mungon saktësia e nevojshme në kuptim të parimit të ligjshmërisë. VKM-ja nr. 658/2012 mbart edhe kontradiksione në vetvete dhe nuk rezulton e qartë se si janë aplikuar teknikat vlerësuese.

11.15 Ndryshimet e bëra në ligjin nr. 9235/2004 përcaktojnë si standarde ndërkombëtare ato të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme. VKM-ja nr. 658/2012 bie ndesh edhe me këto standarde, pasi ajo i përmbahet metodikës së krahasimit të shitjeve, ndërsa standardet kanë për bazë procedurat e vlerësimit të pronës me vlerën e tregut, sipas tri metodave tradicionale për llogaritjen e vlerës së saj. Po ashtu, në këtë akt trojet dhe tokat bujqësore trajtohen sipas së njëjtës metodologji, kurse sipas standardeve, për tokën bujqësore parashikohet aplikimi i vlerës së përdorimit.

12. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka prapësuar para Gjykatës sa vijon:

12.1 *Shqyrtimi i kësaj çështjeje përbën "gjë të gjykuar"*. Me vendimin nr. 1/2017 Gjykata Kushtetuese ka analizuar dhe shqyrtuar kushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, por për shkak të



mungesës së kuorumit ka refuzuar të shprehet. Me ndryshimet që i janë bërë ligjit organik të Gjykatës me ligjin nr. 99/2016, është shfuqizuar edhe parashikimi në nenin 74 që i lejonte palës të riparaqiste kërkesë në rast të refuzimit të saj. Kërkesa në shqyrtim është paraqitur nga kërkuuesja pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe duke qenë dispozita procedurale ato gjejnë zbatim për çështjet në gjykim.

12.2 *Ligji nr. 133/2015 respekton standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së*, duke ruajtur një balancë midis interesit publik dhe kompensimit të drejtë, si pjesë e parimeve të drejtësisë, proporcionalitetit dhe shtetit të së drejtës. Por këto parime nuk kërkojnë dhe nuk mund të kuptohen si një kthim i plotë i të drejtave të pronësisë për të gjitha subjektet e shpronësuara (trashëgimtarët e tyre) ose kompensimin e tyre me vlerën e plotë. Ligjvënësi ka synuar të korrigjojë, për aq sa është e mundur dhe brenda mundësive ekonomike dhe sociale të vendit, padrejtësitë e regjimit të kaluar në dëm të pronës private.

12.3 Metodologjia e përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 133/2015 synon të kompensojë subjektet e shpronësuara me vlerën e tokës sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 89/2016, duke krijuar një formulë të thjeshtë dhe të parashikueshme, e cila trajton subjektet në të njëjtën mënyrë, duke filluar nga e njëjta pikënisje, me vlerën e pronës në kohën e shpronësimit. Në këto dispozita, që përbëjnë pjesën themelore të ligjit, përcaktohet kriteri i përpjesëtimin të drejtë midis ndërhyrjes së ligjvënësit dhe gjendjes që e dikton atë.

12.4 Pretendimet në lidhje me dispozitat e kundërshtuara kanë qenë objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese, e cila, me vendimin nr. 1/2017, ka argumentuar se përse përmbajtja e pikave 3 dhe 5 të nenit 6 cenon parimin e sigurisë juridike. Neni 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, i ligjit nr. 133/2015, nuk ka lidhje organike me dispozitat e shfuqizuara. Metodologjia e parashikuar në këtë dispozitë përkon me një nga objektivat e ligjit, që është konvertimi i vendimeve të kompensimit nga sipërfaqja në vlerë monetare, veprimtari që materializon kriteret e barazisë.

12.5 Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1/2017, Këshilli i Ministrave, duke qenë se dispozitat e shfuqizuara nuk kishin sjellë ndryshime materiale në ligjin nr. 133/2015, pra në formulën e kompensimit, për të siguruar respektimin e parimit

të sigurisë juridike dhe për të ofruar qartësi për procedurat, unifikoi procedurën vendimmarrëse për kërkesat e mbetura pezull, duke ndryshuar dhe përmirësuar përmbajtjen e VKM-ve nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016.

13. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, ka prapësuar para Gjykatës sa vijon:

13.1 *Kërkesa përbën gjë të gjykuar*, pasi të njëjtat pretendime në drejtim të ligjit dhe akteve nënligjore, për të njëjtat shkaqe, janë ngritur gjatë procesit ligjbërës në konsultimet me grupet e interesit dhe ato janë konsideruar jo të mirëqena nga ekspertë të së drejtës dhe autoriteti ligjbërës. Të njëjtat argumente ka trajtuar edhe Komisioni i Venecias, i cili, jo vetëm nuk i ka pranuar ato, por ka arritur në përfundimin se ligji nuk cenon parimet që hyjnë në fushëveprimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Po ashtu, këto pretendime të kërkuësës janë vlerësuar në tërësinë e tyre edhe nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 1/2017, ku është bërë një analizë e hollësishme dhe e qartë e nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 dhe parimeve kushtetuese që ai sanksionon.

A. Për ligjin nr. 133/2015

13.2 *Pretendimet e kërkuësës janë të pabazuara*. Qëllimi i ligjit nr. 133/2015 është të garantojë të drejta të barabarta për subjektet e shpronësuara dhe të shmangë diskriminimin në mënyrën e llogaritjes së formulës së kompensimit, sipas nenit 6. Ky ligj trajton në mënyrë të barabartë të gjitha subjektet e shpronësuara, duke marrë si referencë vlerën e hartës në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit dhe zërin kadastral që prona ka pasur në kohën e shpronësimit. Në nenin 7 të tij përcaktohet procedura që do të ndiqet në lidhje me kompensimin pas vlerësimit të pronës, sipas formulës së përcaktuar në nenin 6, pika 1.

13.3 Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 1/2017, ka lënë në fuqi jo vetëm formulën, por edhe mekanizmin e ndërtuar nga ligji, duke kërkuar procedura më të qarta në momentin e vlerësimit të vendimeve. Nëse Gjykata do të konstatonte krijimin e boshllëkut ligjor me shfuqizimin që u ka bërë pikave 3 dhe 5 të nenit 6, ajo do të vendoste edhe detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor, në kuptim të nenit 78 të ligjit nr. 8577/2000. Gjykata e ka vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjit në tërësinë e tij dhe nuk ka konstatuar elemente të tjera antikushtetuese, prandaj nuk ka vendosur detyrime për korrigjimin e tyre. Ky fakt përbën një



argument tjetër se shfuqizimi i pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 plotësohet më së miri nga dispozita të tjera të këtij ligji, konkretisht ato të parashikuara në nenin 7 të tij, i cili qëndron i pavarur dhe nuk ka asnjë lidhje organike me pikat 3 dhe 5 të nenit 6, të shfuqizuara.

13.4 Formula dhe mekanizmi i ndërtuar nga ligji në tërësinë e tyre janë lënë në fuqi edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin *Beshiri kundër Shqipërisë*, i vitit 2020, e cila ka analizuar dhe ka pranuar ndërhyrjen proporcionale në të drejtën e pronës për shkak të interesit publik. Pretendimin për antikushtetutshmërinë e dispozitave të kundërshtuara, pasi zbatimi i skemës së kompensimit do të rezultonte në shuma kompensimi më të ulëta se ato që do të ishin marrë në zbatim të ligjit të vitit 2004, GJEDNJ-ja e ka shqyrtuar dhe nuk e ka pranuar.

13.5 Ligji nr. 133/2015 i ka prodhuar efektet e tij. Në ATP janë vlerësuar mijëra vendime të periudhës 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të pronës.

B. Për VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016

13.6 Ligji nr. 133/2015 paraqitet si një ligj kuadër, i cili parashikon parimet se si do të bëhet i mundur kompensimi i subjekteve të shpronësuara dhe nuk jep detaje për procedurat dhe teknikat se si duhet të zhvillohet ky proces, ndaj ligjvënësi ka autorizuar Këshillin e Ministrave për të miratuar të gjitha aktet që do e bëjnë të mundur zbatimin efektit të ligjit. Aktet nënligjore janë nxjerrë në zbatim të neneve 100 dhe 118, pika 1, të Kushtetutës dhe Këshilli i Ministrave ka respektuar rezervën ligjore, duke vepruar në përmbushje të kompetencave të veta, në përputhje me objektivin e ligjit dhe për të arritur qëllimin e tij.

13.7 Ndryshimet e miratuara në këto VKM janë rezultat i zgjidhjes së problematikave procedurale të hasura gjatë shqyrtimit të kërkesave dhe i zbatimit të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 1/2017. Me këto ndryshime u unifikua trajtimi i kërkesave të patrajuara nga ATP-ja me ato në proces shqyrtimi dhe ato për të cilat ekzistojnë vendime përfundimtare, duke iu nënshtruar vlerësimit financiar dhe rregullave të kompensimit që janë të njëjta dhe bazohen në formulën dhe procedurat e ligjit nr. 133/2015. Këshilli i Ministrave, brenda hapësirës që i ka lejuar Kushtetuta dhe ligji, ka përcaktuar kushtet, kriteret dhe metodologjinë që ndiqet në përcaktimin e

vlerës së kompensimit financiar të subjekteve të shpronësuara, e cila bazohet në konceptin kushtetues të shpërblimit të drejtë dhe jo sipas vlerës së plotë të tregut.

13.8 Neni 37 i ligjit nr. 133/2015 ka të bëjë me autorizimin/detyrimin e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore për bërjen të zbatueshëm të ligjit. Afati 6-mujor është caktuar me qëllim moszvarritjen në kohë të procesit të trajtimit të pronës, por nuk mund të interpretohet si limit kohor brenda të cilit pushteti ekzekutiv duhet të miratojë këto akte.

13.9 Ligji nr. 133/2015 i ka bërë një delegim konkret Këshillit të Ministrave për të përcaktuar listën e dokumenteve të nevojshme për procesin e trajtimit të pronës. Ndryshimi i pikës 3, shkronja “c”, të VKM nr. 222/2016 me VKM-në nr. 765/2017 ka ardhur si rezultat i praktikës së punës gjatë hetimit administrativ dhe ajo nuk e ka shtuar artificialisht numrin e dokumenteve që subjekti duhet të dorëzojë për të provuar të drejtën e pronës, por, përkundrazi, e ka lehtësuar atë. Kurse dokumentacioni hartografik i kërkuar sipas VKM-së nr. 222/2016 ka thjeshtuar kërkesën e dokumentacionit të kërkuar ndër vite sipas legjislacionit të kohës që ka trajtuar njohjen e pronësisë.

13.10 Për sa i përket pikës 15 të VKM-së nr. 222/2016 nuk jemi para kushtëzimit të së drejtës së njohjes së pronës, por para kompensimit fizik ose kompensimit me një nga format e tjera që përcakton ligji. Pra, subjektit i njihet plotësisht prona e pretenduar, por nëse ajo është e zënë, në kuptim të neneve 24 e 25 të ligjit, nuk mund të kompensohet fizikisht. Ndërsa kërkitimi i informacionit nga Agjencia Shqiptare e Investimeve ka ardhur si rezultat i zbatimit të përcaktimeve ligjore të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”.

13.11 Në ndryshim nga sa pretendon kërkuuesja, parashikimet e VKM-ve të kundërshtuara janë në favor të subjekteve dhe një garanci më tepër për ta. Hetimi administrativ në këtë rast është një domosdoshmëri, pasi për shkak të kohës së gjatë të aplikimit për të përfituar nga legjislacioni, në disa raste mbi 10 vjet, nevojitet verifikimi i tyre. ATP-ja para se të disponojë me vendim, dhe në rastet kur ajo e vlerëson, paraprakisht duhet të kryejë një hetim administrativ, në të kundërt do të ishim në një situatë paligjshmërie. Nëse nuk kryhet hetim



administrativ ekziston rreziku i cenimit të të drejtave të subjekteve kërkuese. Kjo vlen edhe kur kemi një vendim përfundimtar dhe procedura e ekzekutimit, gjithashtu, duhet të ketë hetimin e vet administrativ.

13.12 Këshilli i Ministrave ka përcaktuar vetëm rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e Fondit të Kompensimit, i cili përbëhet nga fondi financiar dhe fondi i tokës referuar burimeve që ka në dispozicion shteti shqiptar për ekzekutimin e kësaj fature financiare. Prioriteti i mënyrave ose formave të kompensimit është në përputhje të plotë me frymën e ligjit dhe në diskrecion të pushtetit ekzekutiv.

13.13 Pretendimet se VKM-ja nr. 223/2016 bie ndesh me nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës, si dhe me nenet 6, pika 1, dhe 13 të KEDNJ-së, nuk përputhen me përmbajtjen e kërkesës. Duke nënkuptuar me proces të rregullt jo vetëm atë gjyqësor, por edhe atë pranë institucioneve shtetërore, nuk rezulton që kërkuesja të ketë paraqitur ankimin administrativ ose gjyqësor për çështjen objekt gjykimi dhe t'i jenë mohuar të drejtat e garantuara nga këto dispozita.

13.14 Qëllimi i ligjit nr. 133/2015, përveç përfundimit të procesit të trajtimit nëpërmjet njohjes së pronave të subjekteve, është edhe rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i kompensimit të pronës, i cili është i ndarë në 2 faza. Faza e parë (nenet 6, 7 dhe 8), ku përcaktohet mënyra e vlerësimit financiar të pronave të njohura për kompensim dhe faza e dytë, ekzekutimi, ku ligji përcakton katër mënyra kompensimi. Në ndryshim nga kuadri ligjor i mëparshëm, ky ligj nuk u njeh të drejtën subjekteve të shpronësuara për të zgjedhur një nga këto mënyra, por është në diskrecion të shtetit që të përzgjedhë mënyrën më të përshtatshme, bazuar në fondin që ka në dispozicion. Në këtë frymë është miratuar edhe VKM-ja nr. 223/2016 dhe përcaktimet e saj u përmbahen urdhërimeve të ligjit dhe nuk cenojnë rezervën ligjore relative sipas nenit 118 të Kushtetutës.

13.15 Ligjvënësi nuk ka përcaktuar në ligj se sa do të jetë masa e kompensimit financiar dhe fizik për çdo subjekt, duke ia deleguar këtë të drejtë Këshillit të Ministrave, si organi që njeh më mirë fondet buxhetore të shtetit. Ligji nuk u ka garantuar asnjë pritshmëri subjekteve për sa i takon masës së përfitimit nga fondi financiar ose fizik. Mënyra e

miratuar me VKM-në nr. 223/2016 është rrjedhojë e llogaritjeve të kryera si rezultat i nxjerrjes së vlerës financiare nga ATP-ja në përfundim të procesit të vlerësimit.

13.16 Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ligjshmërinë e VKM-ve nr. 223/2016 dhe nr. 766/2017 dhe ka vendosur rrëzimin e padive. Përveç themelit, gjykata administrative është shprehur edhe në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e këtij kërkimi.

C. Për VKM-në nr. 89/2016

13.17 Kërkimet objekt kërkesë nuk i përkasin së drejtës së rregulluar nga VKM-ja nr. 89/2016, por kanë të bëjnë me metodologjinë e përcaktuar me VKM-në nr. 658/2012, me të cilën kërkuesja është pajtuar.

13.18 Ky akt është bërë objekt i shqyrtimit nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vendosur rrëzimin e padisë, duke arritur në përfundimin se nuk janë cenuar hapësira dhe kompetenca kushtetuese ose ligjore. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën e Lartë, çka nënkupton se subjektet kanë akoma mjete efektive dhe para se t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese kërkuesja duhet të vërtetonte se janë përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

13.19 Ligji nr. 133/2015 dhe VKM-ja nr. 89/2016 trajtojnë në mënyrë të barabartë të gjitha subjektet e shpronësuara, duke marrë si referencë vlerën e hartës në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit dhe zërin kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit.

C. Për VKM-në nr. 658/2012

13.20 Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione temporis*. VKM-ja nr. 658/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 1.11.2012 dhe në bazë të nenit 117 të Kushtetutës ka hyrë në fuqi në po këtë datë. Edhe ndryshimet e fundit që i janë bërë këtij akti me VKM-në nr. 1034, datë 16.12.2015 kanë hyrë në fuqi në datën 28.12.2015. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesja është e muajit shkurt 2018, për rrjedhojë ajo është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

13.21 Argumenti i paraqitur nga kërkuesja për karakterin vazhdues të shkeljes nuk vlen për këtë rast, pasi nuk ndodhemi para kërkesave ankimore individuale, por para gjykimit abstrakt, të



parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës.

14. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar para Gjykatës sa vijon:

A. Për ligjin nr. 133/2015

14.1 Nga momenti i paraqitjes së kërkesave dhe deri në momentin e shqyrtimit të tyre rezultoi se i gjithë kuadri normativ është shqyrtuar nga GJEDNJ-ja në çështjen *Beshiri kundër Shqipërisë*, i vitit 2020, e cila ka konfirmuar përputhjen e tij me KEDNJ-në. Zbatimi i këtij vendimi është detyrues në dy drejtime: a) konkluzionet e arritura nga GJEDNJ-ja janë detyruese për Gjykatën Kushtetuese edhe në shqyrtimin e kësaj çështjeje; b) duke qenë se nga GJEDNJ-ja janë kthyer 78 çështje që duhet të shqyrtohen në përputhje me ligjin nr. 133/2015 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Gjykata nuk mund t'i shfuqizojë ato, pasi do të sillte cenimin e detyrimeve ndërkombëtare të shtetit shqiptar.

14.2 Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së pronës private, subjektet nuk mund të pretendojnë një kompensim të plotë dhe me vlerën aktuale për një proces që nuk mbështetet mirëfilli në të drejtën e pronësisë, por në parimet e drejtësisë shoqërore, i cili kërkon të merren në konsideratë jo vetëm interesat e subjekteve të shpronësuar dhe trashëgimtarëve të tyre, por edhe ato të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si dhe interesi publik në tërësi. Rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vetë parimin e barazisë.

14.3 Formula e kompensimit, e përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të ligjit, ka për qëllim të kompensojë subjektet e shpronësuar me vlerën e tokës së përcaktuar në VKM-në nr. 89/2016, duke krijuar një formulë të thjeshtë dhe të parashikueshme, që i trajton subjektet në të njëjtën mënyrë. Në këto dispozita përcaktohet edhe kriteri i përpjesëtimit të drejtë midis ndërhyrjes së ligjvënësit dhe gjendjes që e dikton atë. Kjo mënyrë është zgjedhur nga ligjvënësi si më e përshtatshme për realizimin e kompensimit në kohë të arsyeshme për të gjitha subjektet.

14.4 Parimi i sigurisë juridike për normat ligjore është analizuar edhe nga Komisioni i Venecias, Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ-ja, të cilat kanë arritur në përfundimin se nuk ka shkelje. Qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 1/2017 është pranuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen

Beshiri kundër Shqipërisë, i vitit 2020, e cila ka vlerësuar se kompensimi i kësaj kategorie subjektsh nuk mundet të jetë i plotë. GJEDNJ-ja e ka konsideruar të drejtë dhe të sigurt zgjidhjen e dhënë nga ligjvënësi shqiptar.

B. Për VKM-në nr. 223/2016

14.5 Gjykata nuk ka juridiksion për shqyrtimin e kësaj çështjeje, pasi ajo kontrollon kushtetutshmërinë e akteve dhe jo ligjshmërinë e tyre. VKM-të nr. 223/2016 dhe nr. 766/2017 janë marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se ato janë në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 133/2015, duke respektuar rezervën ligjore. Sipas saj, standardi i përlogaritjes së dëmshpërblimit të drejtë nën frymën e nenit 41, pika 4, të Kushtetutës rezultoi të jetë realizuar nga ligjvënësi dhe ekzekutivi nëpërmjet dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore.

14.6 VKM-ja nr. 223/2016, e ndryshuar me VKM-në nr. 766/2017, është ndryshuar me VKM-në nr. 1114, datë 24.12.2020 (*VKM nr. 1114/2020*), e cila ka sjellë ndryshime substanciale në përmbajtje, veçanërisht në lidhje me format e ekzekutimit dhe të kompensimit financiar të pronave. Duke qenë se norma e re ka përmbajtje thellësisht të ndryshme nga norma e vjetër dhe pretendimet e kërkuases kanë të bëjnë me një normë që nuk është më në fuqi, gjykimi duhet pushuar, pasi çështja nuk ka më objekt.

14.7 VKM-ja nr. 223/2016 është miratuar në zbatim të ligjit nr. 133/2015 dhe me ndryshimet që i janë bërë atij me VKM-në nr. 766/2017 është qartësuar procedura e vlerësimit dhe kompensimit të pronës, si dhe është unifikuar procedura e vendimmarrjes për kërkesat që janë shqyrtim (Kreu IV). Me VKM-në nr. 766/2017, ATP-së iu njoh e drejta të bëjë bashkimin e të gjitha vendimeve përfundimtare me qëllim ekzekutimi, duke i grupuar ato mbi disa kriterë, parashikim që është shfuqizuar me VKM-në nr. 1114/2020, duke sjellë edhe rënien e një prej pikave të kërkesës.

14.8 VKM-ja nr. 1114/2020 është miratuar në përputhje me rekomandimin e dhënë nga GJEDNJ-ja në çështjen *Beshiri kundër Shqipërisë*, i vitit 2020, duke bërë të mundur që subjektet, për të cilat vlerësimi financiar i vendimit që ka njohur të drejtën e kompensimit rezultoi i vogël, të përfitojnë 10% të vlerës së pronës të llogaritur sipas zërit kadastral aktual. Sipas kësaj VKM-je, vlera financiare e vendimeve përfundimtare do të



indeksohet me normën zyrtare të inflacionit të llogaritur nga INSTAT-i, nga momenti kur subjekti plotëson dokumentacionin deri në momentin e ekzekutimit.

C. Për VKM-në nr. 89/2016

14.9 Ligjshmëria e këtij akti është marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e cila ka vlerësuar se ai është nxjerrë dhe gjen zbatim në përputhje me objektin dhe qëllimin e ligjit nr. 133/2015. Në të janë mbajtur parasysh të gjitha rrethanat dhe faktorët ekonomikë e socialë në dhënien e shpërblimeve të drejta nga fondet publike, si dhe respektimi e garantimi i drejtësisë sociale për të gjithë individët dhe shtresat e shoqërisë.

Ç. Për VKM-në nr. 658/2012

14.10 Kërkuesja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi VKM-ja nr. 658/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare të datës 1.11.2012 dhe në bazë të nenit 117 të Kushtetutës ka hyrë në fuqi po në këtë datë. Edhe ndryshimet e fundit që i janë bërë këtij akti me VKM-në nr. 1034/2015, kanë hyrë në fuqi në datën 28.12.2015. Kërkesa e paraqitur nga kërkuesja është e muajit shkurt të vitit 2018, për rrjedhojë ajo është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga neni 50, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000.

14.11 Argumenti i paraqitur nga kërkuesja për karakterin vazhdues të shkeljes nuk vlen për këtë rast, pasi nuk ndodhemi para përballë kërkesave ankimore individuale, por para gjykimit abstrakt, parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës. Kjo mënyrë interpretimi është zbatuar nga GJEDNJ-ja, e cila pranon në këto raste vetëm kërkesa individuale, si dhe nga Gjykata Kushtetuese në rastet kur është pretenduar cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

15. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje në seancë plenare.

A. Për juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese

16. Gjykata, referuar nenit 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c” të Kushtetutës, vendos për pajtueshmërinë e ligjit dhe të akteve normative të

organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.

17. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, me ndryshimet që i janë bërë ligjit organik të Gjykatës me ligjin nr. 99/2016, është shfuqizuar edhe parashikimi në nenin 74 që i lejonte palës të riparaqiste kërkesë në rast të refuzimit të saj. Kërkesa në shqyrtim është paraqitur nga kërkuesja pas hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe, si dispozita procedurale, ato gjejnë zbatim për çështjet në gjykim.

18. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, shqyrtimi përsëri i ligjit nr. 133/2015 do të përbënte “gjë të gjykuar”, çka bie ndesh me parimin e sigurisë juridike. Sipas tij, kërkuesja ka paraqitur të njëjtat shkaqe e rrethana fakti me ato të ngritura në kërkesën e mëparshme, për të cilën Gjykata është shprehur me vendimin nr. 1/2017, ku ka analizuar hollësisht dhe qartësisht nenin 6 të ligjit nr. 133/2015 dhe parimet kushtetuese që ai sanksionon.

19. Subjektet e interesuara, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë, kanë pretenduar se Gjykata nuk ka juridiksion as për shqyrtimin e VKM-së nr. 223/2016, të ndryshuar me VKM-në nr. 766/2017, dhe të VKM-së nr. 89/2016. Sipas tyre, këto akte janë shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila i ka vlerësuar se janë në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 133/2015 dhe se kanë respektuar rezervën ligjore. Po ashtu, vendimet e gjykatës administrative janë kundërshtuar në Gjykatën e Lartë, çka nënkupton se subjektet kanë akoma mjete efektive dhe të mjaftueshme për të shteruar në lidhje me rivendosjen e të drejtave të shkelura.

20. Gjykata ka theksuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj garantohet nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimin nr. 17, datë 10.4.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të*



Gjykatës Kushtetuese). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se nga standardi i detyrueshmërisë së zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vetë Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 78, datë 12.12.2017; nr. 44, datë 29.6.2015; nr. 18, datë 14.4.2015; nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në të drejtën kushtetuese parimi *res judicata* njihet si një nga tri format e efekteve që merr vendimi gjyqësor në procedurën abstrakte të kontrollit të kushtetutshmërisë së normave juridike. Në aspektin formal e procedural “gjë e gjykuar” nënkupton përfundimin në drejtim të mosankueshmërisë së vendimit, ndërsa në atë substancial nënkupton fuqinë detyruese të vendimit. Tipar karakteristik i gjësë së gjykuar është se kur në vendimin e parë çështja e ngritur është konsideruar e pabazuar në themel, ajo nuk mund të shqyrtohet më tej. Në rastet kur Gjykata nuk është shprehur në lidhje me pajtueshmërinë me Kushtetutën të normës juridike, kërkuar nuk ndalohej të paraqesë përsëri të njëjtën kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë së kësaj norme me Kushtetutën. Kjo varet nga pjesa arsyetuese e vendimit, sepse rrëzimi i kërkesës mund të jetë vendosur për shkaqe të tjera (*shih vendimin nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuarja së bashku me disa subjekte të tjera kushtetuese i janë drejtuar edhe më parë Gjykatës për kundërshtimin e ligjit nr. 133/2015 në tërësinë e tij. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata, me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, ka vendosur: “*Pranimin pjesërisht të kërkesës. Shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6, pika 1, shkronja “b”, si dhe të nenit 7, pika 2, shkronja “a” dhe “b” të ligjit të mësipërm. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër*”. Në këtë vendim, Gjykata nuk është shprehur as në pjesën arsyetuese, as në dispozitiv, në lidhje me kërkimin për pajtueshmërinë me Kushtetutën të dispozitave të nenit 6, pika 1, shkronja “b”, dhe të nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2015, pasi për këtë kërkim nuk u arrit shumica e votave të kërkuara nga ligji për marrjen e vendimit.

23. Ligji në fuqi në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje (neni 74 i ligjit nr. 8577/2000) parashikonte: “*Kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes*

nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuar të riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar”. Kjo dispozitë është shfuqizuar me ligjin nr. 99/2016, i cili ka shtuar pikën 4 në nenin 73 të ligjit nr. 8577/2000, me këtë përmbajtje: “*Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar*”. Ligji nr. 99/2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 210, datë 8.11.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij.

24. Gjykata vlerëson se pretendimet e subjekteve të interesuara në lidhje me zbatimin e dispozitave të reja procedurale, si dhe veprimin e parimit të gjësë së gjykuar janë të pabazuara. Në kuptim të përmbajtjes së dispozitave të ligjit organik në fuqi në kohën e vendimmarrjes në lidhje me këtë çështje, dispozitat e nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2015 nuk janë shqyrtuar në themel dhe nuk ka një vendim përfundimtar në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me normat dhe parimet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së. Për rrjedhojë, në rastin konkret nuk zbatohet parimi i gjësë së gjykuar dhe Gjykata nuk ka pengesë për t’i marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura sërish para saj.

25. Gjykata e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjekteve të interesuara në lidhje me mungesën e juridiksionit të saj për shqyrtimin e akteve nënligjore, pasi ato janë marrë në shqyrtim dhe janë vlerësuar nga Gjykata Administrative e Apelit në përputhje me ligjin nr. 133/2015. Funkcioni i Gjykatës Kushtetuese është garantimi i respektimit të Kushtetutës, interpretimi përfundimtar dhe sigurimi i epërsisë së saj në sistemin ligjor nëpërmjet dhënies së drejtësisë kushtetuese, që parashikohen në nenet 124, 131 dhe 132 të Kushtetutës. Në kuptim të dispozitave kushtetuese, Gjykata Kushtetuese është organi që ka fjalën e fundit në lidhje me interpretimin detyrues të Kushtetutës dhe pajtueshmërinë me këtë tekst të ligjeve dhe akteve të tjera normative. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës, ajo vendos edhe për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Kjo dispozitë, duke përcaktuar kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, ka përcaktuar kufijtë ndarës midis juridiksionit



kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, në rastin konkret atij administrativ, për shkak të dallimeve thelbësore mes tyre. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se juridiksioni kushtetues nuk zëvendësohet nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor dhe se natyra e pretendimeve të ngritura para kësaj Gjykate është një nga elementet përcaktuese të juridiksionit kushtetues për shqyrtimin e një çështjeje konkrete.

26. Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar i ka njohur kompetencën gjykatës administrative të shqyrtojë edhe mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative normative (neni 7, shkronja “a”), por ai ka parashikuar edhe se gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet, të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese (neni 8, shkronja “a”). Kur kundërshtohet një akt nënligjor normativ, edhe pse mund të verifikohet ekzistenca e njëkohshme e dy mjeteve të ndryshme të ankimit, që i përkasin juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor të zakonshëm, për kontrollin e ligjshmërisë së aktit normativ vihet në lëvizje Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa për kontrollin e pajtueshmërisë së tij me Kushtetutën, vihet në lëvizje Gjykata Kushtetuese, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

27. Gjykata Kushtetuese, në përputhje me kompetencat e përcaktuara nga Kushtetuta, e përcakton vetë juridiksionin e saj gjatë shqyrtimit të çështjeve, rast pas rasti. Për rrjedhojë, përfundimet e arritura nga Gjykata Administrative e Apelit në lidhje me pajtueshmërinë e akteve nënligjore të kundërshtuara me ligjin nr. 133/2015, si dhe fakti që ato janë në shqyrtim në Gjykatën e Lartë, nuk e ve në dyshim, nuk e pengon dhe as e zëvendëson juridiksionin kushtetues të kësaj Gjykate për kontrollin e pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

B. Për legjitimitimin e kërkeses

28. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet që parashikohen në nenin 134, pika 2, të Kushtetutës kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet

veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur.

29. Për sa i përket legjitimitimit të shoqatave, si subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimitimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre. Ajo është shprehur se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo mjaftueshëm interes, bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të veprimtarisë së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis veprimtarisë së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premiset teorike për antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit. Vetëm fakti se dispozitat e kundërshtuara mund të kenë ose kanë pasur një efekt çfarëdo për kërkuuesin, nuk është i mjaftueshëm për të përcaktuar nëse ai legjitimohet në paraqitjen e kërkesës, por është e nevojshme të provohet se dispozita e kundërshtuar rregullon marrëdhënie që janë qëllimi i veprimtarisë së kërkuarit, sipas përcaktimeve të bëra në Kushtetutë, në ligje ose, në rastin e subjekteve të së drejtës private, në statut (*shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 33, datë 8.6.2016; nr. 14, datë 21.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata vëren se shoqata “Pronësi me drejtësi” është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 2941, datë 26.10.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas këtij vendimi dhe përmbajtjes së statutit të saj, ajo është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, që ka si qëllim mbrojtjen me çdo mjet ligjor të të drejtave të personave të shpronësuar nga regjimi komunist në Shqipëri, të cilët nuk i kanë rifituar ende të drejtat e pronësisë, që u janë mohuar padrejtësisht. Duke qenë se objekti i akteve që kundërshtohen para Gjykatës është, në thelb, rregullimi dhe shpërblimi i drejtë në lidhje me çështjet e së drejtës së pronësisë, rregullime që zbatohen dhe prekin drejtpërdrejt subjektet e shpronësuar, që janë anëtarë të kësaj shoqate, vlerësohet se përligjet interesi i saj për të vënë në lëvizje kontrollin kushtetues të normës.



31. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera me Kushtetutën duhet të paraqitet brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit. Rezulton se ligji nr. 133/2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 255, datë 8.2.2016 dhe ka hyrë në fuqi në datën 23.2.2016 (15 ditë pas botimit), kurse kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 11.12.2017, pra brenda afatit ligjor 2-vjeçar.

32. Edhe kërkesa për kundërshtimin e VKM-së nr. 89/2016 është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar, sepse ky akt ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 14, datë 5.2.2016, ndërsa kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur në datën 26.12.2017.

33. VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016 janë botuar në Fletoren Zyrtare nr. 50, datë 4.4.2016 dhe kanë hyrë në fuqi pas botimit të tyre. Disa nga dispozitat e këtyre VKM-ve janë kundërshtuar fillimisht me kërkesën e datës 11.12.2017, e cila përfshinte në objekt edhe kundërshtimin e ligjit nr. 133/2015 (kërkesa nr. S-57, datë 11.12.2017). Në datën 20.12.2017 Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimet nr. 765/2017 dhe nr. 766/2017, të cilat kanë ndryshuar respektivisht VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016 dhe janë botuar në Fletoret Zyrtare nr. 226, datë 22.12.2017 dhe nr. 230, datë 27.12.2017 e kanë hyrë në fuqi pas botimit të tyre. Këto akte janë kundërshtuar me kërkesat e dërguara nëpërmjet shërbimit postar në datën 3.4.2018, e cila konsiderohet edhe data e paraqitjes së tyre për efekt të përlogaritjes së afatit 2-vjeçar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe këto kërkesa janë paraqitur brenda afatit të caktuar nga ligji.

34. Në lidhje me VKM-në nr. 658/2012, e cila ka miratuar metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, në seancën plenare të datës 4.2.2021, kërkesja përsëriti kërkesën e paraqitur në komentet shtesë të datës 15.3.2018 për zgjerimin e objektit të kërkesës nr. S-59, datë 26.12.2017, duke i nënshtruar kontrollit të kushtetutshmërisë edhe VKM-në nr. 658/2012, për shkak të lidhjes organike mes këtij akti dhe VKM-së nr. 89/2016. Sipas kërkuësës, mospërfutja e hartave të vlerës, të miratuara sipas VKM-së nr. 658/2012, ka krijuar një “situatë të vazhdueshme” të shkeljes të së drejtës për kompensim të drejtë, të përshtatshëm e të

mjaftueshëm. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuësja nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar.

35. Gjykata vëren se VKM-ja nr. 658/2012 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 1.11.2012 dhe ka hyrë në fuqi pas botimit të saj. Pavarësisht argumenteve që kërkuësja ka paraqitur për të mbështetur kërkimin e saj, Gjykata vëren se është vënë në lëvizje për kontrollin abstrakt të këtij akti, sipas kompetencës së parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “c”, i Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 50, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, afati 2-vjeçar për paraqitjen e kësaj kërkesë fillon të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të aktit dhe jo nga momenti i konstatimit të pasojës që sjell zbatimi i këtij akti, siç parashikohet në rastin e ankimit kushtetues individual, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000. Për sa më sipër, Gjykata çmon se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor, për këtë arsye kërkuësja nuk legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e aktit në fjalë.

36. Në lidhje me legjitimimin *ratione materia*, Gjykata vëren se për sa u përket pretendimeve të ngritura nga kërkuësja për VKM-në nr. 89/2016, që lidhen me cenimin e së drejtës së pronës private, në thelb, ato i referohen VKM-së nr. 658/2012 për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në bazë të së cilës është miratuar VKM-ja nr. 89/2016. Përtej këtyre pretendimeve në lidhje me VKM-në nr. 658/2012, kërkuësja nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në lidhje me aktin objekt kërkesë, por ka pretenduar vetëm se VKM-ja nr. 89/2016 konfirmon vlefshmërinë e metodologjisë së miratuar më parë ndaj lind nevoja e ballafaqimit të saj me të drejtat minimale që sigurohen nga KEDNJ-ja. Edhe pse Gjykata e bëri pjesë të këtij gjykimi edhe VKM-në nr. 658/2012, duke pranuar kërkesën paraprake të paraqitur në seancë plenare, ajo vlerësoi se ky kërkim është paraqitur jashtë afatit ligjor 2-vjeçar që zbatohet për kundërshtimin e akteve normative. Në këtë kuptim, për çështjet që trajton kjo e fundit, të cilat nuk janë përfshirë në përmbajtjen e VKM-së nr. 89/2016, Gjykata ka pengesë ligjore t'i shqyrtojë dhe të shprehet për to. Po ashtu, pretendimet e kërkuësës i referohen pajtueshmërisë së metodologjisë me kuadrin ligjor të kohës, si dhe me standardet ndërkombëtare të vlerësimit, të cilat janë



pretendime me natyrë ligjore. Për më tepër, Gjykata vëren se në lidhje me përdorimin e hartave të vlerës së pronës të vitit 2016 është shprehur edhe GJEDNJ-ja, në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendimi i datës 17.3.2020, e cila, lidhur me to, ka vënë re rritje të vlerës së çmimit të referencës për të njëjtin zë kadastral (*paragrafi 198 i vendimit*).

37. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se, në thelb, pretendimet e paraqitura nga kërkuesja në lidhje me VKM-në nr. 89/2016 janë të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese dhe shqyrtimi i tyre nuk mund të bëhet pjesë e këtij gjykimi kushtetues, për rrjedhojë kërkuesja nuk legjitimohet *ratione materia* në lidhje me këto pretendime.

38. Pretendimet e tjera të parashtruara nga kërkuesja për dispozitat e ligjit nr. 133/2015 dhe ato të VKM-ve nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016, të ndryshuara me VKM-të nr. 765/2017 dhe nr. 766/2017, lidhen me cenimin e të drejtave dhe parimeve kushtetuese, më konkretisht, së drejtës së pronës private, parimit të sigurisë juridike dhe atij të hierarkisë së akteve ligjore, si dhe së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe, duke qenë pretendime me natyrë kushtetuese, kërkuesja legjitimohet *ratione materia* t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese në lidhje me to ndaj do të shqyrtohen në vijim prej saj.

C. Për themelin e pretendimeve

C.1. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës private

39. Kërkuesja ka pretenduar se zbatimi i dispozitave të kundërshtuara të ligjit nr. 133/2015 cenon parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në të drejtën e pronës private, pasi në parashikimet e nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” kemi të bëjmë me konceptin e një “shpronësimi të ri”, të njëjtë me atë që ka konstatuar Gjykata në vendimin e saj nr. 1/2017, me të cilin ka shfuqizuar pikat 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit.

40. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, ligji nr. 133/2015 në tërësi dhe nenet 6 dhe 7, në veçanti, mbështeten në parimet e shpërblimit të drejtë, detyrimet pozitive të shtetit, standardet e Konventës, por edhe në praktikën e GJEDNJ-së. Ky ligj vendos balancat mes interesit publik dhe interesit të subjekteve të shpronësuara, të cilët do të mund të realizojnë shpërblimin e drejtë në lidhje me padrejtësinë që iu është bërë në trajtimin e pronës së tyre.

41. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, ligji respekton standardet kushtetuese dhe ruan balancën midis interesit publik dhe kompensimit të drejtë, si pjesë e parimeve të drejtësisë, proporcionalitetit dhe shtetit të së drejtës. Formula e kompensimit e përcaktuar në nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 133/2015 ka për qëllim të kompensojë subjektet e shpronësuara me vlerën e tokës të përcaktuar në VKM-në nr. 89/2016 dhe sipas karakteristikave të pronës së shpronësuar, duke krijuar në këtë mënyrë një formulë të thjeshtë dhe të parashikueshme, e cila i trajton të gjitha subjektet e ligjit në të njëjtën mënyrë, duke filluar nga një pikënisje e njëjtë, pra me vlerën e pronës në kohën e shpronësimit.

42. Sipas subjektit të interesuar, Ministrisë së Drejtësisë, subjektet e shpronësuara nuk mund të pretendojnë kompensim të plotë dhe me vlerën aktuale në kuadër të një procesi që nuk mbështetet kryesisht në të drejtën e pronës, por në parimet e drejtësisë shoqërore. Kjo mënyrë është zgjedhur nga ligjvënësi si më e përshtatshme për realizimin e kompensimit brenda një kohe të arsyeshme, të njëjtë për të gjitha subjektet.

43. Gjykata vëren se procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës private të shtetëzuar, të shpronësuar ose të konfiskuar nga shteti pas datës 29 nëntor 1944, ose të marrë padrejtësisht me çdo mënyrë tjetër, ka qenë një ndër çështjet më të ndjeshme për shoqërinë shqiptare, me pasoja të konsiderueshme në planin social, moral e ekonomik. Ligjvënësi shqiptar, me miratimin e ligjeve që synonin rregullimin e kësaj çështjeje, ka bërë përpjekje për të ndrequr, në përputhje me frymën e së drejtës në përgjithësi e të normave ndërkombëtare, për aq sa ishte e mundur, padrejtësitë e bëra individëve, të cilëve iu mor dhe iu mohua në mënyrë të padrejtë prona, duke pasur si qëllim mbrojtjen e interesave të subjekteve të shpronësuara dhe minimizimin e pasojave të ardhura ndaj tyre nga shteti totalitar.

44. Me miratimin e Kushtetutës të vitit 1998, në nenin 181 u përcaktua detyrimi i Kuvendit të Shqipërisë për të nxjerrë brenda 2-3 vjetëve ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41 të Kushtetutës. Kjo dispozitë ka pasur për qëllim t'i hapë rrugën ligjvënësit për të ndrequr brenda afateve të



arsyeshme dhe brenda të gjitha mundësive që ka shteti një padrejtësi që u është bërë subjekteve të shpronësuar. Kjo normë kushtetuese është orientim për ligjvënësin që çështjet e shpronësimeve dhe të konfiskimeve t'i rregullojë pa tejkaluar kufizimet e lejueshme dhe duke respektuar standardet kushtetuese (*shih vendimet nr. 30, datë 1.12.2005; nr. 26, datë 24.4.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kriteret që parashikon neni 41 i Kushtetutës, që janë garantimi i pronës private dhe shpërblimi i drejtë, si dhe koncepti i përcaktuar nga KEDNJ-ja për gëzimin e pronës në mënyrë të qetë, janë orientimet bazë mbi të cilat duhet të zgjidhen të gjitha çështjet që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera përpara miratimit të Kushtetutës, konform edhe nenit 181 të saj. Për sa i përket konceptit të shpërblimit të drejtë, Gjykata e ka trajtuar atë duke iu referuar çmimit të tregut për ndërtesat, gjatë kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 10 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” (*shih vendimin nr. 12, datë 21.3.2000 të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe gjatë kontrollit të pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, Gjykata është shprehur se mënyra e vlerësimit të pronës në referim të nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 9235 datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, që shprehimisht parashikonte se “*vlera e pronës që kompensohet përcaktohet në bazë të vlerës së tregut*” është në pajtim me kriterin kushtetues “shpërblim i drejtë” (*shih vendimin nr. 35, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Po ashtu, Gjykata e ka interpretuar shpërblimin e drejtë lidhur me konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik, si dhe respektimin e parimeve të drejtësisë, të proporcionalitetit dhe të shtetit social. Ajo ka vlerësuar se e drejta e pronës, në kuptimin që i jep neni 41 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk mund të barazohet me kuptimin që ka në vetvete e drejta dhe se e drejta e pronës nuk njësohet me të drejtën e kthimit të saj. Nga kriteret kushtetuese të “rregullimit të drejtë” dhe të “shpërblimit të drejtë”, të pranuar në nenet 41 dhe 181 të Kushtetutës, rezulton se kriteri për

shpërblimin ose kompensimin në dobi të ish-pronarit nuk mund të jetë i plotë, por i drejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Me vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, Gjykata mori në shqyrtim pajtueshmërinë me Kushtetutën të parashikimeve të ligjit nr. 133/2015. Në këtë vendim Gjykata u ndal në analizën nëse ndërhyrja e ligjvënësit në rregullimin e çështjes së kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve ka respektuar parimin e sigurisë juridike sipas standardeve të vendosura nga kjo Gjykatë dhe nga GJEDNJ-ja. Gjykata u shpreh se ligjvënësi ka hapësirën e tij të vlerësimit për të rregulluar çështjen e kompensimit të pronave të shtetëzuara ose konfiskuara gjatë regjimit komunist dhe se ai ka të drejtë ta kufizojë hapësirën e gëzimit dhe të disponimit të pronës private nga shtetasit për arsye të interesit publik. Edhe pse konstatoi ndërhyrje në të drejtën e pronës private, Gjykata identifikoi si interes publik zgjidhjen e çështjes së pronave me një kosto financiare dhe kohëzgjatje sa më të arsyeshme, si dhe vendosjen e paqes sociale midis kategorive të ndryshme shoqërore që prek kjo çështje, e cila ka kishte mbetur e pazgjidhur. Ky interes u vlerësua aq i rëndësishëm sa të justifikojë ndërhyrjen e ligjvënësit. Duke u mbështetur edhe në vendimet e GJEDNJ-së dhe opinionet e Komisionit të Venecias, Gjykata vlerësoi se nuk mund të vendosen detyrime për kompensimin tërësor të pronës së shpronësuar apo të shtetëzuar nga regjimet që nuk kanë respektuar standardet minimale të të drejtave të njeriut dhe se rivendosja e plotë e të drejtave të mëparshme të pronësisë do të ishte në kundërshtim me vetë parimin e barazisë.

48. Gjykata ka vlerësuar se kushti që duhet të respektohet në vendosjen e kufizimeve, ai i përpjesëtimin të drejtë midis ndërhyrjes dhe gjendjes që e dikton atë, e detyron ligjvënësin të vërë në dukje nevojën reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Baraspeshimi i ndërhyrjes me gjendjen që e ka diktuar atë imponon ligjvënësin të zbatojë mjete të tilla ligjore, të cilat duhet të jenë efektive, d.m.th. të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria ka të bëjë, gjithashtu, edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për



subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe proporcionalitetit, në kuptimin strikt të kufizimeve të imponuara. Respektimi i këtyre kërkesave kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton kufizimin me ato të drejta që i nënshtrohen kufizimit, si dhe duke vlerësuar edhe mënyrën e kufizimit. Në këtë drejtim, respektimi i përmbushjes së kërkesave të mësipërme të kufizimit kërkon një trajtim të diferencuar, në varësi të të drejtave dhe lirive individuale që i nënshtrohen kufizimit (*shih vendimet nr. 1, datë 16.1.2017; nr. 25, datë 28.4.2014; nr. 4, datë 23.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Në kuptim të këtyre standardeve, Gjykata ka vlerësuar se metodologjia dhe formula e parashikuar nga ligji nr. 133/2015 ndërhyjnë në të drejtën e pronës private të sanksionuar në nenin 41 të Kushtetutës, por kjo ndërhyrje respekton elementet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Skema e re e kompensimit, e miratuar në ligjin nr. 133/2015, ka ndryshuar metodën e vlerësimit dhe elementi kryesor i vlerësimit të kompensimit financiar është vlera e pronës sipas zërit kadastral që ajo ka pasur në kohën e shpronësimit. Kjo metodë është e ndryshme nga legjislacioni i mëparshëm dhe mund të rezultojë në masë kompensimi më të ulët. Ligjet e mëparshme (ligjet për pronat të viteve 1993, 2004 dhe 2006) parashikonin një skemë me vlerë më të lartë kompensimi se sa ajo e parashikuar nga ligji nr. 133/2015, ndaj mund të thuhet se kanë krijuar pritshmëri për marrjen e kompensimeve sipas vlerës së tregut të pronës në momentin e nxjerrjes së vendimit për kompensimin. Ndonëse masa më e ulët e kompensimit nuk mund të cilësohet si shpronësim formal, ajo mund të cilësohet fare mirë si një “ndërhyrje tjetër”, e cila, pavarësisht se mund të rezultojë në një masë më të ulët kompensimi për ish-pronarët, në tërësinë e saj respekton proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtën e kompensimit të pronës ish-pronarëve dhe, si e tillë, është në respektim të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

50. Në lidhje me pikat 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015, Gjykata ka vendosur shfuqizimin e tyre si të papajtueshme me

Kushtetutën, pasi ka vlerësuar se këto dy dispozita, sipas përmbajtjes së tyre, janë konceptuar si një shpronësim i ri duke qenë se parashikojnë rivlerësimin e pronave të kthyer ose të kompensuara më parë. Në këtë këndvështrim, ato krijojnë probleme lidhur me sigurinë juridike, konkretisht për sa i takon paqartësisë dhe paparashikueshmërisë së legjislacionit. Sipas saj, neni 6 i ligjit nr. 133/2015 duhet parë i lidhur edhe me nenet e tjera të tij, konkretisht me nenet 13, 14, 20, 21, 24, 26 dhe 31 dhe në këtë kontekst ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se deri në çfarë mase kompensimi fizik i parashikuar në nenin 6, pikat 3 dhe 5, plotësohet nga nenet e tjera të ligjit për të mos pasur mbivendosje ose përplasje midis këtyre dispozitave. Parashikimi i rregullimeve të përsëritura dhe të pakoordinuara midis tyre në thelbin dhe pasojat që ato sjellin, krijojnë paqartësi dhe, për rrjedhojë, cenon parimin e sigurisë juridike. Sipas Gjykatës, përmbajtja e pikave 3 dhe 5 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 nuk është në pajtim me parimin e sigurisë juridike, pasi përlllogaritja e sipërfaqes së përfituar dhe asaj që do të zbritet ose shtohet sipas formulës së parashikuar në pikën 1 të nenit 6 është e paqartë dhe krijojnë konfuzion në zbatim për sa u takon pritshmërive të shtetasve (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Në atë gjykim nuk u arrit shumica e votave të kërkuara për vendimmarrje edhe në lidhje me pikën 1, shkronja “b”, të nenit 6 dhe pikën 2, shkronjat “a” dhe “b” të nenit 7, të cilat janë dispozitat për të cilat kërkesja e ka vënë sërish në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

52. Gjykata vëren se pas vendimit të saj nr. 1/2017 nuk pati ndonjë nismë legislative për të miratuar dispozita të reja në ligjin nr. 133/2015 dhe kjo, sipas subjekteve të interesuara, nuk u pa e nevojshme, pasi shfuqizimi i pikave 3 dhe 5 të nenit 6 nuk sillte boshllëk ligjor apo paqartësi në zbatimin e ligjit. Sipas tyre, u vlerësua e nevojshme ndërhyrja me akte nënligjore për të qartësuar më tej procedurën e vlerësimit dhe kompensimit të pronës, si dhe për të unifikuar procedurën e vendimmarrjes për kërkesat në shqyrtim me ato të trajtuara nga ATP-ja. Për këtë qëllim u miratuan nga Këshilli i Ministrave vendimet nr. 765/2017 dhe nr. 766/2017, që sollën ndryshime përkatësisht në VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016.



53. Gjykata vëren, po ashtu, se dispozitat e ligjit nr. 133/2015 janë analizuar edhe nga GJEDNJ-ja në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendimi i datës 17.3.2020. Sipas asaj gjykate, referenca e zërit kadastral fillestar të pronave të shpronësuara si bazë për kryerjen e vlerësimit financiar nuk është *per se* arbitrar. Me qëllim që të parandalohet një barrë e tepërt për subjektet e shpronësuara, mjeti juridik mund të konsiderohet efektiv nëse shuma totale e kompensimit, pavarësisht formës së kompensimit, arrin të paktën 10% të vlerës që do të ishte përfituar nëse vlerësimi financiar do të ishte kryer duke përdorur si referencë zërin kadastral aktual të pronës së shpronësuar. Sipas GJEDNJ-së, pragu minimal 10% për vlerën e kompensimit mund të konsiderohet i arsyeshëm në kontekstin specifik të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave në Shqipëri, për shkak të nivelit të përgjithshëm sakrifikues që skema e re e kompensimit imponon tek subjektet e shpronësuara, krahasuar me pritshmërinë e tyre për të marrë kompensim me vlerën e tanishme të tregut që buronte nga legjislacioni i mëparshëm (*shih paragrafin 196 të vendimit*).

54. Pas këtij vendimi të GJEDNJ-së, Këshilli i Ministrave vlerësoi sërish të ndërhyjë në aktet nënligjore, duke miratuar VKM-në nr. 1114, datë 24.12.2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 223, datë 23.3.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar”. Sipas relacionit të këtij projektvendimi, këto ndryshime kanë për qëllim që subjektet të përfitojnë një vlerësim financiar më të lartë dhe në përputhje me gjetjet e GJEDNJ-së, të rrisin numrin e aplikuesve që do të kërkojnë ekzekutimin e vendimeve të njohjes dhe kompensimit, si dhe dhënien e shtysës procesit që të vijojë sipas afateve të përcaktuara në ligj. Në këtë akt është rregulluar mënyra e kompensimit për vendimet që janë vlerësuar financiarisht bazuar në zërin kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit, por që aktualisht rezultojnë me zërin kadastral të ndryshuar, si dhe mënyra e llogaritjes së vlerës së kompensimit.

55. Pika 16/4 e VKM-së nr. 223/2016, e ndryshuar me VKM-në nr. 1114/2020, parashikon: “*Vendimet, të cilat janë vlerësuar financiarisht bazuar në zërin kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit, por që rezultojnë me zërin aktual të pronës të ndryshuar, kompensohen me 10 (dhjetë) % të vlerës sipas zërit aktual kadastral të pronës së njohur për kompensim. Në rastet kur vlera prej 10 (dhjetë) % e pronës së llogaritur sipas zërit aktual rezulton më e vogël se vlera e llogaritur, sipas zërit kadastral në momentin e shpronësimit, subjekti përfiton vlerën më të madhe dhe mbetet në fuqi vlerësimi i parë sipas zërit kadastral në momentin e shpronësimit. Vlera që përfiton kjo kategori subjektësh llogaritet, si më poshtë vijon: a) prona e njohur për kompensim vlerësohet financiarisht, në bazë të zërit kadastral aktual; b) vlera e pronës së kthyer, të kompensuar fizikisht apo të përfituar në një nga mënyrat e tjera sipas legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronave, e kryer sipas shkronjës “b”, të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, zëbritet nga vlerësimi i kryer sipas shkronjës “a”, të kësaj pike; c) vlera e llogaritur nga diferenca e shkronjës “a” dhe e shkronjës “b”, të kësaj pike, ekzekutohet në masën 10 (dhjetë) %.*”.

56. Përpara se të ndalet në analizën e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson të theksojë se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisët nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrihen argumente bindëse për t’i dhënë asaj mundësi të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr. 37, datë 13.6.2012; nr. 31, datë 18.6.2010; nr. 29, datë 31.5.2010; nr. 16, datë 25.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

57. Duke iu rikthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Gjykata vëren se pika 1, shkronja “b”, e nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 parashikon: “*Prona e kthyer vlerësohet duke e përcaktuar atë nga diferenca, që do të rezultojë midis vlerës së saj, sipas zërit kadastral aktual, dhe vlerës së kësaj prone, sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit.*”. Kjo dispozitë është pjesë e metodologjisë që ka parashikuar në tërësi neni 6 i ligjit nr. 133/2015 dhe i referohet vetëm mënyrës se si vlerësohet financiarisht prona e kthyer. Gjykata rithekson se në përmbajtjen e pikave 1 dhe 2 të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 janë materializuar parimet kryesore të formulës së kompensimit. Pjesa tjetër e nenit 6 rregullon situata të tjera në kuadrin e metodologjisë së kompensimit që harmonizohet edhe me dispozitat e tjera të ligjit, ndërsa



parashikimet e nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” kanë të bëjnë me vlerësimet e vendimeve përfundimtare, në kuptim të pikës 17 të nenit 5, që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe ato që do të merren deri në përfundim të procesit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuësja, shfuqizimi i pikave 3 dhe 5 të nenit 6 nuk e bën të pazbatueshëm parashikimin e shkronjës “b” të pikës 1 të po këtij neni dhe se kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se si parashikimi i kësaj dispozite, në vetvete, bie ndesh me kërkesat e nenit 41 të Kushtetutës.

58. Në lidhje me parashikimet e nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, Gjykata vëren se ato trajtojnë rastin kur një subjekt ka përfituar me vendim përfundimtar edhe kthim, edhe kompensim. Në këtë rast, vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare për kompensim do të bëhet duke vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, sipas nenit 6 të këtij ligji, në përputhje me procedurën e mëposhtme: a) nëse vlerësimi i pronës së kthyer me vendim përfundimtar rezulton se është më i madh sesa vlerësimi i tokës së njohur për kompensim, atëherë subjekti i shpronësuar konsiderohet i kompensuar; b) nëse vlerësimi i pronës që është njohur për kompensim është më i madh sesa vlerësimi i tokës së kthyer, atëherë subjektit i kompensohet diferenca, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

59. Duke iu referuar dispozitave të kundërshtuara dhe metodologjisë së parashikuar nga ligji, si dhe shpjegimeve të subjekteve të interesuara në lidhje me mënyrën se si zbatohen këto norma në praktikë, rezulton se në rastet kur subjektit i është njohur vetëm e drejta e kompensimit (në një nga format që parashikon ligji nr. 133/2015), vlerësimi financiar i pronës në çdo rast (pra nëse është vendosur kompensimi fizik brenda sipërfaqes së njohur ose nga fondi i tokës, ose kompensim financiar) bëhet në bazë të zërit kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 6. Ndërsa në rastet kur subjektit i është njohur, me vendim përfundimtar, e drejta për kthim dhe kompensim, llogaritet diferenca mes vlerës së sipërfaqes së kthyer sipas shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 6 dhe vlerës së sipërfaqes së njohur për kompensim sipas shkronjës “a” të pikës 1 të po këtij neni.

60. Gjykata vëren se ecuria e procesit të kompensimit të pronave deri më tani, si dhe shpjegimet e dokumentet e paraqitura prej subjekteve të interesuara, japin një panoramë të qartë të situatës faktike në lidhje me mënyrën se si zbërthehen në praktikë dhe çfarë pasojash sjell përmbajtja e normave të ligjit nr. 133/2015. Referuar relacionit të projektvendimit të VKM-së nr. 1114/2020, Gjykata vëren se nga 26.091 vendime të njohjes së pronës të vlerësuara më parë, preken rreth 10.120 vendime që kanë ndryshim të zërit kadastral. Për shkak të këtij ndryshimi në zërin kadastral, siç pranohet edhe në relacion, vlerësimi financiar i këtyre pronave ka qenë shumë më i ulët se sa pragu minimal 10% i përmendur në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendimi i datës 17.3.2020.

61. Gjykata e gjen me vend të theksojë se për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive, e cila është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17, pika 2, të saj, që parashikojnë se vendimet e GJEDNJ-së zbatohen drejtpërsëdrejti. Neni 17 i Kushtetutës i jep katalogut të të drejtave, të parashikuara në KEDNJ, statusin e standardit minimal për sa u takon kufizimeve të të drejtave dhe lirive të shprehura në Kushtetutë. Detyrimet që mbart secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. Për sa i përket pushtetit legjislativ, për të lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

62. Gjykata rithekson se metodologjia sipas skemës së kompensimit të miratuar në ligjin nr. 133/2015, sjell një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuara, e cila konsiderohet si një “ndërrhyrje tjetër” në të drejtën e pronës private (*shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata çmon se kjo masë kompensimi duhet të respektojë një nivel të caktuar, me qëllim që të mos çojë në mohimin e së drejtës së pronës private dhe të jetë në përputhje me kriteret e ndërrhyrjes në kuptim të neneve 41 dhe 17 të Kushtetutës.

63. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vlerëson se sistemi aktual i vlerësimit të pronës, siç u provua



në këtë gjykim, nuk respekton në të gjitha rastet pragun minimal prej 10% të vlerësimit financiar dhe, për këtë arsye, është një ndërhyrje jo proporcionale në të drejtën e pronës private.

64. Gjykata vlerëson vullnetin e shprehur nga ekzekutivi për ta çuar përpara dhe për ta përmbyllur këtë proces në përputhje me rregullat e parashikuara nga ligji nr. 133/2015, por thekson se rregullime të tilla, në kuptim të neneve 41 dhe 17 të Kushtetutës, bëhen vetëm me ligj dhe jo me akte nënligjore. Parashikimi kushtetues i rregullimit me ligj ka një funksion garantues të interesit publik të përgjithshëm, për arsye se garanton që në fusha të caktuara, veçanërisht delikate, si në rastin e të drejtave themelore kushtetuese, vendimet të merren nga Kuvendi, si organi përfaqësues i pushtetit sovran. Nëpërmjet një mekanizmi demokratik, siç është rezerva ligjore, garantohej parimi i ligjshmërisë, duke qenë se ligji i miratuar nga Kuvendi konsiderohet si burimi më i përshtatshëm që respekton të drejtat individuale dhe kënaq të ashtuquajturën *ratio* garantuese të rezervës ligjore. Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 17 të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se kjo dispozitë, në mënyrën se si është formuluar, nuk i ka lënë mundësi delegimi ndonjë organi tjetër përveç Kuvendit si organ përfaqësues. Shprehja “vetëm me ligj” ka kuptimin që në rast se është i nevojshëm kufizimi i një të drejte të parashikuar në Kushtetutë, atëherë ky vlerësim është në diskrecion vetëm të ligjvënësit dhe jo të organeve të tjera, përfshirë edhe Këshillin e Ministrave. Çdo interpretim i kundërt, është padyshim një zhvleftësim i garancisë që jep Kushtetuta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe do t'i cenonte efektivisht ato (*shih vendimet nr. 28, datë 27.5.2010; nr. 20, datë 11.7.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të sa më sipër, në rastin konkret jemi para *rezervës ligjore absolute*, pasi norma kushtetuese në kuptimin formal, ia ka rezervuar ligjit rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me kufizimet e së drejtës së pronës private.

65. Po ashtu edhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së sanksionon parimin e ligjshmërisë, sipas të cilit, si një ndër kërkesat më të rëndësishme të këtij neni, çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin e qetë të pasurisë duhet të jetë e ligjshme. Fjala e dytë e paragrafit të parë të këtij neni autorizon ndërhyrjen vetëm në kushtet e parashikuara me ligj, ndërsa paragrafi i dytë njeh të

drejtën e shtetit që të kontrollojë pasurinë vetëm me ligj.

66. Në të njëjtën linjë arsyetimi si më sipër, edhe pse parashikimet e pikës 16/4 të VKM-së nr. 223/2016 sjellin përmirësim për subjektet në krahasim me ligjin, pasi jo vetëm nga formulimi i kësaj dispozite, por edhe nga shembujt konkretë të ilustruar në relacionin shoqërues të projektvendimit rezulton se qëllimi i tyre është përfitimi financiar më i lartë për subjektet e shpronësuara dhe dukshëm ky përfitim është më i madh se ai që përfitohet sipas parashikimeve të ligjit nr. 133/2015, këto lloj parashikimesh jo vetëm në kuptim të rezervës ligjore absolute, por edhe të parimit të sigurisë juridike, janë një çështje që i takon kompetencës ekskluzive të ligjvënësit.

67. Po ashtu, Gjykata vlerëson se kufizimi i së drejtës së pronës private ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së rregullimit nga pika 2 e nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 të situatës të ndryshimit që ka pësuar zëri kadastral i pronës ndër vite. Në vlerësimin e Gjykatës, kjo mungesë rregullimi përbën një boshllëk ligjor, nga i cili vijnë pasoja negative për të drejtat kushtetuese të individëve, në rastin konkret e drejta e pronës private. Kjo mungesë e rregullimit ligjor të situatës që ka rezultuar nga ndryshimi i zërit kadastral, i ka mohuar kompensimin e drejtë kësaj kategorie subjektesh.

68. Sipas nenit 76, pika 5, të ligjit nr. 8577/2000, kur Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të një çështjeje, konstaton se ka boshllëk ligjor, si pasojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, ndër të tjera, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar. Për rrjedhojë, Gjykata, me qëllim që t'i japë ligjvënësit kohën e mjaftueshme për të miratuar rregullat e reja ligjore në përputhje me vendimin e saj, vlerëson se Kuvendi duhet të plotësojë ligjin nr. 133/2015 brenda afatit 6-mujor, duke filluar ky afat nga shpallja e këtij vendimi deri në hyrjen në fuqi të tij.

69. Gjykata çmon të vlerësojë, gjithashtu, se KEDNJ-ja, si instrument i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, ofron vetëm një standard minimum të mbrojtjes së të drejtave dhe shtetet nuk pengohen të shkojnë përtej këtij kufiri (*shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010; nr. 24, datë 13.6.2007; nr. 38, datë 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Kushtetuta, në nenin 17 të saj, e ka pranuar përmbajtjen e



KEDNJ-së si minimumin e këtyre kufizimeve, pa penguar që legjislacioni vendas t'u japë më shumë të drejta e liri, si dhe një dimension më të madh realizimit të mbrojtjes së individit. Në lidhje me një të drejtë themelore, respektimi i detyrimeve ndërkombëtare nuk mundet asnjëherë të jetë shkak i një zvogëlimi të mbrojtjes së saj në krahasim me ato të parashikuara tashmë nga rendi i brendshëm, por mund dhe duhet, përkundrazi, të përbëjë instrument efikas të zgjerimit të vetë mbrojtjes (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pragu i rekomanduar nga GJEDNJ-ja prej 10% të vlerës që duhet përfituar, nëse do të përdorej si referencë zëri kadastral aktual i pronës së shpronësuar, përbën minimumin e garancive që duhet të sigurohen, por nuk e pengon ligjvënësin që të bëjë rregullimet e nevojshme brenda hapësirës së tij të vlerësimit dhe në përputhje me kërkesat e nenit 41 të Kushtetutës dhe faktorët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë që ndikojnë në vendimmarrjen e tij.

70. Për sa më sipër, përmbajtja e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 nuk arrin të garantojë një shpërblim të drejtë të pronës për subjektet e shpronësuara, në pjesën që nuk parashikon minimumin e garancive për subjektet për të cilat zëri kadastral ka ndryshuar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e së drejtës së pronës nga përmbajtja e këtyre dispozitave është i bazuar dhe duhet të pranohet.

C.2. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

71. Kërkesja ka pretenduar se përdorimi i metodologjisë së përcaktuar në pikën 1, shkronja “b”, të nenit 6 të ligjit nr. 133/2015 në kuadrin e parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të këtij neni, tashmë të shfuqizuara, krijon pasiguri juridike, për faktin se ka rënë baza ligjore që e mban ende në fuqi shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 6. Kjo dispozitë humbet kuptimin pa dispozitat e shfuqizuara, pasi ato kanë qenë hartuar në mënyrë të ndërlidhur. Në këto kushte, mungojnë elementet e parimit të sigurisë juridike, pra qartësia, saktësia dhe kuptueshmëria e ligjit në tërësi. Sipas kërkuarës, edhe rregullimet në nenin 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, udhëhiqen nga parimi i përfitimeve të zbritshme. Këto rregullime janë të ndërthurura me njëra-tjetrën dhe shprehin një vazhdimësi, e cila me shpalljen si jokushtetuese të pikave 3 dhe 5 të nenit 6, automatikisht lë hapësirë

për arbitraritet nga ana e ligjzbatuesve, të cilët duke rrëzuar apo zhvlerësuar kërkesat e pronarëve, bazuar në parashikimet e nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, kanë krijuar konfuzion të pritshmëritë e ligjshme të shtetasve.

72. Sipas subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron. Pretendimi se neni 6, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 133/2015 është i pazbatueshëm nuk është i argumentuar dhe bie ndesh me praktikën e zbatimit të tij nga ATP-ja. Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi se zbatueshmëria e nenit 6 kushtëzohet nga zbatimi i nenit 7, pika 2 me procedurën e parashikuar në shkronjat “a” dhe “b” të tij.

73. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, pika 1, shkronja “b”, e nenit 6 është e lidhur ngushtë me pikën 1, shkronja “a” të këtij neni, pasi nëse prona nuk do të llogaritej sipas llojit të pasurisë, zërit kadastral në momentin e shpronësimit, nuk do të kishte pse të parashikohej pika 1, shkronja “b”. I njëjti arsyetim është edhe për shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7, të cilat janë të lidhura ngushtë me shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të nenit 6 dhe nuk mund të qëndrojnë pa njëra-tjetrën. Nëse Gjykata do të konstatonte krijimin e boshllëkut ligjor me shfuqizimin që u ka bërë pikave 3 dhe 5 të nenit 6, ajo do të vendoste edhe detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor, në kuptim të nenit 78 të ligjit nr. 8577/2000.

74. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe pritshmëritë e ligjshme. Ky parim, mbi të cilin mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 15, datë 10.3.2016; nr. 25, datë 28.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i sigurisë juridike, përveç të tjerash, kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore dhe që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzistenca e



paqartësisë, e pasaktësisë, e kontradiksionit logjik ose e paazbatueshmërisë së normave ligjore mbartin drejtpërsëdrejti rrezikun e mosrespektimit të parimit të shtetit të së drejtës, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk është në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

75. Në kuptim të parimit të sigurisë juridike, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë që paraqet për funksionimin e shtetit të së drejtës shmangia e boshllëkut ligjor. Sipas saj, në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të këtij boshllëku, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv dhe kjo situatë mund të çojë në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese (*shih vendimin nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

76. Gjykata gjen me vend të theksojë se, kur ligjvënësi nuk përmbush detyrimin e caktuar nga Kushtetuta për miratimin e një ligji që duhet ta miratonte në bazë të këtij detyrimi apo ligji i miratuar është i paplotë, Gjykata nuk kontrollon ligjin, sepse një i tillë nuk ekziston, por kontrollon pse nuk ka ligj ose, ndryshe, në këtë rast Gjykata nuk kontrollon ligjin, por vetë ligjvënësin. Në këtë kuptim, çdo mosveprim i mundshëm i ligjvënësit për miratimin e tërësisë së normave të zakonshme të kërkuara për materializimin e një norme të caktuar kushtetuese me qëllim zbatimin e saj, mund të sjellë boshllëk ligjor dhe, për rrjedhojë, bëhet shkak për konstatimin e jokushtetutshmërisë. Por edhe kur ligjvënësi nuk vepron kur ndaj tij ka lindur një detyrim për të përmirësuar ose ndryshuar aktet ligjore ekzistuese, kjo mund të kthehet në një boshllëk thelbësor nëse mosbërja e këtyre ndryshimeve sjell pasoja gjatë zbatimit në praktikë të të drejtave themelore. Antikushtetutshmëria për shkak të boshllëkut ligjor vërehet edhe kur organi ligjvënës nuk vepron pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që deklaron ligjin të papajtueshëm me Kushtetutën. Megjithatë, jo në çdo rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese me efekte shfuqizuese, duhet të sjellë reagimin e ligjvënësit për miratimin e rregullimeve të reja ligjore, pasi edhe mosveprimi i ligjvënësit mund të jetë një mënyrë e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kjo,

ndonjëherë, mund të jetë një zgjidhje praktike ose mund të jetë e nevojshme.

77. Gjykata ka vlerësuar më sipër se pikat 3 dhe 5 të nenit 6 dhe shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 133/2015 rregullojnë situata të ndryshme dhe ato nuk mbivendosen (*shih paragrafin 57 të vendimit*). Në ndryshim nga sa pretendon kërkesja, shfuqizimi i pikave 3 dhe 5 të nenit 6 nuk e bën të pazbatueshëm parashikimin e shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni, pasi formulimi i kësaj dispozite është i zbatueshëm në kuptim të dispozitave të tjera të këtij ligji, konkretisht nenit 7, pika 2. Mungesa e parashikimeve të pikave 3 dhe 5 të nenit 6, për shkak të shfuqizimit të tyre dhe mosveprimi i ligjvënësit për miratimin e normave të reja ligjore nuk sjell ndonjë paqartësi në lidhje me zbatimin e nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, në kuptim të parimit të sigurisë juridike.

78. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, siç është konstatuar prej saj në paragrafin 67 të këtij vendimi, parimi i sigurisë juridike cenohet për shkak të boshllëkut ligjor të konstatuar nga mungesa e rregullimit ligjor në nenin 7, pika 2, të ligjit nr. 133/2015 të asaj kategorie subjektsh që ka pësuar ndryshime në zërin kadastral ndër vite.

79. Gjykata thekson se, gjatë hartimit të dispozitave të reja ligjore, ligjvënësi duhet të marrë masat që të eliminohet çdo paqartësi apo papajtueshmëri midis frymës së ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë, pasi kjo është një çështje me interes të përgjithshëm publik. Ruajtja e besimit të qytetarëve të shteti dhe të legjislacioni i miratuar prej organeve ligjvënëse të tij, si pjesë e parimit të shtetit të së drejtës, kërkon që autoritetet të mos miratojnë parashikime ligjore të paqarta, të dyfishta apo që mbivendosen mes tyre.

80. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se boshllëku ligjor i konstatuar prej saj cenon parimin e sigurisë juridike, si një nga elementet e parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.

C.3. Për pretendimin e cenimit të parimit të hierarkisë së akteve normative

81. Sipas kërkeses, transferimi i dispozitave të ligjit nr. 133/2015 në përmbajtjen e VKM-ve nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016, të ndryshuara me VKM-të nr. 765/2017 dhe nr. 766/2017, përmbajtja e të cilave më pas është shtuar, pakësuar ose ndryshuar konteksti i zbatimit të tyre, si dhe



rregullimi me këto akte nënligjore i çështjeve për të cilat Kuvendi nuk e ka autorizuar Këshillin e Ministrave, është bërë shkak për cenimin e së drejtës së pronës private, të parimit të sigurisë juridike, të parimit të hierarkisë së akteve normative, si dhe të së drejtës për një proces të rregullt e mjete ligjore efektive. Po ashtu, sipas kërkuësës, këto akte mbështeten në nenin 37 të ligjit, i cili parashikon vetëm afatet brenda të cilave Këshilli i Ministrave duhet të miratojë aktet për të cilat është autorizuar nga vetë ligji.

82. Sipas subjekteve të interesuara këto pretendime janë të pabazuara. Neni 37 i ligjit nr. 133/2015 ka të bëjë me autorizimin/detyrimin e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë aktet nënligjore për të bërë të zbatueshëm ligjin dhe afati 6-mujor është caktuar me qëllim moszvarritjen e procesit të trajtimit të pronës, por nuk mund të interpretohet si limit kohor brenda të cilit pushteti ekzekutiv duhet të miratojë këto akte. Ligji nr. 133/2015 paraqitet si një ligj kuadër, pra ai parashikon parimet se si do të bëhet i mundur kompensimi i subjekteve të shpronësuara dhe në të nuk jepen detaje për procedurat dhe teknikat se si duhet të zhvillohet ky proces, ndaj ligjvënësi ka autorizuar Këshillin e Ministrave për të ndjekur këtë proces duke nxjerrë të gjitha aktet që do e bëjnë të mundur zbatimin efektiv të ligjit. Aktet nënligjore kanë dalë në përputhje me rezervën ligjore relative dhe përcaktimet e tyre i përmbahen urdhërimeve të ligjit dhe nuk cenojnë rezervën ligjore relative sipas nenit 118 të Kushtetutës.

83. Gjykata vëren se kërkuësja, edhe pse ka pretenduar se VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016, të ndryshuara me VKM-të nr. 765/2015 dhe nr. 766/2017, cenojnë të drejtën e pronës private, parimin e sigurisë juridike dhe atë të hierarkisë së akteve ligjore, si dhe të drejtën për një proces të rregullt dhe mjete juridike efektive, për shkaket e cituara në pjesën hyrëse të vendimit, këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me tejkalimin nga ana e pushtetit ekzekutiv të tagrave që i janë dhënë nga pushteti ligjvënës, çka është pasqyruar, sipas kërkuësës, në rregullimin e ndryshëm të çështjeve të rregulluara nga vetë ligji nr. 133/2015. Për rrjedhojë, në kuptim të parimit *iura novit curia* këto pretendime do të trajtohen në këndvështrim të respektimit të kritereve të përcaktuara në nenet 116 dhe 118 të Kushtetutës.

84. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfutur kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr.3, datë 20.2.2006; nr. 5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Kurse në nenin 118, pika 1, Kushtetuta sanksionon se “*aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë*”. Ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon: “*Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte*”. Këto dispozita ndihmojnë për t’i dhënë kuptimin kushtetues dhe doktrinar konceptit *rezervë ligjore*, nëpërmjet të cilit kufizohet ose orientohet pushteti normativ i organeve ekzekutive për të rregulluar marrëdhënie të caktuara me akte nënligjore. Kjo *rezervë ligjore* krijon mundësinë që çështja konkrete e rregulluar pjesërisht me ligj të mund të detajohet më tej nga aktet nënligjore, duke iu përmbajtur parimeve dhe kufijve të përcaktuar nga ligji. Vetëm në këtë mënyrë autorizimi i ligjvënësit për nxjerrjen e akteve nënligjore mund të konsiderohet i realizuar brenda kufijve të kushtetutshmërisë (*shih vendimin nr. 60, datë 16.9.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

85. Bazuar në standardet e mësipërme, nisur nga pretendimet e kërkuësës dhe prapësimet e subjekteve të interesuara, Gjykata do të analizojë nëse përmbajtja e VKM-ve nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016 është në harmoni me normat që sanksionojnë parimin e shtetit të së drejtës, konkretisht elementet që kanë të bëjnë me respektimin e hierarkisë së akteve normative.

86. Në analizë të dispozitave të ligjit nr. 133/2015, rezulton se ai ka autorizuar Këshillin e Ministrave të përcaktojë metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë (neni 8, pika 4, shkronja “b”); fondin fizik të pronave në çdo qark (neni 12, pika 1, shkronja “a”); rregullat dhe procedurat për rastet e tjera të kompensimit fizik pas kompensimit fizik me ankand (neni 14, pika 5); rregullat e krijimit,



mbajtjes dhe administrimit të regjistrit të të gjitha vendimeve që njohin të drejtën e kompensimit të pronës së subjekteve të shpronësuara (neni 16, pika 1); territoret turistike për efekt të zbatimit të këtij ligji (neni 21, pika 5); për trajtimin e pronave të zëna me ndërtime, miratimin e shumës në dispozicion të subjekteve dhe shtrirjen kohore të përfitimit të kësaj shume në bazë të të ardhurave të arkëtuara, sipas shkronjës “c”, të pikës 3, të nenit 10 (neni 24, pika 5); listën e dokumenteve të nevojshme për procesin e trajtimit të pronës sipas këtij ligji (neni 26, pika 2); ngritjen e një komisioni me përbërje ndërinstitucionale, për administrimin e punës për identifikimin e pronës shtetërore që mund të kalojë dhe të bëhet pjesë në Fondin e Kompensimit të pronave (neni 26, pika 3); mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ATP-së (neni 26, pika 5); përcaktimin e tarifave për pranimin dhe administrimin e kërkesave (neni 28, pika 5); rregullat e hollësishme për procedurën e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të veprimtarisë së ATP-së me institucionet e tjera shtetërore (neni 36, pika 2); nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të ligjit, brenda 6-muajve nga hyrja në fuqi e tij (neni 37).

87. Duke iu referuar përmbajtjes së VKM-ve të kundërshtuara, rezulton se me VKM-në nr. 222/2016 janë rregulluar procedurat për mbledhjen, përpunimin, administrimin e akteve të subjekteve të shpronësuara dhe vendimmarrjen e ATP-së gjatë procesit të njohjes të së drejtës së kompensimit në zbatim të ligjit nr. 133/2015. Ky akt përcakton procedurën që duhet të ndjekë subjekti i shpronësuar nga data e dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues të saj. Në pikën 3 të VKM-së rezulton se përveç dokumentacionit ligjor dhe hartografik të përcaktuar nga neni 28, pika 1, shkronja “a”, në shkronjën “c” është shtuar edhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës që lidhet me origjinën e pronës së marrë padrejtësisht nga shteti. Në kuptim të pikës 4 të kësaj VKM-je, dokumentacioni ligjor përbëhet, sipas rastit, nga dokumentacioni hipotekor, kadastral, arkivor dhe vendime të mëparshme administrative ose gjyqësore, që vërtetojnë heqjen ose marrjen e së drejtës së pronësisë nga shteti subjektit të shpronësuar. Kurse sipas pikës 5/2, dokumentacioni tjetër mbështetës i kërkesës është dokumentacioni që kërkohet gjatë shqyrtimit

administrativ të kërkesës, dhe përbëhet nga vërtetime, deklarata noteriale, vendime kthimi ose kompensimi, ose çdo dokument tjetër që tregon përfitimet e mëparshme të subjekteve.

88. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se këto dispozita duket se sigurojnë një hetim sa më të plotë nga ana e organit administrativ dhe kërkuësja nuk ka arritur të provojë se ato vendosin një barrë të tepër mbi subjektet. Po ashtu, edhe parashikimet e tjera të VKM-së nr. 222/2016, në vlerësimin e Gjykatës, nuk përbëjnë tejkalim të delegimit të dhënë nga ligjvënësi për çështjet që mund të rregullojë ekzekutivi me akte nënligjore.

89. Në lidhje me VKM-në nr. 223/2016, ajo ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave. Ky akt ka pësuar ndryshime së fundmi edhe me VKM-në nr. 1114/2020, me të cilën është synuar të rregullohet çështja e vlerësimit të pronave që kanë pësuar ndryshime në zërin kadastral, në përputhje me rekomandimet e GJEDNJ-së në çështjen *Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, vendimi i datës 17.3.2020.

90. Gjykata më sipër vlerësoi se rregullimet e pikës 16/4 të VKM-së nr. 223/2016, të ndryshuar, për sa kohë që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të pronës, janë çështje që hyjnë në kompetencën ekskluzive të pushtetit ligjvënës dhe nuk mund të rregullohen me akte nënligjore, në kushtet kur ato përbëjnë ndërhyrje në të drejtën e pronës private (*shih paragrafët 64 dhe 66 të vendimit*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se përmbajtja e kësaj dispozite bie ndesh edhe me nenin 118 të Kushtetutës, për sa kohë ka rregulluar një çështje që në kuptim të rezervës ligjore absolute mund të rregullohet vetëm me akt të miratuar nga ligjvënësi.

91. Më tej, Gjykata vëren se në kreun III të këtij akti, që rregullon procedurat dhe rregullat e përgjithshme të kompensimit, pika 16/2 parashikon: “*Prioriteti i mënyrave të kompensimit përcaktohet sipas rendit kronologjik të mëposhtëm: a) Kompensim fizik në ish-pronën e subjektit të shpronësuar; b) Kompensim financiar dhe fizik nga fondi i tokës; c) Kompensim financiar*”. Po ashtu, pika 18 e VKM-së nr. 233/2016, të ndryshuar, ka këtë përmbajtje: “*Në të gjitha rastet kur subjekti nuk përfiton kompensim fizik sipas shkronjës “a”, të pikës 16/2, dhe ka një vendim përfundimtar, të vlerësuar financiarisht, përfiton kompensim*



financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në 20 % të vlerës totale të kompensimit financiar, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompensohet fizikisht nga fondi i tokës.”.

92. Sipas parashikimeve të sipërcituara, VKM-ja nr. 223/2016, e ndryshuar, ka vendosur një radhë të kompensimit, duke i dhënë përparësi kompensimit fizik përkundrejt atij financiar, e cila është detyruese për subjektin. Këto parashikime nuk i japin mundësi subjektit që të kundërshtojë apo të zgjedhë radhën e formës së kompensimit në përputhje me interesat e tij.

93. Gjykata vëren se, sipas pikës 5 të nenit 5 (përkufizime) të ligjit nr. 133/2015, “kompensim” është shprehërimi i drejtë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe format e kompensimit janë: “kompensim financiar”, “kompensim fizik nga fondi i tokës” dhe “kompensim fizik brenda pronës së njohur subjektit të shpronësuar”. Sipas pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 133/2015, subjektet e shpronësuar u nënshtrohen procedurave të kompensimit bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim: a) financiar; b) me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit; c) me aksione në shoqëri me kapital shtetëror ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme; ç) me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit. Gjykata vëren se dispozitat e sipërcituara të ligjit kanë parashikuar një renditje, por nuk kanë përcaktuar një radhë përparësie në kompensim.

94. Gjykata ka në vëmendje edhe përmbajtjen e nenit 20 të ligjit, i emërtuar “Kërkesat e patrajuara”, i cili parashikon: *“Kërkesat e bëra para hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe kërkesat e bëra brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj, nëse prona nuk kategorizohet në pronat e përcaktuara në nenet 4 dhe 25, të këtij ligji, do t’i nënshtrohen trajtimit të pronës nëpërmjet njohjes së të drejtës së subjekteve të shpronësuar me vendim të ATP-së dhe kompensimit të tyre sipas këtij ligji. Në çdo rast, aty ku është e mundur, i jepet përparësi kompensimit fizik në pronën që i njihet subjektit me vendim të ATP-së.”.*

95. Nga sa më sipër, konstatohet se vetë ligji, në lidhje me një kategori kërkesash, ka parashikuar përparësinë e kompensimit fizik në pronën që i njihet subjektit në ato raste kur kjo

formë kompensimi është e mundur. Nga ana tjetër, në lidhje me format e tjera të kompensimit ligji nuk ka caktuar radhë prioritare dhe as nuk përmban një delegim të shprehur për ekzekutivin për përcaktimin e radhës prioritare të kompensimit për subjektet që përfitojnë nga ky ligj. Ndërkohë që duke e krahasuar përmbajtjen e normave ligjore me ato nënligjore, rezulton se ajo është e ndryshme.

96. Duke iu referuar edhe përmbajtjes së nenit 17 të ligjit nr. 133/2015, me titull “Shqyrtimi i kërkesave të veçanta për kompensim financiar”, edhe në këto raste janë vetë subjektet që shprehin vullnetin për t’u kompensuar financiarisht me kërkesë të veçantë, duke përfituar brenda një afati më të shkurtër kompensim në një masë të caktuar nga fondi buxhetor vjetor, duke hequr dorë, në mënyrë të shprehur, nga pjesa tjetër e vlerës së kompensimit.

97. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ligji nr. 133/2015 ka qenë i qartë në dhënien e autorizimit ekzekutiv për të nxjerrë akte nënligjore, si në përmbajtje, objekt, qëllim dhe fushëveprim. Për sa kohë që ligji nuk ka bërë asnjë delegim për përcaktimin e radhës së kompensimit apo kombinimit të formave të ndryshme të kompensimit, konsiderohet se këto parashikime cenojnë kufijtë e rezervës ligjore dhe se pushteti ekzekutiv ka vepruar në tejkalim të normave ligjore dhe në mungesë të një delegimi të shprehur, duke rregulluar me akt nënligjor një marrëdhënie që i përket fushës së rregullimit të ligjvënës.

98. Në lidhje me pretendimet e tjera të kërkuases, referuar VKM-së nr. 223/2016, si dhe bazuar në përmbajtjen e dispozitave të këtij akti nënligjor, Gjykata vlerëson se në tërësinë e tyre nuk rezulton të kenë dalë tej parashikimeve të ligjit nr. 133/2015 dhe as të trajtojnë çështje në kundërshtim me rezervën ligjore.

99. Po ashtu, kërkuësja ka pretenduar se VKM-të nr. 222/2016 dhe nr. 223/2016 mbështeten në nenin 37 të ligjit nr. 133/2015, i cili parashikon vetëm afatet brenda të cilave Këshilli i Ministrave duhet të miratojë aktet për të cilat është autorizuar nga vetë ligji. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata vëren se aktet nënligjore të kundërshtuara kanë si bazë ligjore në përmbajtjen e tyre nenin 100 të Kushtetutës



dhe nenin 37 të ligjit nr. 133/2015, i cili ka parashikuar një afat 6-mujor për miratimin e akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të këtij ligji. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse për qëllime të saktësisë do të duhej që VKM-të të tregonin qartësisht dispozitat ligjore mbi të cilat mbështeten, referimi vetëm në këtë dispozitë dhe mungesa e referimit edhe në dispozitat e tjera të ligjit që përmbajnë delegim të shprehur për ushtrimin e veprimtarisë normuese të pushtetit ekzekutiv, nuk sjell pasoja në nivel kushtetues, për sa kohë që Gjykata vlerëson jo vetëm referencën ligjore të cituar nga akti nënligjor, por edhe përmbajtjen e aktit në drejtim të çështjeve që ai vetë ka rregulluar, në kuptim të kufijve të delegimit të shprehur nga ligji në tërësinë e tij. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkuësës për cenimin e parimit të hierarkisë së akteve ligjore është i bazuar.

100. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga shoqata kombëtare “Pronësi me drejtësi” është pjesërisht e bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “c” dhe 134, pika 1, shkronja “h” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 76, e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.
- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikave 16/2, 16/4 dhe 18 të VKM-së nr. 223, datë 23.3.2016, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar.
- Rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera.

- Detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë të plotësojë ligjin nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij.

- Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.2.2021.

Shpallur më 8.3.2021.

KRYETARE: Vitore Tusha

ANËTARË: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo

VENDIM

Nr. 49, datë 17.2.2021

MBI KËRKESËN PËR RISHIKIMIN E VENDORIT TË BORDIT TË ERE-s NR. 244, DATË 21.12.2020, “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË ‘SEKA HYDROPOWER’ SHPK, PËR VENDOSJE HIPOTEKE DHE BARRE SIGURUESE/PENG NË FAVOR TË BANKËS ‘INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA’ SHA, MBI PASURITË E PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME TË KRIJUARA APO QË DO TË KRIJOHEN NGA SHOQËRIA KONCESIONARE ‘SEKA HYDROPOWER’ SHPK”

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15 dhe 16, të “Rregullores për organizimin, procedurat dhe funksionimin e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/2 prot., datë 10.2.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 244, datë 21.12.2020, ka vendosur:



1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k.

- Gjatë procedurës së shqyrtimit të këtij transferimi, në ERE ka mbërritur kërkesa e datës 23.1.2021 e banorëve të fshatit Gjocaj, Njësia Administrative Derjan, pjesë e Bashkisë Mat, protokolluar në ERE me nr. 54 prot., datë 25.1.2021, për rishikimin e vendimit nr. 244/2020, duke kërkuar refuzimin e miratimit për vendosjen si kolateral për të marrë kredi bankare të pasurive që shoqëria do të krijojë në të ardhmen.

- Në referencë të nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 3, pika 7, germa “a” dhe germa “b”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, kërkesit legjitimohen për të paraqitur një kërkesë të tillë dhe kërkesa e tyre është paraqitur brenda afatit të përcaktuar.

- Kusht thelbësor për rishikimin e një vendimi të ERE-s është paraqitja e provave të reja nga palët e përfshira në këtë proces.

- Për sa i përket pretendimit të kërkuarve se projekti i realizimit të dy HEC-eve shtrihet 2.08 km brenda këtij parku kombëtar dhe pavarësisht faktit se vendimi i Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, për pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë së tyre, duke shfuqizuar licencën e miratuar nga ERE, në emër të shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike për HEC Zais, nuk është i formës së prerë, mbetet fakt që ky HEC është duke u ndërtuar në një zonë të mbrojtur, duke cenuar rëndë interesat e publikut dhe mjedisin, vlen të theksohet se shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., për qëllime të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin sipas kërkesave të rregullores përkatëse. Po ashtu, kërkesit nuk kanë provuar se ka ndryshuar statusi i dokumenteve mbi të cilat është mbështetur vendimi i ERE-s për licencimin e shoqërisë, në mënyrë specifike me zonën ku do të zhvillohet projekti, e as nuk kanë provuar se organet kompetente apo një vendim i formës së prerë të gjykatës të ketë miratuar apo

ndryshuar përcaktimet e tyre. Gjithashtu rezulton e aprovuar pavlefshmëria e këtyre dokumenteve.

- Për qëllime të aplikimit, për marrjen e autorizimit të ERE-s, për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka Hydropower” sh.p.k., kjo e fundit, nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1260/1 prot., datë 28.12.2020, ka depozituar në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (MIE-s) me nr. 8580/1 prot., datë 22.12.2020, drejtuar shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., dhe bankës “Intesa Sanpaolo sh.a.”, në lidhje me marrjen e konfirmimit të MIE-s lidhur me procesin e huamarrjes me bankën Intesa Sanpaolo sh.a., ku ndër të tjera Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) shprehet se në zbatim të nenit 17, “Kufizimet” të kontratës së koncesionit, pika 3, konfirmojmë të drejtën e parashikuar në kontratë për vendosje hipoteke dhe barrë mbi asetet e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., të krijuara në zbatim të kësaj kontrate për efekt të kredisë në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank” sh.a., me kusht që kjo të jetë në përputhje me kontratën e koncesionit.

- Për sa i përket pretendimit të kërkuarve se fakti që në aplikimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për transferim të aseteve, mungon pjesa më e madhe e dokumentacionit të kërkuar nga rregullorja dëshmon një nxitim në aplikim e se ky nxitim lidhet edhe me faktin që banorët e zonës Derjan po ndjekin disa beteja ligjore kundrejt shoqërisë, me qëllim ndalimin e ndërtimit dhe mos vënien në funksion të HEC që po ndërtohet në zonën e mbrojtur, vlen të theksohet se në zbatim të përcaktimeve të ligjit dhe rregullores përkatëse, bazuar në propozimin përkatës, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria, i cili në kuptim të kërkesave të rregullores është konsideruar i mjaftueshëm për të marrë në konsideratë shqyrtimin e kësaj kërkesë, Bordi i ERE-s ka vendosur të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a. mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, të krijuara apo që do krijohen nga shoqëria koncesionare “Seka



Hydropower” sh.p.k., duke konstatuar dhe dokumentacionin përkatës të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Po ashtu, në “Rregulloren për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, është parashikuar që subjekti mund të plotësojë dokumentacionin përkatës pas fillimit të procedurave. Sa më sipër nuk përbën provë të re, të tillë që ta çojë Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 244/2020.

- Për sa i përket pretendimit të kërkuarve që ERE të mos vijojë procedurat për miratimin e transferimit të asetëve dhe vendosjen e tyre si kolateral në formën e pengut, barrës siguruese, apo hipotekës, duke qenë se këto pasuri, që po realizohen nga shoqëria “Seka Hydropower” sh.p.k., aktualisht janë konsideruar nga gjykata pjesërisht në kundërshtim me ligjin, duke sjellë në vëmendje se një transferim si më sipër mbart në vetvete rrezikun që në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e debitorit, shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., këto asete dalin në ankand, ose i transferohen bankës, ERE, në vendimmarrjen finale mbi kërkesën e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k. do të veprojë në ushtrim të kompetencave të saj dhe do të analizojë dokumentacionin e depozituar nga ana e shoqërisë në përputhje me kërkesat dhe parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

- Për gjithë sa më sipër, kërkuarët nuk kanë paraqitur asnjë provë të re, të tillë që ta çojë Bordin e ERE-s të ndryshojë vendimin nr. 244/2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 21.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë ‘Seka Hydropower’ sh.p.k., për vendosje hipoteke dhe barrë siguruese/peng në favor të bankës ‘Intesa Sanpaolo Bank Albania’ sh.a., mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të krijuara apo që do të krijohen nga shoqëria koncesionare ‘Seka Hydropower’ sh.p.k.”, si të pambështetura në prova.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesit mbi vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 50, datë 17.2.2021

MBI MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË, TË PROPOZUAR NGA OST SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 43, datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a.”; të nenit 21, të direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/EC; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/1, datë 9.2.2021, mbi miratimin e riemërimit të Zyrtarit të Pajtureshmërisë, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr. 662 prot., datë 26.1.2021, protokolluar në ERE me nr. 134 prot., datë 27.1.2021, ka paraqitur në ERE vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë “OST” sh.a., nr. 21, datë 28.12.2020, me anë të të cilit ka riemëruar zyrtarin e pajtureshmërisë, si dhe ka miratuar kontratën e ofrimit të shërbimeve të Zyrtarit të Pajtureshmërisë midis OST sh.a., dhe i është drejtuar ERE-s me kërkesën për miratimin e riemërimit të Zyrtarit të Pajtureshmërisë dhe kontratës së ofrimit të shërbimeve të Zyrtarit të Pajtureshmërisë, ndërmjet OST sh.a. dhe Zyrtarit të Pajtureshmërisë.

- Kërkesa e “OST” sh.a. është në mbështetje të pikës 2, paragrafi 5, të vendimit të ERE-s nr. 43,



datë 15.3.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC, mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë; të direktivës 2009/72/EC, të datës 13 korrik 2009, lidhur me rregullat e përbashkëta për tregjet e brendshme të energjisë elektrike; të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimeve të ERE-s nr. 154, datë 11.12.2015, për miratimin e “Rregullave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike”.

- ERE, në zbatim të kompetencave që i jep ligji, me vendimin nr. 147, datë 28.9.2017, ka miratuar kontratën tip për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së OST sh.a.

- Në kontratën sipërcituar, përkatësisht në shtojcën 2 të saj janë të listuar kriteret që duhet të përmbushë zyrtari i pajtuëshmërisë, si më poshtë:

- Arsimiti i lartë (master shkencor ose diplomë ekuivalente) në degët Inxhinieri Elektrike/Juridik/Ekonomik;

- Eksperienca mbi 15 vjet në degën në të cilën është diplomuar, nga të cilat mbi 10 vjet në sektorin e energjisë elektrike;

- Njohuri të shkëlqyera të gjuhës angleze;

- I padënuar më parë, vërtetuar me dëshmi penaliteti lëshuar jo më vonë se 1 (një) muaj para lidhjes së kontratës;

- Të mos ketë punuar në kompani të prodhimit, furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, 3 vjet para lidhjes së kontratës për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë;

- Niveli i lartë i integritetit dhe kryerje në mënyrë shembullore në çdo kohë e detyrës/shërbimit;

- Aftësi të mira analizuese dhe aftësi për të pasqyruar dhe prioritetizuar një fushë të gjerë dhe të larmishme, sipas detyrave të parashikuara në kontratën për ofrimin e shërbimeve të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë dhe programin e pajtuëshmërisë;

- Aftësi të mira komunikuese dhe personalitet i fortë, përqaasje, nismë, pavarësi, këmbëngulje.

- Zyrtari i Pajtuëshmërisë së OST sh.a., znj. Brunilda Veizi, i ka përmbushur kriteret e sipërcituara që në emërimin e saj të parë, sikurse

është cituar edhe në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147/2017 dhe aktualisht është kërkuar riemërimi i saj nga ana e OST sh.a. për një mandat të dytë (3-) trevjeçar.

- Nga analizimi i përmbajtjes së kontratës që ka përcjellë OST sh.a. në ERE për vijimin e marrëdhënies me zyrtarin e pajtuëshmërisë, rezulton se ajo është e njëjtë me atë që ka miratuar ERE me vendimin nr. 147/2017.

- Miratimi nga ERE i riemërimit në detyrë të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së OST sh.a., për mandatin e tij të dytë, i cili do të vijojë të rregullohet nëpërmjet kontratës së ofrimit të shërbimit të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë, të miratuar nga ERE nr. 147/2017, nënkupton edhe miratimin e rinovimit të kësaj kontrate për tre vitet e ardhshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë riemërimin në detyrë të Zyrtarit të Pajtuëshmërisë së OST sh.a., të znj. Brunilda Veizi, ofrimi i shërbimit të së cilës do të rregullohet me kontratën e miratuar nga Bordi i ERE-s për këtë qëllim me vendimin nr. 147/2017.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 51, datë 17.2.2021

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA, “PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË BALANCIMIT, KAPACITETIT REZERVË DHE ENERGJISË BALANCUESE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 105, germa “c”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave



Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, si dhe të nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 27/5 prot., datë 12.2.2021, të Drejtorive Teknike, mbi miratimin e kontratës ndërmjet shoqërisë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) dhe shoqërisë Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH sh.a.) “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 613/1 prot., datë 28.1.2021, ka përcjellë për miratim në ERE kontratën me nr. KESH/nr. 477/1 prot., dhe OST/nr. 613 prot., ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”.

- Me vendimin nr. 39, datë 6.3.2020, Bordi i ERE-s ka vendosur që, kontrata KESH/nr. 6651 prot., dhe OST/nr. 8859 prot., datë 31.12.2018, lidhur ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese”, do të shtrijë efektet e përcaktuara në nenin 15 të saj, deri në miratimin nga ERE të kontratës “Për sigurimin e shërbimit të balancimit, kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese” për vitin 2020, të paraqitur nga palët në mungesë të burimeve të tjera të sigurimit të këtij shërbimi për OST sh.a.

- Përmes vendimit nr. 106, datë 2.7.2020, Bordi i ERE-s vendosi “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”.

- Në vijim, me vendimin nr. 275, datë 28.12.2020, Bordi i ERE-s vendosi shtyrjen e afatit të zbatimit nga pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike, pa efekte financiare (*dry run*) deri në datën 31.3.2021, të rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, sipërcituar, si dhe OST sh.a. dhe pjesëtarët e tregut

të energjisë elektrike të vijojnë aplikimin e periudhës *dry run* deri në këtë datë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, datë 20.8.2018, vendosi miratimin e “Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018” midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Për periudhën 2019–2020, vlen të theksohet se shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit për sistemin elektroenergjetik janë siguruar nga shoqëria KESH sh.a.

- Në pikën 2, të dispozitivit të vendimit sipërcituar, është përcaktuar se: “Çmimet dhe tarifat e përmendura në këtë kontratë nuk janë objekt i miratimit nga ERE”.

- Për këtë arsye, çmimet e përcaktuara në nenin 9 të kontratës, nuk janë objekt i miratimit nga ana e ERE, pasi këto çmime janë të negociuara dhe të dakordësuara nga vetë palët OST sh.a. dhe KESH sh.a.

- Nga analiza e kontratës së përcjellë nga ana e shoqërisë OST sh.a. përmes shkresës nr. 613/1 prot., datë 28.1.2021, u konstatua se ajo është e njëjtë me kontratën për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.8.2018.

- Veç sa më sipër, shërbimet ndihmëse dhe ato të balancimit janë elemente kryesore në garantimin e sigurisë së operimit të sistemit elektroenergjetik shqiptar. Për periudhën deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, për “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”, KESH sh.a. si kompani e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik ka qenë dhe vijon të jetë ofrues i këtyre shërbimeve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Zgjatjen e efekteve juridike të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 184, datë 20.8.2018, “Mbi miratimin e Kontratës për sigurimin e shërbimeve të balancimit (kapacitetit rezervë dhe energjisë balancuese) të sistemit elektroenergjetik për



periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018' midis OST sh.a. dhe KESH sh.a.”.

2. Kontrata do të shtrijë efektet nga data 1 janar 2021 deri në hyrjen në fuqi me efekte financiare të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020, për “Miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Inspektimeve të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet juridike nga data 1 janar 2021.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 52, datë 17.2.2021

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
222, DATË 15.12.2020 DHE
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
223, DATË 15.12.2020

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 95 dhe nenit 113, të “Kodit të procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/3 prot., datë 10.2.2021 të përgatitur nga Grupi i Punës, ngritur me urdhrin e kryetarit të

ERE-s nr. 125, datë 4.11.2020, mbi subjektet debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit, konstatoi se:

- Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, për një afat 30-vjeçar, modifikuar me vendimin e Bordit nr. 194, datë 30.8.2018, si dhe mbajtëse e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015, për një afat 26-vjeçar.

- Shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/6 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu, iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 222, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, të ndryshuar, dhe me vendimin nr. 223, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015. Për këto vendimmarrje shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. u njoftua nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/6-1 prot., datë 23.12.2020 dhe iu bë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Vendimet e Bordit të ERE-s nr. 222/2020 dhe nr. 223/2020 janë marrë në kushtet kur shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. mbante ende statusin e debitorit për mosshlyerjen e pagesave



përkatëse të rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019.

- Në vijim shoqëria ka depozituar në ERE shpjegimet e saj dhe ka shlyer pjesën më të madhe të debisë dhe rezultoi se, në krahasim me debinë fillestare, asaj i ka mbetur ende pa u likuiduar një vlerë e parakorduar e debisë që zë një peshë specifike prej 13.60% në krahasim me debinë fillestare.

- Duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga shoqëria, vlerën relativisht të vogël të mbetur pa shlyer nga detyrimi fillestar, i cili krahasimisht me vlerën totale të detyrimit zë një peshë shumë të vogël, gjendjen e vështirë të shkaktuar për shkak të pandemisë globale në pjesën më të madhe të bizneseve private, si dhe faktin që subjekti i mësipërm është licencuar për të kryer aktivitet në tregun e energjisë elektrike duke nisur që nga viti 2010, vlerësohet që shoqëria është në kushtet e moskuptimit të drejtë të vlerës totale të detyrimit të mbartur ndër vite, apo në kushtet e mosrakhordimit të saktë të vlerës që rezultoi në një diferencë të pashlyer.

- Në nenin 95, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se:

- Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet se: Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për:

a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.

Për sa i përket diferencës së mbetur nga vlera e parakorduar e debisë përkatëse të pashlyer ende nga shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k., duke marrë në konsideratë angazhimin dhe vullnetin e shoqërisë për shlyerjen e saj dhe shmangien e faktit që çoi Bordin e ERE-s të fillojë procedurat për të hequr licencat me të cilat është pajisur kjo shoqëri, do t’i lihet afat për rakhordimin e vlerës së pashlyer dhe likuidimin e saj jo më vonë se afati përfundimtar i shlyerjes së pagesave të rregullimit që do të përcaktohen për vitin 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Hidropower Elektrik’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, të ndryshuar”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 222, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 130, seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Hidropower Elektrik’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 59, datë 22.6.2011, i ndryshuar”.

3. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 223, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Hidropower Elektrik’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015”.

4. Shfuqizimin e vendimit nr. nr. 223, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 267, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Hidropower Elektrik’ sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 19, datë 11.2.2015”.

5. Shoqëria “Hidropower Elektrik” sh.p.k. të shlyejë diferencën e mbetur nga vlera e parakorduar e debisë (përkatësisht për të dy licencat, shuma në 62,976 lekë), jo më vonë se afati përfundimtar për shlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2021.

6. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 53, datë 17.2.2021

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
220, DATË 15.12.2020, DHE
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE TË NISUR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
221, DATË 15.12.2020**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 17.2.2021, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 27/3 prot., datë 10.2.2021, të përgatitur nga grupi i punës, i ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 125, datë 4.11.2020, mbi subjektet debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimit,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, për një afat 30-vjeçar, dhe modifikuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 95, datë 16.7.2012, si dhe e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/3 prot., datë 4.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6, të “Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse, në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së rregullimit, për vitet në të cilat është debitore. Gjithashtu, iu kërkuar që të përcillte në

ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t'i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e kryetarit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, i ndryshuar, dhe me vendimin nr. 221, datë 15.12.2020, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015. Për këto vendimmarrje shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” u njoftua nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 1172/3-3 prot., datë 23.12.2020, dhe iu bë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Vendimet e Bordit të ERE-s nr. 220/2020 dhe nr. 221/2020 janë marrë në kushtet kur shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. mbante ende statusin e debitorit për mosshlyerjen e pagesave përkatëse të rregullimit për vitin 2018 dhe vitin 2019.

- Në vijim, shoqëria ka depozituar në ERE shpjegimet e saj dhe ka shlyer pjesën më të madhe të debisë dhe rezulton, se, në krahasim me debinë fillestare, asaj i ka mbetur ende pa u likuiduar një vlerë e parakorduar e debisë që zë një peshë specifike prej 0.37%, në krahasim me debinë fillestare.

- Duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga shoqëria, vlerën relativisht të vogël të mbetur pa shlyer nga detyrimi fillestar, i cili krahasimisht me vlerën totale të detyrimit zë një peshë shumë të vogël, gjendjen e vështirë të shkaktuar, për shkak të pandemisë globale në pjesën më të madhe të bizneseve private, si dhe faktin që subjekti i mësipërm është licencuar për të kryer aktivitet në tregun e energjisë elektrike, duke nisur që nga viti 2010, vlerësohet që shoqëria është në kushtet e moskuptimit të drejtë të vlerës totale të detyrimit të mbartur ndër vite, apo në kushtet e mosrakhordimit të saktë të vlerës që rezulton në një diferencë të pashlyer.



- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

- Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

- Në nenin 9, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017, parashikohet, se me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat, sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë, për:

a) të mbyllur procedurën për heqjen e licencës.

- Për sa i përket diferencës së mbetur nga vlera e parakorduar e debisë përkatëse të pashlyer ende nga shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k., duke marrë në konsideratë angazhimin dhe vullnetin e shoqërisë për shlyerjen e saj dhe shmangien e faktit, që çoi Bordin e ERE-s të fillojë procedurat për të hequr licencat me të cilat është pajisur kjo shoqëri, do t’i lihet afat për rakordimin e vlerës së pashlyer dhe likuidimin e saj, jo më vonë se afati përfundimtar i shlyerjes së pagesave të rregullimit që do të përcaktohen për vitin 2021.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 220, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Power-Elektrik-Slabinje’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, të ndryshuar”.

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 220, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 93, seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Power-Elektrik-Slabinje’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 10, datë 8.2.2010, të ndryshuar”.

3. Përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e

licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Power-Elektrik-Slabinje’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015”.

4. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 221, datë 15.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 265, seria T15P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘Power-Elektrik-Slabinje’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 17, datë 11.2.2015.

5. Shoqëria “Power-Elektrik-Slabinje” sh.p.k. të shlyejë diferencën e mbetur nga vlera e parakorduar e debisë (përkatësisht për të dyja licencat, shuma në 4,466 lekë), jo më vonë se afati përfundimtar për shlyerjen e pagesës së rregullimit të vitit 2021.

6. Grupi i punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 40, datë 27.1.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KORÇË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 27.1.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: Mbi miratimin e vendimit “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a.”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Korçë (UK Korçë), me shkresën nr. 361 prot. ERRU, datë 18.12.2020, si dhe plotësimet me shkresë përcjellëse nr. 12 prot., datë 12.1.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit, të UK Korçë, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) shoqëria UK Korçë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 112 548 banorë të Bashkisë Korçë;

b) drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Pandi Qirinxhi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Gjeodezi, në vitin 1985 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

c) drejtuesi teknik i shoqërisë për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura, z. Aleks Andoni, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Kimi industriale, në vitin 1993 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Korçë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë

financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjetllësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejinin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Korçë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a. me (NUIS: J64103141O), në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura;

c) Kategoria D - Për trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues ligjor – Petrit Tare;

b) Drejtues teknik – Pandi Qirinxhi;

c) Drejtues teknik – Aleks Andoni.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a. është Bashkia Korçë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës-Kanalizime Korçë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ndriçim Shani**

**VENDIM****Nr. 53, datë 4.2.2021****PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË
SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË
NDOTURA PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS-KANALIZIME PATOS SHA**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 39); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.2.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Patos sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

VËREN SE:

Shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime Patos” (UK Patos) me shkresë nr. 163 prot., datë 1.10.2020, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” ka paraqitur kërkesën pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) për ndryshimin e tarifave në zonën e shërbimit për të tri kategoritë e konsumatorëve, si dhe për ujin me shumicë, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 40.

1. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) pasi e gjeti paraqitjen e kërkesës për vendosjen e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura dhe tarifën fikse të shoqërisë UK Patos në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 40, me vendimin nr. 129, datë 11.11.2020, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për propozimin e bërë nga UK Patos për nivel të ri tarifor, për shërbimet UK, për të gjithë zonën e riorganizuar të shërbimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.”

2. Ujësjiellës-Kanalizime Patos në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU-së me shkresë nr. 163 prot., datë 1.10.2020, “Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura” propozon ndryshim të nivelit tarifor për të tri kategoritë e konsumatorëve, si dhe për ujin me shumicë, sipas tabelës së mëposhtme:



Tabela me tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria sipas kategorisë së konsumatorëve

Kategoria e konsumatorëve	Zona e shërbimit		
	Tarifat aktuale (të pa miratuara nga ERRU-ja)	Tarifat e propozuara	Diferenca me tarifat aktuale
A. Shërbimi i FU-së	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³
1. Konsumatorë familjarë	50	119	+69
2. Konsumatorë publik	100	150	+50
3. Konsumatorë privat	100	150	+50
4. Afrofe për konsumatorë familjar	600 lekë/muaj	150 litra/ditë, person	n/a
B. Shërbimi i KUN-së	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³
1. Konsumatorë familjarë	Nuk aplikon tarifa për ujërat e ndotura	20	+20
2. Konsumatorë publik		20	+20
3. Konsumatorë privat		20	+20
C. Tarifë fikse shërbimi	lekë/muaj/lidhje	lekë/muaj/lidhje	lekë/muaj/lidhje
1. Konsumatorë familjarë	0	200	+200
2. Konsumatorë familjarë inaktiv	200 lekë/muaj	200 lekë/muaj	0
3. Konsumatorë publik	0	200	+200
4. Konsumatorë privat	0	200	+200
D. Shitje uji me shumicë	lekë/m ³	lekë/m ³	lekë/m ³
Shitje uji me shumicë UK Fier	24	50	+26

3. Në aplikimin e shoqërisë me referencë vitin e mbyllur 2019, si dhe duke konsideruar tarifat e reja të propozuara, shoqëria ka përcaktuar gjithashtu objektivat që do të realizohen në vitin 2021. Treguesit kryesorë të performancës për të dy vitet, përkatësisht 2019–2020, si edhe objektivat për vitin 2021, jepen në tabelën e mëposhtme.

Treguesit kryesorë të performancës sipas shoqërisë për vitet 2019–2020–2021

Treguesit e performancës	Njësia	Treguesit e performancës sipas shoqërisë		
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021 objektivat
1. Uji pa të ardhura	%	58.7	55.2	65.4
2. Mbulimi me ujë	%	86.4	86.4	89.2
3. Mbulimi me KUN	%	0	0	52
4. Niveli i matjes	%	60	60	100
5. Norma e arkëtimit korrente	%	77.3	68.7	70.2
6. Norma e përgjithshme e arkëtimit	%	105.6	100.7	81.4
7. Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	8	8	8
8. Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje UK	24.3	24.8	10.8
9. Mbulimi i kostove O&M	%	23	24	75



4. Shoqëria në relacionin e saj e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave sipas argumenteve të mëposhtme:

a) nevoja për të qenë një shoqëri e rregulluar ligjërisht me tarifa të miratuara nga ERRU-ja;

b) për arsye të riorganizimit në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”;

c) aplikon për të përmirësuar situatën financiare, pasi UK Patos është një shoqëri e cila bën pjesë në grupin e shoqërive mjaft të dobëta financiarisht me nivel shumë të ulët të mbulimit të kostove O&M prej 23%;

d) aplikon për shkak të rritjes së kostove si rezultat i marrjes nën administrim nga shoqëria të njësive administrative Zharrëz dhe Ruzhdië.

Shoqëria UK Patos ofron shërbimin e furnizimit me ujë në 86.4% të popullsisë në zonën e juridiksionit të saj, ndërsa shërbimin e largimit të ujërave të ndotura, pas transferimit, do ta ofrojë për 52% të popullsisë. Treguesi i ujit pa të ardhura është në nivelin 58.7% dhe shoqëria ka nevojë për ndërhyrje me efikasitet në riparimet në rrjetin shpërndarës dhe për kryerjen e investimeve në rrjet duke qenë se rrjedhjet shkaktojnë humbje të mëdha.

UK Patos operon me kosto të energjisë elektrike shumë të larta, duke qenë se uji prodhohet me ngritje mekanike me pompa dhe elektromotorë me rendiment të ulët, distanca e madhe midis matësve të energjisë elektrike dhe stacioneve të pompimit ka rënduar faturën për shkak të lidhjeve të paligjshme dhe mosdakordësia midis OSHEE-së dhe UK Patos për vendosjen e çmimit me tension të mesëm dhe jo të ulët, të gjitha këto kanë bërë që kostot e energjisë elektrike të zënë 53% të kostove O&M. Me të ardhurat e gjeneruara UK Patos nuk arrin të mbulojë as 1/4 e kostove të operimit duke rënduar më shumë situatën financiare, megjithëse shoqëria subvencionohet nga qeveria qendrore përsëri nuk arrihen të mbulohen nevojat e saj.

UK Patos synon rritjen e tarifave për të gjithë zonën e shërbimit duke propozuar tarifa të larta, me të cilat, duke përmirësuar edhe nivelin e kostove, të arrijë rreth 75% të mbulimit të kostove O&M.

5. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 42, ERRU-ja ka kërkuar informacion shtesë nga UK Patos, si dhe verifikim të saktësisë së të dhënave të vëna në dispozicion nga shoqëria.

6. ERRU-ja, në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe treguesve të performancës, si dhe në analizën ekonomike financiare, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Patos të kritereve të mëposhtme:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar (ligji nr. 9121), për mos lejjimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve” të ndryshuar (ligji nr. 9902);

d) orientimin drejt mbulimit të kostove të Operim & Mirëmbajtjes;

e) tarifat e propozuara nga operatori të jenë në përputhje të plotë me parimin ligjor rregullator mbi përballueshmërinë e tyre nga ana e konsumatorëve familjarë;

f) tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

g) propozimin për ndryshimin e tarifave nga shoqëria, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar kjo analizës tekniko-ekonomike, si dhe realizimit të objektivave të performancës të përcaktuara.

7. ERRU-ja, në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë i konsideron të arritshëm objektivat mbi treguesit e performancës dhe për këtë rekomandon:

a) shoqëria duhet të hartojë plan biznesi afatgjatë (pesëvjeçar) në përputhje me situatën aktuale të zonës së shërbimit pas riorganizimit, me objektiva dhe plane veprimi për realizimin e tyre;



b) të hartojë planet e veprimit dhe të ndërmarrë aksionin për gjetjen dhe eliminimin e të gjitha lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes në zonën e shtuar rurale dhe të evidentojë të gjithë klientët në zonën e shërbimit sidomos në zonat rurale të shtuara;

c) shoqëria duhet të hartojë një bilanc uji sa më real duke u nisur nga një vlerësim më i saktë i sasisë së ujit të prodhuar, si dhe të përcaktimit të nënkomponentëve të humbjeve teknike dhe administrative në sistemet e furnizimit me ujë, sidomos për zonat rurale të shtuara;

d) të bëjë përpjekje për të realizuar instalimin e matësve të mëdhenj në pikat e prodhimit të ujit dhe në pikat kyçe të rrjeteve shpërndarëse, si dhe ato individuale për të gjithë klientët;

e) kostot e shërbimit FU dhe KUN të mbahen me qendra sipas shërbimeve;

f) të ndërmarrë hapat e duhura për të arritur një marrëveshje me OSHEE-në që të aplikojë një çmim njësi të energjisë elektrike për tension të mesëm dhe jo të ulët që aplikohet aktualisht ndaj UK Patos. Fillimi i pagesës së një pjese të shumës së faturës së energjisë elektrike nga shoqëria për OSHEE-në do të jetë një premisë e mirë që kjo e fundit të ndryshojë mënyrën e faturimit. Në rast dështimi të ndjekë rrugën ligjore për korrigjimin e kësaj anomalie faturimi;

g) të rrisë rrugët e komunikimit me publikun për ndërgjegjësimin në lidhje me kostot reale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, kosto të cilat duhet të përballohen nga faturat e konsumatorëve, si dhe në lidhje me përpjekjet që po bën shoqëria në bashkëpunim me pushtetin vendor, dhe AKUM-in për projektet që po zbatohen dhe ato që priten të fillojnë, që do të përmirësojnë dukshëm cilësinë e shërbimeve në zonën e shërbimit;

h) të hartojë inventarin e aseteve me informacionin për kohën kur janë instaluar dhe të gjitha të dhënat e tyre (materialin, dimensionet, gjatësitë etj.) dhe hartojë një plan për menaxhimin e tyre;

i) shoqëria në aplikimin pasardhës, në lidhje me tarifën për shitjen e ujit me shumicë, referuar Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave, duhet të hartojë një analizë të detajuar të kostove të prodhimit të ujit me shumicë dhe në konsultim

edhe me shoqërinë blerëse dhe të dakordësuar midis palëve.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifën e propozuar nga operatori mbi bazën e metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe akteve të tjera rregullatore që lidhen me të, arrin në konkluzionin se tarifën e propozuar sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kriterëve ligjore referuese lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuar, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, për gjithë sa më sipër, në zbatim të nenit 13, 14 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Patos si më poshtë:

Kategoria	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
Tarifë volumetrike për furnizimin me ujë	lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	70
Konsumatorë publik	135
Konsumatorë privat	135
Tarifë volumetrike për KUN*	lekë/m ³
Konsumatorë familjarë	20
Konsumatorë publik	20
Konsumatorë privat	20
Tarifë fikse	lekë/muaj/lidhje
Konsumatorë familjarë	200
Konsumatorë publik	200
Konsumatorë privat	200
Tarifë e shitjes së ujit me shumicë	lekë/m ³
UK Fier	38



2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2021, për UK Patos, do të jenë:

Treguesit e performancës	Njësia e matjes	Niveli i objektivit për vitin 2021 të përcaktuar nga ERRU
1.Mbulimi i kostove O&M	%	54
2.Uji pa të ardhura	%	60
3.Mbulimi me ujë	%	90
4.Mbulimi me KUN	%	52
5.Niveli i matjes	%	100
6.Norma e arkëtimit korrente	%	74
7.Norma e arkëtimit e përgjithshme	%	88
8.Vazhdimësia e furnizimit me ujë	orë/ditë	10
9.Eficienca e stafit	staf/1000 lidhje	10.8

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Patos sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Patos, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 1.4.2021 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

SHKURTIM VENDIMI Nr. 8823, datë 26.2.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

Gjyqtare: Alma Kodraliu,
asistuar nga Sekretare Gjyqësore Gencjana Dada, sot, më datë 26.2.2021, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen tregtare që i përket:

KËRKUES: Shoqëria “Brum” sh.p.k. përfaqësuar nga administratore Aulona Sula.

OBJEKTI: Hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Nenet 320, 334 të K. Pr. Civile; nenet 3, 4, 13, 14/1 dhe 15 të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Faqe| 4780

VËREN:

Se shoqëria “Brum” sh.p.k. i është drejtuar kryesisht kësaj Gjykate, me kërkesën formale për hapjen e procedurave të falimentimit të saj, mbështetur në ligjin 110/2016, “Për falimentimin”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në nenet 126, 306–308 të K. Pr. Civile, nenin 26 e vijues të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuarit, shoqëria “Brum” sh.p.k.

2. Hapjen në orën 14:55, të datës 26.2.2021, të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., me administratore znj. Aulona Sula, me seli në adresën: Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Perlat Rexhepi”, Rezidenca Ivanaj nr. 12 dhe nr. 13, Tiranë.

3. Emërimin si administratore të falimentimit për shoqërinë “Brum” sh.p.k. të znj. Shpresa Breçani, e regjistruar në listën e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, më nr. rendor 243, me adresë: Pallati i Kulturës, kati i tretë nga parkimi, Tiranë.

4. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Brum” sh.p.k. të paraqesin pranë administratores së falimentimit pretendimet e tyre, brenda 45 ditëve nga dita e shpalljes së këtij vendimi në QKB.



5. Të gjithë kreditorët e shoqërisë “Brum” sh.p.k. të njoftojnë menjëherë administratoren e falimentimit për pretendimet dhe të drejtat e tyre të siguruara mbi pasuritë e debitorit.

6. Personat që kanë detyrime ndaj debitorit, shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë ato administrores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.

7. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Brum” sh.p.k. për raportim të mbahet brenda 60 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

8. Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Brum” sh.p.k. për verifikim të mbahet brenda 60 ditëve nga përfundimi i afatit të depozitimit të pretendimeve.

9. Urdhërohet publikimi i shkurtimit të këtij vendimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të publikohet shkurtimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe në Fletoren Zyrtare.

10. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i njoftohet administrores së falimentimit znj. Shpresa Breçani.

11. Një kopje e shkurtimit të vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me qëllim njoftimin e të gjitha zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe kryerjen e veprimeve konform ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

12. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum”

sh.p.k., t’i dërgohet të gjitha bankave të nivelit të dytë të Republikën e Shqipërisë.

13. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

14. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

15. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Autoritetit Rrugor Kombëtar.

16. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

17. Një kopje e vendimit, për hapjen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Brum” sh.p.k., t’i dërgohet Dhomës Kombëtare të Noterëve.

18. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuarit.

19. Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot, më datë 26.2.2021, në Tiranë, ora 14:55.

SEKRETAR
Gencjana Dada

GJYQTAR
Alma Kodraliu

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 352 lekë